



## **SIGMA**

**Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe të Menaxhimit**  
Një iniciativë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Europian, e financuar kryesisht nga BE

# **KAPACITETET E MENAXHIMIT RREGULLATOR TË SHTETEVE ANËTARE TË BASHKIMIT EUROPIAN QË HYNË NË BE MË 1 MAJ 2004**

**MBËSHTETJA E PËRMIRËSIMEVE NË MENAXHIMIN RREGULLATOR NËPËRMJET NJË  
POLITIKE TË NORMIMIT MË TË MIRË**

## ***DOKUMENTI I SIGMA-S NR. 42***

Ky dokument është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk përfaqësojnë mendimin zyrtar të Bashkimit Europian dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e OECD-së dhe të vendeve anëtare të saj, apo të vendeve përfituese, pjesëmarrëse në Programin Sigma.

## PROGRAMI SIGMA

Programi SIGMA - mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe të menaxhimit - është një iniciativë e përbashkët e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe Bashkimit Europian (BE), financuar kryesisht nga BE.

Duke punuar në partneritet me vendet përfituese, Sigma mbështet qeverisjen e mirë përmes:

- vlerësimin të përparimit të reformave dhe identifikimit të përparësive bazuar në të dhëna bazë që pasqyrojnë praktikën e mirë europiane dhe legjislacionin ekzistues të BE-së (the *acquis communautaire*);
- dhënies së ndihmës për vendimmarrësit dhe administratat në ndërtimin e institucioneve dhe të procedurave për realizimin e standardeve dhe praktikën e mirë europiane;
- lehtësimin të ndihmës nga BE dhe donatorë të tjerë brenda dhe jashtë Europës duke ndihmuar për hartimin e projekteve, garantimin e parakushteve dhe mbështetjen për zbatimin.

Në vitin 2007 Sigma po punon me këto vende partnere:

- **Shtetet e reja Anëtare të BE-së** — Bullgaria dhe Rumania
- **Shtetet kandidate për BE** — Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Turqia
- **Vendet e Ballkanit Perëndimor** — Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina (Shteti, Federata e BH dhe Republika Serbska), Mali i Zi, Serbia dhe Kosova (qeverisur që në qershor 1999 nga Misioni i Administrimit të Përkohshëm të OKB në Kosovë – UNMIK)
- **Ukrainën** (veprimtaritë financohen nga Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar).

Programi Sigma mbështet përpjekjet për reforma të vendeve partnere në fushat e mëposhtme:

- Kuadri ligjor dhe administrativ, shërbimi civil dhe drejtësia; sistemet e integritetit publik
- Kontrolli i brendshëm financiar publik (KBFP), auditimi i jashtëm, lufta kundër mashtrimit financiar dhe menaxhimi i fondeve të BE-së
- Menaxhimi i shpenzimeve publike, sistemet e buxhetit dhe të thesarit
- Prokurimet publike
- Hartimi i politikave dhe koordinimi
- Normimi më i Mirë.

Për më shumë informacion mbi Programin Sigma, vizitoni faqen tonë të internetit:

<http://www.sigmaweb.org>

**Të drejtat e autorit: OECD, 2007**

**Ky material është botuar për herë të parë në gjuhën angleze nën titullin: *Regulatory Management Capacities of Member States of the European Union that Joined the Union on 1 May 2004.***

**OECD autorizon përdorimin e këtij materiali pa pagesë, për qëllime jofitimprurëse. Të gjitha kërkesat për përdorim për qëllime fitimprurëse të këtij materiali ose për marrjen e të drejtave të përkthimit të materialit duhet të dërgohen në adresën elektronike [rights@oecd.org](mailto:rights@oecd.org).**

## Falënderime

Analiza e kapaciteteve rregullatore të Qipros, Republikës Çeke, Estonisë, Hungarisë, Letonisë, Lituanisë, Maltës, Polonisë, Republikës Sllovaqe dhe Sllovenisë mbi të cilat mbështetet ky raport sintezë u krye në kuadër të programit Sigma.

Programi Sigma është një nismë e përbashkët e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe Komisionit Europian, i financuar kryesisht nga BE.

Në Sigma, projekti u menaxhua nga z. Edward Donelan, Administrator i lartë, i cili gjithashtu ka qenë bashkautor i raportit. Ai u ndihmua nga znj. Diane de Pompignan, Administratore, me mbështetjen administrative të Znj. Sandra Philippe.

Në Komisionin Europian projekti u menaxhua nga z. Manuel Maria Santiago dos Santos, DG Enterprise i cili u asistua nga Znj. Debby De Roover, Këshilltare Rregullatore, dhe me mbështetje financiare nga Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit, menaxhuar nga Z. Alan van Hamme dhe Znj. Ewa-Anna Stadnik.

Procesi u krye me ndihmën e një grupi kolegësh, me një grup prej tre homologësh që shkoi në çdo vend që u monitorua/vlerësua.

Gjithashtu u dha informacion shumë i rëndësishëm dhe nga ekspertët vendas.

Përmbledhja u qarkullua dhe u komentua nga një grup kryesor homologësh të zgjedhur sipas përfaqësimit gjeografik, numrit të vendeve të shqyrtuara apo njohurive të tyre të veçanta.

Homologët e përfshirë në komentimin e përmbledhjes ishin: Dr. Luigi Carbone, Profesor Alan Mayhew, Z. Dieudonné Mandelkern, Z. Charles Henri-Montin dhe Z. Henrik Wingfors.

## PASQYRA E LËNDËS

PROGRAMI SIGMA .....	2
PASQYRA E LËNDËS.....	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	6
1. HYRJE .....	9
Informacion historik mbi raportin.....	9
Çështjet e analizuara .....	10
Çështjet e pashqyrtuara .....	10
Metodologjia .....	10
Procesi.....	11
Shtetet e Reja Anëtare — Pamje e përgjithshme .....	11
Sfida të përgjithshme .....	14
2. ORIGINAT E POLITIKËS SË BASHKIMIT EUROPIAN MBI NORMIMIN MË TË MIRË .....	17
Cila është origjina e normimit më të mirë?.....	17
OECD dhe reforma rregullatore.....	17
Politika mbi normim më të mirë (Bashkimi European).....	18
Raporti i Grupit Mandelkern.....	18
Rinovimi i procesit të Lisbonës .....	19
Hartimi i politikës së BE-së për Normim më të Mirë .....	20
Vlerësim strategjik i Normimit më të Mirë në BE.....	21
3. MENAXHIMI RREGULLATOR.....	23
Hyrje .....	23
Politika për Normimin më të Mirë.....	23
Strategjia për veprim dhe procesi i vendosjes së prioritetëve .....	27
Një proces transparent dhe i strukturuar mirë.....	30
Sigurimi i cilësisë — institucionet.....	34
Sigurimi i cilësisë – instrumentet.....	38
Numër i mjaftueshëm personeli të trajnuar mirë .....	43
4. INSTRUMENTAT E NORMIMIT MË TË MIRË NË SHTETET E REJA ANËTARE.....	45
Vlerësimi i ndikimit — në përgjithësi.....	45
Vlerësimi i ndikimit në Shtetet e Reja Anëtare.....	49
Konsultimi në përgjithësi .....	55
Konsultimi në Shtetet e Reja Anëtare .....	56
Alternativa ndaj rregulloreve tradicionale — në përgjithësi.....	59
Alternativat ndaj rregulloreve tradicionale në Shtetet e Reja Anëtare.....	61
Thjeshtimi në përgjithësi.....	61
Matja e kostove administrative .....	64
Thjeshtimi në Shtetet e Reja Anëtare.....	65
Mundësia për informacion .....	71

5. MIRATIMI NGA PARLAMENTI .....	74
Strukturat për miratimin e legjislacionit parësor.....	74
Procedurat e miratimit.....	76
Nisja e projektligjeve dhe ndryshimeve nga anëtarët e parlamentit.....	77
Burimet në dispozicion të parlamentit .....	79
Rezultatet e arritura.....	80
Raportimet dhe vlerësimet publike .....	85
6. ZBATIMI DHE RESPEKTIMI.....	87
Qasja apo filozofia e përgjithshme e zbatimit dhe respektimit .....	87
A ka ndonjë prirje drejt niveleve më të larta të zbatimit ose respektimit?.....	88
Proceset e apelimit .....	90
7. PËRFUNDIME .....	92
Rekomandime të përbashkëta për të gjitha Shtetet e Reja Anëtare .....	94
SHTOJCA 1: FJALORTH TERMASH PËR PROJEKTIN E VLERËSIMIT TË KAPACITETEVE NORMUESE.....	96
SHTOJCA 2: STANDARDI .....	100
SHTOJCA 3: PYETËSOR MBI PROJEKTIN E VLERËSIMIT TË KAPACITETEVE TË MENAXHIMIT RREGULLATOR TË SHTETEVE TË REJA ANËTARE TË BE-së .....	104
SHTOJCA 4: HOMOLOGËT DHE GRUPI I MENAXHIMIT TË PROJEKTIT.....	109
SHTOJCA 5: BIBLIOGRAFIA E PËRZGJEDHUR.....	111

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### *Normimi më i mirë për të rritur konkurrueshmërinë e Europës*

Rritja e konkurrueshmërisë së ekonomisë së saj nëpërmjet rritjes së produktivitetit është një prej sfidave kryesore që merrte përsipër BE-ja në strategjinë fillestare të Lisbonës si dhe në strategjinë e ndryshuar të Lisbonës për zhvillim dhe krijim të vendeve të punës (miratuar respektivisht në vitin 2000 dhe 2005). Përmirësimi i mjedisit rregullator dhe proceseve rregullatore në nivel të institucioneve të BE-së dhe të shteteve të saj anëtare është një faktor kyç në krijimin e një mjedisi biznesi që nxit rritjen e produktivitetit.

Kjo politikë njihet si “Normimi/rregullimi më i mirë”. Kjo politikë nuk nënkupton më shumë apo më pak rregullim, por përfshin krijimin e proceseve që bëjnë të mundur që të gjitha rregulloret/aktet normative të jenë të lehta për t’u kuptuar, zbatuar, respektuar si dhe të kenë cilësi të lartë.

Rregullimi ligjor luan një rol qendror në funksionimin e ekonomive dhe është me rëndësi themelore për të trajtuar dështimet e tregut, nxituri konkurrencën, garantuar sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien si dhe për të lehtësuar mbrojtjen e mjedisit. Rregullimi me cilësi të lartë i arrin këto objektiva me koston më të ulët të mundshme. Rregullimi me cilësi të ulët mund të ketë pasoja të kundërta.

### *Analiza e kapaciteteve të menaxhimit rregullator të secilit prej Shteteve të Reja Anëtare (SHRA)*

Në institucionet e BE-së dhe në disa shtete anëtare të BE-së dihet shumë për zbatimin e politikës së Normimit më të Mirë, por më pak dihet në 10 vendet që iu bashkuan BE-së më 1 maj 2004 (SHRA). Në mënyrë që të mësohet më shumë nga 10 SHRA-të mbi zhvillimet rreth Normimit më të Mirë, Komisioni European i kërkoi Sigma-s ta studionte këtë çështje.

Këto studime fillimisht u krijuan si veprimtari për gjetjen e fakteve dhe nuk gjykonin cilësinë e rregulloreve të tyre. Ato u përdorën si një mjet për të nxitur zhvillimin e politikës së Normimit më të Mirë. Ky raport është një përmbledhje e këtyre studimeve që u kryen nga marsi 2005 deri në tetor 2006.

Studimet shqyrtuan: origjinën e politikës së BE-së për Normim më të Mirë për të ofruar një kuadër për studimet, proceset e menaxhimit rregullator, instrumentet e përdorur në këto procese (vlerësimi i ndikimit, konsultimi, thjeshtimi, alternativat dhe mundësia e përdorimit), proceset e miratimit/ratifikimit dhe zbatimi e respektimi i ligjeve në SHRA-të, duke iu referuar ligjit të pronësisë intelektuale dhe ligjeve mjedisore.

SHRA-të kanë gjeografi dhe kultura të ndryshme, por ndajnë bashkë përvojën e miratimit të *acquis communautaire* në një periudhë jashtëzakonisht të shkurtër dhe tani përballen me presionin e interpretimit dhe zbatimit të tij në kushtet e veta. Tetë prej këtyre vendeve kanë përjetuar një përsheptim të historisë kur u shndërruan nga ekonomi të centralizuara dhe të kontrolluara në ekonomi të tregut të lirë. Kjo nënkuptonte jo vetëm përshtatjen e ekonomive të tyre, por edhe ndryshime domethënëse dhe të rëndësishme në kulturat e tyre administrative dhe mjediset institucionale politike.

### *Përfundime*

1. Për të nxitur vëmendjen e vazhdueshme ndaj politikës së Normimit më të Mirë do të jetë e nevojshme vullneti politik. Për këtë arsye, Njësitë e Normimit më të Mirë duhet të tërheqin

vëmendjen politike nëpërmjet seminareve dhe debateve që nxisin të kuptuarit e çështjeve të lidhura me Normimin më të Mirë.

2. Hartimi i një politike për Normim më të Mirë dhe përmirësimi i kapaciteteve të menaxhimit të rregulloreve janë çështje që po konkurrojnë me një numër të madh çështjesh të tjera, të gjitha shumë të rëndësishme. SHRA-ve u duhet kohë për të përshtatur ndryshimet që kanë përjetuar si rrjedhojë e aplikimit të tyre për anëtarësim në BE, sidomos me përfshirjen e *acquis communautaire* dhe, për shumë prej tyre, kalimin në një ekonomi tregu të hapur. Përgjegjësia për hartimin e Normimit më të Mirë në SHRA-të bie mbi shpatullat e një numri të vogël zyrtarësh të përkushtuar. Sfida e SHRA-ve është të pranojnë se kjo nuk është thjesht një politikë që arrihet me “një goditje”, por është diçka që kërkon përkushtim të vazhdueshëm për përmirësim.
3. Të gjitha SHRA-të e kuptojnë nevojën për të përdorur instrumentet e Normimit më të Mirë. Megjithatë, shumë SHRA kanë miratuar ligje që i detyrojnë punonjësit të përgatisin vlerësimet e ndikimit të të gjithë legjislativitetit të tyre të ri. Këto ligje rrallë janë mbështetur me metodologji apo organizime institucionale të përshtatshme për të mbikëqyrur cilësinë e vlerësimeve. Si rrjedhojë, u humbën përfitimet e mundshme nga përdorimi i këtyre instrumenteve.
4. Shumica e SHRA-ve po e trajtojnë këtë problem, por qasja e zgjedhur për vlerësimin e ndikimit është një shembull i një problemi më të gjerë, kryesisht besimit se miratimi i një ligji është veprimtari e mjaftueshme për zgjidhjen e një problemi të politikave. Por, përveç miratimit të ligjeve, SHRA-të duhet të trajtojnë domosdoshmërinë e mbështetjes së ligjeve të reja me organizime të përshtatshme institucionale për të garantuar zbatimin e respektimin e tyre.
5. Të gjitha SHRA-të e pranojnë nevojën për të matur kostot administrative dhe, atje ku është e mundur, për të hedhur hapa për t’i ulur ato. Mund të shihet përparim në Shtetet e Reja Anëtare si në llogaritjen e kostove ashtu dhe në vlerësimin e procedurave administrative, shpesh të inspektimeve dhe në veprimtari të ngjashme zyrtare për të garantuar që të mbahet në minimum barra mbi njerëzit dhe sidomos barra tek bizneset e vogla. Ky është një zhvillim shumë pozitiv i cili duhet nxitur e mbështetur, aty ku është e mundur, nga institucionet e BE-së.
6. Gjithashtu, degët e ekzekutivit dhe legjislativit duhet të bashkëpunojnë së bashku dhe të ndjekin politika të përbashkëta për të arritur në Normim më të Mirë. Shumë prej SHRA-ve kanë përjetuar kriza politike kohët e fundit. Pjesëmarrësit në të gjitha pjesët e proceseve politike duhet të kuptojnë më thellë se përparësi duhet t’i jepet një mjedisi të mirë rregullator për të ruajtur dhe nxitur konkurrueshmërinë e ekonomive të tyre. Gjatë analizës së cilësisë së akteve normative, të dyja degët e qeverisjes duhet të ndjekin një qasje shumë-disiplinore, ku aktet normative të analizohen dhe vlerësohen për sa i përket zbatimit nga ana e tyre të parimeve të Normimit më të Mirë, si dhe çështjeve të efektivitetit të legjislativitetit.
7. Në të gjitha SHRA-të është e nevojshme të shqyrtohen politikat e zbatimit dhe respektimit për të zbuluar nëse ka mënyra më të mira për të garantuar që, pasi kthehen në ligj, ato të zbatohen e respektohen në një mënyrë që të prodhohen rezultatet e dëshiruara. Kjo gjithashtu është një çështje që mund të trajtohet në nivel të institucioneve të BE-së, dhe ofron një fushë të pasur për bashkëpunim në të ardhmen.

### ***Rekomandime të përbashkëta për të gjitha SHRA-të***

Raporti jep rekomandime që janë të përbashkëta për të gjitha SHRA-të:

1. Mbështetja politike është shumë e rëndësishme për hartimin dhe mbajtjen e një politike mbi Normimin më të Mirë.
2. Një politikë për arritjen e një Normimi më të Mirë funksionon më mirë kur ka masa të përshtatshme dhe të financuara mjaftueshëm për ta mbështetur e mbajtur atë.
3. Kapacitetet e menaxhimit të normave mund të zhvillohen nëpërmjet përdorimit efikas të instrumenteve për Normim më të Mirë.
4. Degët ekzekutive dhe legjislative të qeverisjes duhet të bashkëpunojnë në një mënyrë konstruktive për të garantuar qeverisje të zgjuar.
5. Duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje zbatimit dhe respektimit të normave.



## 1. HYRJE

*Ky raport është një përmbledhje e vlerësimeve të kapaciteteve të menaxhimit rregullator të 10 Shteteve të Reja Anëtare që iu bashkuan BE-së më 1 maj 2004 (SHRA).*

*Ky seksion jep informacion historik mbi raportin, përshkruan metodologjinë e përdorur dhe shpjegon se çfarë mbulon dhe çfarë nuk mbulon raportin.*

*Ai jep një pamje të përgjithshme të shkurtër të SHRA-ve dhe shpjegon lëndën kryesore të raportit.*

### **Informacion historik mbi raportin**

Rritja e konkurrueshmërisë së ekonomisë së saj nëpërmjet rritjes së produktivitetit është një prej sfidave kryesore që pranonte BE-ja në strategjinë fillestare të Lisbonës si dhe strategjinë e ndryshuar të Lisbonës për zhvillim dhe krijim të vendeve të punës (miratuar përkatësisht në vitin 2000 dhe 2005). Përmirësimi i mjedisit rregullator dhe proceseve rregullatore në nivel institucionesh të BE-së dhe të shteteve të saj anëtare nëpërmjet hartimit të një politike për Normim më të Mirë është një faktor kyç në krijimin e një klime biznesi që nxit rritjen e prodhueshmërisë.

Normimi, rregullimi luan një rol qendror në funksionimin e ekonomive dhe ka rëndësi jetike për të trajtuar dështimet e tregut, për të nxitur konkurrencën, garantuar sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien si dhe për të ndihmuar mbrojtjen e mjedisit. Normimi me cilësi të lartë i arrin këto objektiva. Normimi me cilësi të ulët mund të ketë pasojat të kundërta. Komisioni Europian ka hartuar një politikë për Normim më të Mirë, me qëllim përmirësimin e kapaciteteve të tij për menaxhimin rregullator. Politika funksionon në nivel të të gjitha institucioneve për të përmirësuar rrjedhën e rregulloreve/akteve normative të reja si dhe të atyre ekzistuese.

### ***Raportet e OECD-së mbi reformën rregullatore***

OECD ka publikuar një seri Raportesh mbi Reformën Rregullatore për shumicën e vendeve të OECD-së. Këto raporte përfshijnë një kapitull mbi kapacitetin e këtyre vendeve për të hartuar akte normative të një cilësie të lartë. Nga këto studime mund të kuptohet më shumë mbi kapacitetet e menaxhimit rregullator të disa shteteve anëtare të BE-së. Megjithatë, nuk ekzistojnë studime të tilla për SHRA-të, përveç raporteve të OECD-së mbi reformën rregullatore në **Republikën Çeke, Hungarinë dhe Poloninë**.

Komisioni Europian dëshironte të kuptonte më shumë kapacitetet e menaxhimit rregullator të SHRA-ve dhe të nxiste miratimin e një politike të Normimit më të Mirë në të gjitha Shtetet Anëtare, të ngjashme me ato të miratuara nga institucionet e BE-së. Me këtë objektiv, Komisioni Europian i kërkoi Sigmës të vlerësojë kapacitetet menaxhuese rregullatore të SHRA-ve. U përgatit një raport me vlerësimin për çdo SHRA dhe iu dha çdo SHRA-je si dhe Komisionit Europian.

Raportet e veçanta mbi SHRA-të nuk u publikuan nga Komisioni Europian sepse ato janë dokumente të brendshme të tyre dhe të qeverive të përfshira. Megjithatë, SHRA-të ishin të lira t'i përkthenin dhe t'i publikonin raportet apo t'i përshtatnin materialet e tyre për nevojat e politikave të tyre. Raportet për **Republikën Çeke, Lituaninë, Poloninë, Republikën Sllovaqe dhe Slloveninë** u përkthyen dhe iu vunë në dispozicion këtyre SHRA-ve.

## Çështjet e analizuar

Vlerësimet u kryen duke marrë për referencë një standard, të përcaktuar tek **Shtojca 2**, krijuar me qëllim për tu përdorur në 10 vlerësimet. Këto vlerësime kishin për qëllim të analizonin pesë fusha:

1. Ekzistencën e një politike për sa i përket menaxhimit rregullator dhe shkallën në të cilën ajo është zhvilluar në një politikë për të përmirësuar normimin (Normim më i Mirë).
2. Formulimin e një politike, hartimin e rregulloreve<sup>1</sup>, procesin për të garantuar cilësinë rregullore për “rrjedhën” e rregulloreve të reja si dhe “stokun” e rregulloreve ekzistuese.
3. Procesin e miratimit/hyrjes në fuqi.
4. Mekanizmat për zbatim e respektim.

Standarti u krijua në mënyrë specifike për këtë projekt dhe nuk shfaqet në asnjë literaturë tjetër mbi këtë temë.

## Çështjet e pashqyrtuara

Vlerësimet e kapaciteteve të menaxhimit rregullator të SHRA-ve, mbi të cilat mbështetet kjo përmbledhje, nuk përpiqeshin të gjykonin nëse rregulloret e hartuara në Shtetet Anëtare në fjalë ishin të mira apo të këqija, apo nëse legjislacioni në SHRA-të ishte i një cilësie të lartë. Procesi nuk u përpoq as të gjykonte nëse Shtetet Anëtare kishin më shumë rregullore sesa duhej ose jo. Vlerësimet kishin për qëllim të gjenin çfarë niveli kishin kapacitetet e menaxhimit rregullator të SHRA-ve të matura përkundrejt një standardi të përcaktuar për këtë studim, dhe deri në çfarë shkalle po hartoheshin politika të llojit Normim më i Mirë në këto vende.

Vlerësimet dhanë rekomandime për reforma për secilën SHRA, shumica e të cilave u pranuan pasi përputheshin me politikat e tyre ekzistuese apo të planifikuara.

## Metodologjia

Përgatitja e raportit mbi SHRA-të ndoqi tre faza: përgatitja, vlerësimi nga homologët dhe kontrolli i fakteve. Faza e përgatitjes përfshiu përcaktimin e një standardi përkundrejt të cilit do të studioheshin kapacitetet e menaxhimit rregullator të SHRA-ve. Gjithashtu u hartua një pyetësor dhe iu dërgua secilit SHRA (**Shtojca 3**).

Secili Shtet i Ri Anëtar u vizitua nga një grup homologësh për 5 ditë të njëpasnjëshme pune. Për këtë proces u zgjodh një panel homologësh (**Shtojca 4**). Këta u përzgjedhën në bazë të njohurive, përvojës dhe pozicionit të tyre në lidhje me çështjet e Normimit më të Mirë, dhe u zgjodhën nga Drejtorët e Rrjetit<sup>2</sup> të Normimit më të Mirë si dhe Grupi i Punës i OECD-së mbi menaxhimin rregullator.

Tre homologë u përzgjedhën për secilin mision në një SHRA. Homologët e përzgjedhur për secilin mision u zgjodhën në mënyrë të atillë që të sillnin një larmi të aftësive, njohurive dhe përvojave në fushat përkatëse: çështje të politikave të administrimit, sistemeve ligjore dhe politikave ekonomike. Gjithashtu,

---

<sup>1</sup> Fjala “rregullore” përdoret në të gjithë tekstin duke nënkuptuar instrumenta ligjore apo administrative për të arritur objektivat e politikave. Termi “rregullore” përdoret më shpesh nga ekonomistët dhe shkencëtarët politikë në kuptimin e gjerë të arritjes së rezultateve të politikave. Juristët e përdorin fjalën “rregullore” për t’iu referuar legjislacionit dytësor. Ky studim pasqyron shumë nga mendimet e OECD-së mbi këtë temë dhe raportet e shkruara në këtë fushë e përdorin fjalën “rregullore” më shpesh sesa “legjislacion”. Për këtë arsye, fjala “rregullore” përdoret sa më shpesh të jetë e mundur. Megjithatë, herëpashere, ky raport, për të qenë më i qartë, përdor termin “legjislacion” dhe ky është termi më i njohur nga punonjësit me përgatitje juridike. “Legjislacioni” ndahet më tej në ligje parësore (të hartuara nga parlamentet) dhe ligje dytësore (të hartuara nën autoritetin e legjislacionit parësor).

<sup>2</sup> Një grupim informal i Drejtorëve për Normim më të Mirë të qeverive të BE-së, i cili mbledhet dy herë në vit.

ata u përzgjedhën edhe për të arritur një shpërndarje gjeografike dhe një përfaqësim të ekuilibruar të sistemeve të ndryshme administrative dhe ligjore. Për secilin SHRA u hartua një raport, u ra dakord mbi të nga homologët, dhe pastaj iu dorëzua SHRA-ve për kontroll të fakteve.

## **Procesi**

Procesi i vlerësimit nga homologët që u përdor u krijua për të ndërtuar një dialog politikash brenda SHRA-ve dhe mes SHRA-ve dhe homologëve, si dhe për të analizuar e identifikuar pikat e forta, të dobëta apo edhe mangësitë në kuadrin e institucioneve, të politikave dhe instrumenteve të politikave për menaxhimin rregullator. Ky proces rezultoi një shkëmbim të gjallë të pikëpamjeve në shumicën e SHRA-ve dhe në një shpirt për shkëmbimin e sukseseve dhe dështimeve. Për shkak të rëndësisë së Normimit më të Mirë për Axhendën e Lisbonës, vlerësimi i çdo SHRA-i kërkoi prova të kapaciteteve për menaxhim rregullator dhe sidomos kapacitetit për të miratuar, zbatuar dhe zhvilluar një politikë për Normimin më të Mirë. Po ashtu, kjo veprimtari kishte për qëllim të nxirrte në pah ato politika që kanë funksionuar mirë në SHRA-të dhe, nëpërmjet homologëve, t'u jepte informacion SHRA-ve dhe të identifikonte ato fusha ku mund të kishte përmirësime.

Në lidhje me këtë proces u organizuan seminare në gjashtë SHRA<sup>3</sup>, për të cilat u sollën ekspertë nga Shtete Anëtare të tjera, dhe u bë e mundur që një numër i madh punonjësish të dëgjonin për Normimin më të Mirë si dhe për procesin e vlerësimit. Përveç kësaj, Ministria e Ekonomisë në **Poloni** organizoi një konferencë të suksesshme dhe me shumë pjesëmarrës, mbi Normimin më të Mirë në SHRA-të.

## **Shtetet e Reja Anëtare — Pamje e përgjithshme**

SHRA-të kanë shumë pika të përbashkëta për sa i përket politikës për menaxhimin rregullator. Të gjitha janë marrë në një mënyrë apo një tjetër me hartimin e politikave që kanë objektiva të ngjashme me ato të miratuara nga institucionet e Bashkimit Europian dhe vende të tjera si pjesë e një prirjeje mbarëbotërore drejt një qëllimi për një Normim më të Mirë. Është bërë shumë përparim dhe ka pasur shumë zhvillime nga nisja e projektit deri në përfundimin e tij. Tabela e mëposhtme ju jep një ide të asaj që ka ndodhur dhe ka më shumë si qëllim të pasqyrojë përparimin sesa të japë një pamje të përgjithshme gjithëpërfshirëse, gjë e cila do të kërkonte përditësim të vazhdueshëm.

---

<sup>3</sup> Shih për shembull **Qipro, Republika Çeke, Letonia, Lituania, Malta** [www.mcmp.gov.mt/newsdetail.asp?i=126](http://www.mcmp.gov.mt/newsdetail.asp?i=126) dhe **Republika Sllovaqe**.

**Disa shembuj të praktikave më të mira dhe zhvillimeve të propozuara**

<b>SHRA-të</b>	<b>Praktika më e mirë<sup>4</sup></b>	<b>Zhvillimet e propozuara</b>
<b>Republika Çeke (Kontrolli i fakteve më 11 dhjetor 2006)</b>	Qeveria e Republikës Çeke miratoi në prill 2005 një Plan Veprimi për Uljen e Barrës Administrative mbi Bizneset, si dhe një Metodologji për Matjen e Barrës Administrative, mbështetur në Modelin e Kostos Standarde Holandeze <sup>5</sup> . Sipas këtij plani, kreu i Zyrës së Qeverisë ishte përgjegjës për hartimin e një raporti ( <i>Analiza e Barrës Administrative mbi Bizneset</i> ) mbështetur në rezultatet e matjeve të kryera në ministri dhe autoritete të veçanta të administratës shtetërore qendrore.	Republika Çeke ka forcuar kapacitetet e saj për të zbatuar politikën e Normimit më të Mirë dhe ka hartuar një metodologji të re për vlerësimin e ndikimit.
<b>Qipro (Kontrolli i fakteve më 5 qershor 2006)</b>	“Qendra e parë me një ndalesë” për qytetarët u hap në dhjetor 2005 për të ofruar mundësi më të mirë për disa kategori të caktuara informacioni të qeverisë dhe për një sërë shërbimesh. Ajo bashkon disa shërbime: dokumentet e identitetit, regjistrimin e automjeteve, përfitimet shëndetësore dhe shoqërore. Është një mjedis shtesë i ofruar për lehtësi të publikut, dhe shërbimet vazhdojnë të ofrohen në zyrat e veçanta të çdo ministrie. Qendra me një ndalesë ka personel përfaqësues të çdo ministrie përkatëse. Ka për qëllim të jetë si një vitrinë e politikës së qeverisë për ta bërë administratën më të përdorshme nga publiku.	Qipro ka krijuar një Grup Pune për të hetuar mënyrat me anë të të cilave vlerësimi i ndikimit mund të bëhet pjesë e procesit politikë-bërës. Në tetor të vitit 2006 u hap një Qendër e dytë me një Ndalesë, dhe e treta planifikohet të hapet deri në shkurt të vitit 2007.
<b>Estonia (Kontrolli i fakteve më 15 qershor 2006)</b>	Është krijuar një instrument i qeverisjes elektronike për të lehtësuar konsultimin, i quajtur Web ‘Talk along’ <sup>6</sup> . Ai lejon përfshirjen e qytetarëve në formulimin e politikave dhe hartimin e legjislacionit.	Bizneset tani mund të krijohen në më pak se dy muaj, dhe po mendohet dhe për hartimin e një politike të qartë mbi Normimin më të Mirë. Janë planifikuar dy projekte të reja për Kostot e Standardeve (transporti dhe fondet strukturore) dhe një program thjeshtimi.
<b>Hungaria (Kontrolli i fakteve 15 gusht 2006)</b>	Në vitin 2004 u prezantuan dy nisma për trajnimin e punonjësve mbi administrimin modern, ku përfshihej Normimi më i Mirë. I pari është në Budapest, i dyti në Universitetin e Perch, i cili ka nisur një program mësimor mbi Normimin më të Mirë për juristë të autoriteteve vendore. Trajnimi ka për qëllim t’u japë	Projekti për vlerësimin e efikasitetit të vlerësimeve të ndikimit rregullator është në proces e sipër. Është marrë vendimi për të vlerësuar detyrimet rregullatore të brendshme për Ministrinë e

<sup>4</sup> Informacioni i paraqitur në këtë tabelë ishte i saktë në kohën e hartimit të raportit për çdo vend.

<sup>5</sup> Rezoluta (Nr. 421/2005).

<sup>6</sup> [www.mkm.ee/index.php?id=8252](http://www.mkm.ee/index.php?id=8252).

	punonjësve aftësitë e duhura për të ndërmarrë dhe menaxhuar një projekt për vlerësimin e ndikimit.	Drejhtësisë.
<b>Letonia</b> (Kontrolli i fakteve 17 maj 2006)	Një tipar dallues i sistemit letonez të qeverisjes është se një përfaqësues i OJF-ve dhe shoqatave profesionale mund të ndjekë takimet e Sekretarëve të Shtetit si vëzhgues. Ky tipar bën të mundur ndërgjegjësimin e shoqërisë civile, nëpërmjet një rrjeti të OJF-ve dhe shoqatave profesionale, mbi zhvillimet në politika dhe propozimet për rregullore të reja. Procesi është strukturuar në atë mënyrë që OJF-të dhe shoqatat profesionale të mund të dorëzojnë komentet e tyre mbi projektpolitikat dhe projektregulloret.	Është planifikuar të hartohet një model standard për koston dhe është në proces e sipër edhe një program thjeshtimi i përkohshëm ( <i>ad hoc</i> ).
<b>Lituania</b> (Kontrolli i fakteve 19 shtator 2005)	Një faktor thelbësor në menaxhimin rregullator është zgjidhja e shpejtë e mosmarrëveshjeve. Komisioni Kryesor për Mosmarrëveshjet Administrative dëgjon pretendimet dhe zgjidh mosmarrëveshjet në lidhje me ligjshmërinë e vendimeve administrative.	<b>Lituania</b> ka përkthyer dhe publikuar raportin e Sigma-s në gjuhën lituaneze dhe po ecën drejt zhvillimit të një politike për Normim më të Mirë.
<b>Malta</b> (Kontrolli i fakteve 28 korrik 2006)	Në zyrën e kryeministrit ka një Njësi për Efiçencën e Menaxhimit. Kjo njësi përfshin Njësinë për Normim më të Mirë, të sapokrijuar, dhe është një model interesant për të kryer reformat për Normim më të Mirë pasi është në qendër të qeverisë dhe në të njëjtën kohë një pjesë integrale e Shërbimit Publik në tërësi.	Propozim për hartimin e një politike VER.
<b>Polonia</b> (Kontrolli i fakteve 10 tetor 2006)	Ekziston një grup pune ndërministror (Task Forca për Normimin Ekonomik Modern) për të hartuar politika për Normim më të Mirë; një grup në Ministrinë e Ekonomisë dhe një punonjës në secilën ministri janë përgjegjës për krijimin e një Normimi më të Mirë në atë Ministri.	Që në vitin 2006, në Poloni është hartuar një strategji për Normim më të Mirë. Më 19 gusht 2006, Këshilli i Ministrave miratoi Programin për Reformën Rregullatore. Ai është programi i parë gjithëpërfshirës për reformë rregullatore në Poloni i cili përcakton një qasje të integruar ndaj politikës së menaxhimit rregullator. Programi ka një plan me 3 faza për zbatimin e Modelit Standard për koston për të llogaritur kostot administrative të normimit. Më 10 tetor 2006, Këshilli i Ministrave miratoi një metodologji të rishikuar të VER-it (Vlerësim për

		Efektin e Rregulloreve) – <i>Udhëzimet për Vlerësimin e Ndikimit të Rregulloreve.</i>
<b>Republika Sllovaqe (Kontrolli i fakteve 4 shtator 2006)</b>	Një tipar i ri i sistemit të vlerësimit të ndikimit të tij është vlerësimi i ndikimit të legjislacionit të propozuar për familjet e vendit.	Analiza e politikës së saj të vlerësimit të ndikimit dhe hartimi i një metodologjie të re.
<b>Sllovenia (Kontrolli i fakteve 8 dhjetor 2006)</b>	Ka një Program Masash për Uljen e Barrave Administrative, i cili synon të pakësojë pengesat administrative, të garantojë që administrata publike të jetë e sjellshme, efektive, e hapur dhe transparente, dhe të nxisë zhvillimin e shpejtë të qeverisjes elektronike. Të gjitha ministratë po përgatisin plane pune për periudhën 2007-2008 për të ulur barrat administrative.	Krijimi në 2006 i një grupi të posaçëm për të mbikëqyrur Normimin më të Mirë ishte një lëvizje e rëndësishme drejt zhvillimit të një politike gjithëpërfshirëse për Normim më të Mirë.

### **Periudhë e ndryshimit të shpejtë**

Shtetet e Reja Anëtare që kanë qenë nën ndikimin komunist kanë kaluar një periudhë ndryshimi të shpejtë e thelbësor për përshtatjen e tyre nga ekonomi “komandë e kontrolli” në ekonomi të tregut të lirë, dhe kanë ndërmarrë ndryshimet e nevojshme për të arritur tek legjislacioni i Bashkimit Europian, *acquis communautaire*.

Në një kohë relativisht të shkurtër, këtyre SHRA-ve iu është dashur të krijojnë kapacitete të reja institucionale ose të zhvillojnë dhe të përshtatin të vjetrat. **Qipros** dhe **Maltës** nuk iu është dashur të merren me çështjet që kanë të bëjnë me krijimin e një tregu të lirë, por iu është dashur të merren me sfidën e miratimit të një vëllimi të madh legjislacioni të ri në mënyrë që të përputheshin me *acquis communautaire*, pa përfitimin e llojit të ndihmës dhe asistencës që morën SHRA-të e tjera.

**Qipro** dhe **Malta** patën avantazhin e sistemeve ligjore dhe strukturave institucionale të cilat ishin zhvilluar gjatë një periudhe të gjatë kohe. Ky avantazh duhet peshuar përkundrajt faktit se ato ishin SHRA të vogla, me një kapacitet administrativ tashmë nën një presion të madh për të mbuluar nevojat e brendshme.

Të gjitha SHRA-të u përballën me një përshpejtim të historisë. Më vonë do të nevojitet një vlerësim i ndikimit të plotë të këtij përshpejtimi, nëse ai del i suksesshëm apo jo, dhe pse. Në kohën kur u kryen vlerësimet, të gjitha SHRA-të morën frymë të çliruara sepse ishte kaluar me sukses sfida e përqaimit, miratimit të *acquis communautaire*.

Ekipet e homologëve ndanë përvojën e, nga njëra anë, të të parit të “të korrave”, ndryshimeve të mëdha administrative, ekonomike, politike dhe shoqërore si dhe nga ana tjetër, të të parit të fushave që sapo ishin mbjellë e që kishin nevojë për kohë që farat të çelnin e të lulëzonin.

Në këto vende ka dalë në skenë një brez i ri zyrtarësh, dhe është me fat që sfida e përmirësimit të menaxhimit rregullator është ndërmarrë nga ai brez.

### **Sfida të përgjithshme**

Pesë sfidat e përgjithshme me të cilat përballen të gjitha SHRA-të: nevoja për të ruajtur mbështetjen politike; nevoja për të kryer vlerësimin e ndikimit në thelb e në formë; eficienta, së bashku me efektivitetin ligjor janë element përcaktues kyç të normimit me një cilësi të mirë; parlamentet duhet t’i kushtojnë

vëmendje më të madhe edhe çështjeve të Normimit më të Mirë dhe politikave të zbatimit duhet të merren më shumë parasysh.

### ***Mbështetja politike duhet të jetë e vazhdueshme***

Mbështetja politike për Normim më të Mirë është e pranishme në të gjitha SHRA-të. Megjithatë, do të nevojitet më shumë mbështetje dhe inkurajim për të vazhduar përparimin. Mbështetja politike për futjen e politikave mbi Normimin më të Mirë është më e dukshme sesa mbështetja politike e prekshme për zbatimin e Normimit më të Mirë.

Disa SHRA (**Republika Çeke dhe Polonia**) kanë miratuar politika të qarta mbi Normimin më të Mirë përpara procesit të vlerësimit nga homologët.

**Estonia, Lituania, Malta, dhe Sllovenia** ishin në proces e sipër të miratimit të një politike të tillë, dhe shtetet e tjera ose po merrnin në konsideratë miratimin e një politike të qartë, ose mendonin se ajo që po bënë ishte e mjaftueshme për të ofruar një legjislacion me një cilësi të lartë.

Megjithatë, përvoja nga vendet e OECD-së tregon se hartimi i Normimit/Rregulloreve më të Mira nuk është një politikë “që arrihet me një herë”, por diçka që ka nevojë për monitorim të vazhdueshëm dhe që zakonisht duhet të kalojë nëpër një numër veprimesh në mënyrë që të dalë i suksesshëm. Edhe në SHRA-të që kanë tashmë një politikë të tillë të miratuar, do të duhen përpjekje të vazhdueshme për t’i mbajtur ato.

### ***Vlerësimet e ndikimit duhet të kryhen në thelb dhe në formë***

Të gjitha SHRA-të, me përjashtim të **Maltës** dhe **Qipros**, kanë ligje që kërkojnë kryerjen e vlerësimeve të ndikimit të rregulloreve (VNR) si pjesë e hartimit të politikave të reja rregullatore.

Megjithatë, organizimet e pamjaftueshme institucionale, sidomos për sa i përket analizës cilësore të vlerësimeve, mungesa e metodologjive dhe e trajnimeve të qarta bënë që procesi të kthehej në një formulë boshe dhe që VNR të ekzistonte thesht si emër dhe jo në thelb, substancë.

Këto probleme janë trajtuar ose po trajtohen (**Estonia, Republika Çeke, Letonia, Lituania, Polonia, Republika Sllovaqe dhe Sllovenia**). Në këto vende po arrihet përparim për të përmirësuar mbështetjen institucionale për VNR, për të hartuar metodologji efektive dhe trajnuar zyrtarët.

### ***Efiçenca, së bashku me efektivitetin e ligjeve, është një element përcaktues kyç i rregulloreve me cilësi të mirë***

Procesi i formulimit të politikave dhe të hartimit të rregulloreve në të gjitha SHRA-të ndikohet pashmangshmërisht nga traditat dhe praktikave kulturore, ligjore dhe administrative. Nuk ka dyshim se siguria ligjore është një pjesë thelbësore e efektivitetit rregullator. Megjithatë, përvoja nga studimet e OECD-së tregon se rregulloret nuk duhet të jenë vetëm efektive ligjorisht, por ato duhet të jenë edhe efiçente. Rregulloret duhet të jenë të lehta për tu respektuar e zbatuar, dhe duhet të veprojnë pa pasoja të padëshiruara. Për t’i arritur këto synime nuk mjafton një qasje thjesht ligjore ndaj hartimit të rregulloreve. Duhet të ketë një qasje shumëdisiplinëshe ndaj hartimit të politikave dhe të legjislacionit, dhe njohje të nevojës për të pasur strukturat e duhura në fuqi.

Strukturat administrative në të gjitha SHRA-të përqendrohen në efektivitetin ligjor. Në këto SHRA kanë hyrë në fuqi shumë ligje pa iu vënë shumë rëndësi mënyrës se si ato do të funksionojnë në praktikë dhe se si ato do të zbatohen. Në këtë drejtim po arrihet përparim, por ky nuk është i njëjlojtë dhe nuk do të mund të jetë i qëndrueshëm.

### ***Parlamentet duhet t’i kushtojnë vëmendje më të madhe edhe çështjeve të Normimit më të Mirë***

Regjimet rregullatore efektive kanë nevojë për mbikëqyrje efektive nga parlamenti. Shumë parlamente në SHRA-të kanë zhvilluar kapacitete të mira kërkimore, por ende nuk janë angazhuar plotësisht me përmirësime të mundshme të cilësisë së rregulloreve, cilësi që mund të vijë nga përdorimi i politikave për

Normim më të Mirë. Në pjesën më të madhe të SHRA-ve ka disa shenja se punonjës të ekzekutivit po përmirësojnë kapacitetet e menaxhimit rregullator nëpërmjet Normimit më të Mirë. Megjithatë, ky interes nuk po mbështetet në këto SHRA nga parlamentet. Sugjerimet e bëra në raportet përkatëse të Sigma-s që u janë dhënë SHRA-ve përfshinin idenë e debateve në parlamente, çdo vit, mbi çështjet që kanë lidhje me Normimin më të Mirë.

***Politikat e zbatimit duhet të merren më shumë parasysh***

Të gjitha SHRA-të thonë se përdorin qasjen e “zero tolerancë” ndaj zbatimit, por sfidat e kapaciteteve, aftësive e cënojnë këtë qasje. Për shkak të rëndësisë që ka kjo çështje për integrimin europian, SHRA-të duhet të tregojnë më shumë vëmendje ndaj gjetjes së një qasjeje më realiste për zbatimin, si p.sh. hartimi i një politike të mbështetur mbi analizën e rrezikut, ose një politike që vendos tarifa për inspektimet.



## 2. ORIGJINAT E POLITIKËS SË BASHKIMIT EUROPIAN MBI NORMIMIN MË TË MIRË

### Cila është origjina e normimit më të mirë?

Nevoja për Normim më të Mirë rrjedh nga një shqetësim i qeverive për t'i mbajtur shpenzimet e qeverisë në minimum dhe për të siguruar që normimi të jetë eficient si dhe efektiv ligjërisht. Kjo rrjedh gjithashtu edhe nga shqetësimi për t'i mbajtur kostot rregullatore më të ulëta sesa përfitimet që nxirren nga legjislacioni. Rrënjët e Normimit më të Mirë mund të gjenden tek reformat rregullatore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat kishin për qëllim zvogëlimin e qeverisë si dhe të ndërhyrjes së saj në treg.

Një sërë reformash rregullatore dhe veprimtarish rregullatore së pari në **SHBA** dhe pastaj në vende të tjera çuan në tregje që funksiononin më mirë, sipas raporteve të OECD-së. Megjithatë, reforma rregullatore në shumë raste sollën dhe rritje të normimit. Kjo për shkak se aty ku ekzistonin monopole shtetërore nuk kishte nevojë për rregulla për futjen dhe daljen nga tregu. Gjithësesi, kur një shtet dilte nga një fushë, si p.sh. telekomunikacioni apo shërbime të tjera në infrastrukturë, duhej të futeshin rregulla për të siguruar barazinë në treg, dhe për këtë arsye u rrit numri i rregulloreve. Në SHBA, shqetësimet në lidhje me numrin e tepërt të rregulloreve si dhe me cilësinë e dobët të rregulloreve sollën politika që kishin për synim përmirësimin e cilësisë së legjislacionit, përfshirë këtu përdorimin e vlerësimit të ndikimit.

Në **Mbretërinë e Bashkuar**, një Dokument i Bardhë i vitit 1985, *Heqja e Barrës*, trajtonte shqetësimet rreth barrës së legjislacionet mbi bizneset e vogla. Vende të tjera europiane hartuan politika të ngjashme. Institucionet e BE-së filluan të hartonin një politikë të Normimit më të Mirë në të njëjtën periudhë. Zhvillime të ngjashme ndodhën në disa Shtete të tjera Anëtare të BE-së, kryesisht në **Hollandë**, **Danimarkë** e **Suedi**. Disa vende, si **Franca**, ndërmorën reforma të ngjashme në kuadër të modernizimit të shërbimeve të tyre publike. **Irlanda** miratoi një politikë të quajtur *Si të Normojmë më Mirë*.

### OECD dhe reforma rregullatore

OECD-ja ka studiuar mbi 23 vende nga këndvështrimi i reformës rregullatore dhe ka vënë re se vendet me ekonomi më të mirë i kushtonin rëndësi cilësisë së menaxhimit të proceseve të tyre rregullatore. Në studimet e OECD-së vërehen tre faza reforme. Në fazën e parë, të klasifikuar si kundër-normim, ajo që ndodh është heqja e rregullimeve që pengojnë konkurrencën dhe tregtinë, dhe zvogëlimi i numrit të rregulloreve. Ky proces përfshin gjithashtu uljen e barrës mbi bizneset dhe të kostos së rregulloreve, si dhe thjeshtimin e procedurave dhe reformimin e administratës. Të gjitha vendet e studiuara bëjnë pjesë në këtë kategori, megjithëse shkalla në të cilën janë kryer të gjitha reformat ndryshon nga vendi në vend dhe brenda vetë këtyre vendeve.

Në fazën e dytë të zhvillimit të këtij subjekti, të klasifikuar si Reforma Rregullatore, bëhet një përpjekje për të prodhuar rregullore me cilësi të lartë nëpërmjet proceseve të përmirësuara politike-bërëse, të cilat përdorin instrumente të tilla si vlerësimi i ndikimit, konsultimi më i mirë dhe planifikimi më efikas i masave rregullatore. Kjo fazë mund të përfshijë edhe përditësimin dhe analizimin e modernizimit (d.m.th. përpunjen me objektivat politike në fushat e ekonomisë, mjedisit dhe standardeve shoqërore) të rregulloreve ekzistuese. Të gjitha vendet e studiuara bëjnë pjesë në këtë kategori, megjithëse shkalla në të cilën janë kryer të gjitha reformat ndryshon nga vendi në vend dhe brenda vetë atyre vendeve.

Në fund, faza e tretë e reformës është klasifikuar nga OECD si menaxhim rregullator, i cili merret me këndvështrimin afatgjatë, sistematik në lidhje me përmirësimin e institucioneve dhe të performancës rregullatore. Asnjëri prej vendeve të studiuara nuk e ka arritur plotësisht këtë fazë.

Një zhvillim kyç në mendim, i kontribuar nga OECD-ja, ishte miratimi në vitin 1995 i *Rekomandimeve të Këshillit të OECD-së për Përmirësimin e Cilësisë së Rregullimit të Qeverisë*<sup>7</sup>. Ky rekomandim parashtroi grupin e parë të parimeve të pranuar botërisht mbi garantimin e cilësisë rregullatore. Ky grup përfshiu 10 pika të Listës së Kontrollit të OECD-së për Vendimmarrjen Rregullatore. Në një raport të rëndësishëm *Nga Ndërhyrja në Qeverisje Rregullatore*<sup>8</sup>, OECD identifikoi tre pika kyçe për të pasur efektshmëri rregullatore. Këto ishin politikat rregullatore (d.m.th. politika për të përmirësuar procesin rregullator), mjetet rregullatore dhe institucionet rregullatore. Programi i Reformës Rregullatore të OECD-së, i cili përfshin një sërë studimesh mbi reformat rregullatore në vendet anëtare të OECD-së, synon të ndihmojë qeveritë të përmirësojnë cilësinë rregullatore. Ai përqëndrohet në reformimin e rregulloreve që krijojnë pengesa të panevojshme në lidhje me konkurrimin, inovacionin dhe zhvillimin, ndërkohë që garanton që rregulloret të shërbejnë me efikasitet qëllimeve të rëndësishme të shoqërisë.

### **Politika mbi normim më të mirë (Bashkimi Europian)**

Një hap fillestar drejt përmirësimit të mjedisit rregullator në institucionet e BE-së u ndërmor kur Institucionet e BE-së miratuan rekomandimet udhëzuese të Marrëveshjes Ndërinstitucionale të dhjetorit 1998. Qëllimi i kësaj ishte përmirësimi i cilësisë së projekt-legjislacionit<sup>9</sup>. Këshilli Europian i Edinburgut i vitit 1992 e ktheu në një nga përparësitë kryesore të Komunitetit detyrën e thjeshtimit dhe përmirësimit të mjedisit rregullator. Megjithatë, vetëm nga mesi i viteve '90 u bë sistematik kërkimi për rregullime të cilësisë më të lartë. Normimi më i Mirë përmendet gjithashtu edhe në një protokoll bashkëngjitur Traktatit të Amsterdimit.

Kjo çështje u trajtua më tej në kuadër të përpjekjeve për të luftuar performancën rritjes relativisht të dobët ekonomike të shumë Shteteve Anëtare – një çështje që shpesh shqetëson ligjvënës të europianë. Për të trajtuar këtë çështje, krerët e shteteve dhe të qeverive të vendeve të BE-së u takuan në Lisbonë në vitin 2000 dhe nisën një sërë reformash ambicioze në nivel kombëtar dhe nivel europian si pjesë e një strategjie të përgjithshme. Duke krijuar një treg të brendshëm efektiv, duke forcuar kërkimin shkencor dhe inovacionin dhe duke përmirësuar arsimimin (që janë vetëm disa prej përpjekjeve për reformë), ata kishin për qëllim të zgjidhnin sfidat me të cilat përballëj BE-ja për shkak të ndikimit të ndryshimeve demografike dhe globalizimit.

Hartimi i Normimit më të Mirë në Bashkimin Europian u përshpejtua më shumë me daljen e Dokumentit të Bardhë të BE-së mbi Qeverisjen. Ky Dokument i Bardhë tregon se kishte disa lidhje mes qeverisjes së mirë dhe përpjekjeve për Normim më të Mirë.

### **Raporti i Grupit Mandelkern**

Një prej masave praktike të marra për këtë politikë ishte krijimi i një grupi përfaqësues të Shteteve Anëtare, nën kryesimin e një gjykatësi të Këshillit të Shtetit në Francë, Z. D. Mandelkern<sup>10</sup>, për të shqyrtuar mënyrat me të cilat mund të përmirësohej hartimi i politikave dhe i rregulloreve në institucionet e Bashkimit Europian. Grupi raportoi në nëntor të vitit 2001 dhe hartoi një plan për një Normim më të Mirë në Bashkimin Europian. Ky raport u vlerësua nga të gjithë dhe rekomandimet e tij u pranuan në masë të gjerë nga institucionet e BE-së.

<sup>7</sup> OECD/GD/ 95(95) OECD, Paris (1995)

<sup>8</sup> OECD Paris, [PUMA(2002)3]

<sup>9</sup> Deklarata 39 mbi cilësinë e hartimit të legjislacionit të Komunitetit, shtojcë e Aktit Final të Traktatit të Amsterdimit, 1997.

<sup>10</sup> <http://ec.europa.eu/governance/impact/docs/mandelkern.pdf>

Grupi përdori shumë burime, si p.sh. raportet mbi reformën rregullatore nga pothuajse 20 vende të OECD-së<sup>11</sup>. Përfundimet që nxori Grupi ishin pak a shumë se për të arritur një Normim më të Mirë nevojitet mbështetje politike e nivelit të lartë dhe nga të gjitha anët e qeverisë, dhënia e burimeve të duhura si dhe një politikë e qartë për Normim më të Mirë. Kjo politikë duhet të përdorë instrumente si: vlerësimi i ndikimit, ndikimit, thjeshtimi dhe konsultimi. Ajo duhet të nxisë një ndryshim në kulturën e formulimit të politikave dhe hartimit të rregulloreve.

Në raport thuhej se Normimi më i Mirë është një përpjekje për të përmirësuar procesin e hartimit të politikave nëpërmjet përdorimit të integruar të instrumenteve efektive, dhe jo një përpjekje për të imponuar barra burokratike shtesë. Raporti propozoi një Plan Veprimi, i cili u ndoq nga afër nga institucionet e BE-së, dhe përcaktoi 7 parime bazë për Normim më të Mirë. Këto parime janë: nevoja, proporcionaliteti, subsidiariteti, transparencja, përgjegjshmëria, mundësia për akses dhe thjeshtësia.

Raporti i Grupit Mandelkern u ndoq nga një Komunikatë e Komisionit Europian në vitin 2002, e cila paraqiste një sistem të ri të integruar për vlerësimin e ndikimit, udhëzimet, instrumentet të cilat ofrojnë një qasje alternative për legjislacionin (p.sh. bashkë-normim, vetë-normim), standardet minimale për konsultimin e palëve të interesuara si dhe udhëzimet për mbledhjen dhe përdorimin e këshillave të ekspertëve<sup>12</sup>.

### **Rinovimi i procesit të Lisbonës**

Nga institucionet e Bashkimit Europian është arritur përparim në secilin prej këtyre fronteve, dhe me rinovimin e strategjisë së Lisbonës në vitin 2005, u vu theksi në hartimin e një politike për Normim më të Mirë në Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian. Pas arritjes së gjysmës së fazës të procesit të Lisbonës të filluar më 2005, Komisioni vendosi të riniste nga fillimi strategjinë me fokus në zhvillim dhe vende pune, dhe në një proces të riorganizuar për të përfunduar ndjenjën e pronësisë së Shteteve Anëtare mbi programet e tyre të reformave. Zbatimi i politikës së Normimit më të Mirë është me shumë rëndësi për përpjekjet për rritjen e produktivitetit në kuadër të Strategjisë së Lisbonës. Megjithatë, Bashkimi Europian nga ana e vet nuk mund të rrisë produktivitetin dhe numrin e vendeve të punës krejt i vetëm. Edhe Shtetet Anëtare duhet të luajnë rolin e tyre, p.sh., duke hartuar e zbatuar politikën e Normimit më të Mirë dhe duke përdorur me efektivitet instrumentet e Normimit më të Mirë.

Shtetet Anëtare duhet të pranojnë se thjesht veprimet vetëm në nivel të BE-së nuk do të mjaftojnë për të arritur Normimin më të Mirë. Transpozimi nga Shtetet Anëtare i legjislacionit të BE-së dhe nismat kombëtare rregullatore kanë pasojë, jo vetëm për administratat kombëtare dhe për shtetasit, por edhe për bizneset, sidomos për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), në të gjithë Bashkimin. Për këtë arsye, hartimi dhe zbatimi i politikës së Normimit më të Mirë, është një përparësi e cila duhet trajtuar në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Lisbonës. Rëndësia e Normimit më të Mirë pasqyrohet në *Udhëzime të Integruara për Zhvillim dhe Vende Pune*<sup>13</sup>, ku thuhet se Shtetet Anëtare u rekomandohet:

“Të krijojnë një mjedis më konkurrues për biznesin dhe të nxitin iniciativën private nëpërmjet një Normimi më të Mirë, Shtetet Anëtare duhet të:

1. *pakësojnë barrën administrative që bie mbi ndërmarrjet, sidomos mbi NVM-të dhe ndërmarrjet e reja;*

<sup>11</sup> <http://www.oecd.org>

<sup>12</sup> Komisioni Europian, Plani i Veprimit – “Thjeshtimi dhe përmirësimi i mjedisit rregullator”, COM (2002) 278 final, [http://europa.eu.int/eur-lex/lex/LexUriServ/site/en/com/2002/com2002\\_0278en01.pdf](http://europa.eu.int/eur-lex/lex/LexUriServ/site/en/com/2002/com2002_0278en01.pdf); Parime të përgjithshme dhe standarde minimale për konsultimin e palëve të interesuara nga Komisioni, COM (2002) 704 final, [http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/com/2002/com2002\\_0704en01.pdf](http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/com/2002/com2002_0704en01.pdf); Komunikatë nga Komisioni mbi Vlerësimin e Ndikimit, COM (2002) 276 final, [http://ec.europa.eu/governance/impact/docs/key\\_docs/com\\_2002\\_0276\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/governance/impact/docs/key_docs/com_2002_0276_en.pdf)

<sup>13</sup> Udhëzimi Nr. 14 për periudhën 2005-08

2. rrisin cilësinë e rregulloreve ekzistuese dhe të reja, teksa ruajnë objektivat e tyre, nëpërmjet një vlerësimi sistematik dhe rigoroz të efekteve të tyre ekonomike, shoqërore (përfshirë shëndetësore) dhe mjedisore, teksa marrin në konsideratë dhe arrijnë përparim në matjen e barrës administrative që ka lidhje me normimin, si dhe efektin mbi konkurrencën, përfshirë atë që ka lidhje me zbatimin;
3. nxisin ndërmarrjet të zhvillojnë përgjegjësitë e tyre shoqërore”.

Siç u ra dakord në Këshillin European në mars 2005, Shtetet Anëtare janë të angazhuara të krijojnë nën përgjegjësinë e tyre Programe të Reformave Kombëtare (PRK) mbështetur në Udhëzimet e Integruara për Zhvillim dhe Vende Pune, të cilat përfshijnë fushat ekonomike, shoqërore dhe mjedisore. Programet e reformave duhet të drejtohen drejt nevojave të tyre dhe situatave specifike të tyre, duke lejuar lirinë e situatave dhe përparësive të politikave në nivel kombëtar. PRK-të duhet të konceptohen si dokumente politike me vizion, të cilat përcaktojnë strategjitë e tyre 3-vjeçare për të sjellë zhvillim e vende pune. Këto programe, së bashku me raportet e tyre të zbatimit, i mundësojnë Komisionit të vlerësojë politikat dhe përparimin e identifikuar nga Shtetet Anëtare.

Komisioni e ka bërë këtë në dy Raportet e tij të fundit Vjetore mbi Progresin nga janari dhe dhjetori 2006. Në raportin e tij të dytë, Komisioni nxori rekomandime specifike për vende të veçanta dhe vuri në dukje se reformat kanë filluar të japin rezultate. Në të njëjtën kohë, ai theksoi se reformat janë në një fazë të hershme dhe duhet të çohen deri në fund në mënyrë që të kenë një efekt ekonomik të qëndrueshëm.

### **Hartimi i politikës së BE-së për Normim më të Mirë**

Për të garantuar suksesin e Normimit më të Mirë dhe për të forcuar këto nisma, Komisioni prezantoi në qershor të vitit 2002 një sërë masash në fushën e Normimit më të Mirë<sup>14</sup>.

Një komunikatë e mëtejshme në vitin 2003<sup>15</sup> kishte për qëllim riorganizimin dhe thjeshtimin e mjedisit rregullator duke ulur vëllimin e legjislacionit ekzistues të Bashkimit European si dhe prezantimin e *acquis communautaire* në një mënyrë më “miqësore ndaj përdoruesve”.

Në dhjetor të vitit 2004, Ministrat e Financave dhe Çështjeve Ekonomike të gjashtë Shteteve Anëtare (Irlandës, Holandës, Luksemburgut, Mbretërisë së Bashkuar dhe Austrisë e Finlandës) nënshkruan një deklaratë që synonte t’i jepte një shtysë të re procesit të Normimit më të Mirë.

Deklarata e Përbashkët e Gjashtë Presidencave ndoqi dhe u mbështet tek Nisma e mëparshme e Përbashkët e Katër Presidencave të janarit të vitit 2004, e cila përcaktonte objektivat e këtyre Presidencave për reformën rregullatore në vitet e ardhshme.

Në mars të vitit 2005, Komisioni miratoi një komunikatë të re “*Normimi më i Mirë për Zhvillim dhe Vende Pune në Bashkimin European*”. Teksa garanton përputhje me veprimet në vazhdim për Normim më të Mirë, dhe në kuadër të strategjisë së rinovuar të Lisbonës, Komunikata propozoi tre linja kyçe për veprim:

- nxitje të mëtejshme të konceptimit dhe zbatimit të instrumentave të Normimit më të Mirë në nivel të BE-së, sidomos për sa i përket vlerësimit të ndikimit dhe thjeshtimit.
- bashkëpunim më të ngushtë me Shtetet Anëtare për t’u siguruar se parimet e Normimit më të Mirë zbatohen rregullisht në të gjithë BE-në nga të gjithë rregullatorët. Nuk mjafton vetëm veprimi në nivelin e BE-së: edhe transpozimi i legjislacionit të BE-së nga Shtetet Anëtare dhe

<sup>14</sup> COM (2002)278 final, po aty.

<sup>15</sup> Komunikata nga Komisioni për Këshillin, Parlamentin European, Komitetin Ekonomik dhe Social european si dhe Komitetin për Rajonet – Përditësimi dhe Thjeshtimi i *Acquis* të Komunitetit {SEC(2003) 165} com/2003/0071 Final

nismat rregullatore kombëtare kanë gjithashtu pasoja, jo vetëm mbi administratat kombëtare dhe shtetasit por edhe mbi bizneset, sidomos NVM-të, në të gjithë Bashkimin Europian.

- forcim të dialogut konstruktiv midis të gjithë rregullatorëve në nivel të BE-së dhe atë kombëtar, si dhe me aktorët e përfshirë.

Në përputhje me atë komunikatë, Komisioni Europian<sup>16</sup> ka:

- miratuar udhëzime të rishikuara për vlerësimin e ndikimit<sup>17</sup>;
- miratuar një Komunikatë mbi një metodologji të përbashkët për vlerësimin e kostove administrative të imponuara nga legjislacioni<sup>18</sup>;
- miratuar një Komunikatë mbi rezultatet e një vlerësimi të propozimeve të legjislacionit në pritje<sup>19</sup>;
- miratuar një Komunikatë mbi një strategji për thjeshtimin e mjedisit rregullator<sup>20</sup>;
- krijuar grupin e ekspertëve rregullatorë kombëtarë të nivelit të lartë<sup>21</sup>;

Komunikata shpreh qëllimin e politikës së Bashkimit Europian për normim më të mirë:

“Politika për Normim më të Mirë e Bashkimit Europian synon të përmirësojë normimin, rregullimin, të hartojë më mirë rregulloret për të rritur përfitimet për shtetasit, dhe të përforcojë respektimin dhe efektivitetin e rregullave, si dhe të minimizojë kostot ekonomike – në përputhje me parimet e Bashkimit Europian për proporcionalitet dhe subsidiaritetit”<sup>22</sup>.

### **Vlerësim strategjik i Normimit më të Mirë në BE<sup>23</sup>**

Më 14 nëntor të vitit 2006, Komisioni Europian paraqiti rezultatet e një vlerësimi strategjik në shkallë të gjerë të Normimit më të Mirë në BE. Procesi i vlerësimit analizon përparimin e deritanishëm dhe parashtron një grup propozimesh ambicioze.

Një prej nismave ka të bëjë me prezantimin e një strategjie ambicioze për të ulur barrën administrative të rregulloreve ekzistuese. Komisioni Evropian ka paraqitur një propozim për të pakësuar, së bashku me Shtetet Anëtare, barrën administrative për kompanitë me 25% deri në vitin 2012.

Sipas tyre kjo do të çonte në një rritje prej 1.5% të PPB-së së BE-së dhe do të sillte si rrjedhojë më shumë investime për zhvillim dhe vende të reja pune, që arrinin në rreth 150 miliardë euro. Për të arritur këtë objektiv, Shtetet Anëtare dhe autoritetet rajonale e vendore duhet t’u japin edhe një shtytje të re politike përpjekjeve të tyre për të ulur nivelin e burokracisë.

---

<sup>16</sup>[COM(2005)97 final], [http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/com/2005/com2005\\_0097en01.pdf](http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/com/2005/com2005_0097en01.pdf). Shih gjithashtu raportet nga Komisioni mbi Ligjbërje më të Mirë 2005, psh, (raporti i 13<sup>-të</sup>), COM (2006) 289 Final, [http://ec.europa.eu/governance/impact/docs/SEC2005\\_791\\_IA%20guidelines\\_annexes.pdf](http://ec.europa.eu/governance/impact/docs/SEC2005_791_IA%20guidelines_annexes.pdf)

<sup>17</sup> SEC (2005) 791, [http://ec.europa.eu/governance/impact/docs/SEC2005\\_791\\_IA%20guidelines\\_annexes.pdf](http://ec.europa.eu/governance/impact/docs/SEC2005_791_IA%20guidelines_annexes.pdf).

<sup>18</sup> COM (2005) 518 final, [http://ec.europa.eu/governance/impact/docs/key\\_docs/com\\_2005\\_0518\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/governance/impact/docs/key_docs/com_2005_0518_en.pdf)

<sup>19</sup> COM (2005) 462 final, [http://ec.europa.eu/enterprise/regulation/better\\_regulation/docs/en\\_br\\_final.pdf](http://ec.europa.eu/enterprise/regulation/better_regulation/docs/en_br_final.pdf).

<sup>20</sup> COM (2005) 535 final, [http://ec.europa.eu/enterprise/regulation/better\\_regulation/docs/simplification/COMM\\_PDF\\_COM\\_2005\\_0535\\_F\\_EN\\_AC\\_TE.pdf](http://ec.europa.eu/enterprise/regulation/better_regulation/docs/simplification/COMM_PDF_COM_2005_0535_F_EN_AC_TE.pdf).

<sup>21</sup> Detyra e grupit është të këshillojë Komisionin mbi çështjet e Normimit më të Mirë në përgjithësi dhe të ofrojë një kufi eficient ndërmjet Komisionit dhe autoriteteve kryesore të qeverisë për zhvillimin e normimit më të mirë në nivel të BE-së dhe nivel kombëtar.

<sup>22</sup> Shih faqen 2 [COM (2005) 97 final], po aty.

<sup>23</sup> COM (2006) 689, [http://ec.europa.eu/enterprise/regulation/better\\_regulation/docs/en\\_689.pdf](http://ec.europa.eu/enterprise/regulation/better_regulation/docs/en_689.pdf).

Në mars të vitit 2007, Këshilli European i Pranverës theksoi se **ulja e barrave administrative** është një masë e rëndësishme për të zhvilluar ekonominë e Europës, sidomos nëpërmjet efektit të saj mbi NVM-të, dhe se është e nevojshme një përpjekje e përbashkët e fuqishme. Për këtë arsye u ra dakord se barrat administrative që rrjedhin nga legjislacioni i BE-së duhet të ulen me 25% deri në vitin 2012. Ai gjithashtu ftoi Shtetet Anëtare që duke marrë në konsideratë pikënisjet dhe traditat e tyre, të përcaktojnë objektivat e veta kombëtare, me ambicie të ngjashme brenda fushave të tyre të ekspertizës deri në vitin 2008.

Gjithashtu, sistemi për vlerësimin e ndikimit të të gjitha propozimeve të reja kryesore për legjislacion do të përmirësohet, në mënyrë që të garantojë cilësi dhe objektivitet përmes krijimit të një Bordi për Vlerësimin e Ndikimit. Për më tepër, programit aktual të thjeshtimit për periudhën 2006-2009 i janë shtuar 43 nisma të reja. Këto nisma janë në një spektër të gjerë fushash të politikave.

Më 17 mars 2006, Komisioni konfirmoi qëllimin e tij për të tërhequr 67<sup>24</sup> propozimet si një rezultat i vlerësimit të 183 propozimeve për ligjet e BE-së që prisnin miratimin nga Parlamenti dhe Këshilli European. Lista e propozimeve të tërhequra u publikua në Fletoren Zyrtare<sup>25</sup>. Këto propozime u tërhoqën pasi disa prej tyre nuk ishin në përputhje me objektivat e “Partneritetit për Zhvillim dhe Vende Pune” ose sepse nuk plotësonin standardet e normimit më të mirë. Të tjerat nuk kishin ecur përpara në procesin legjislativ, ose thjesht ishin të vjetruara.

Në vitin 2006 u shqyrtuan 79 propozime të miratuara nga Komisioni mes 1 janarit dhe 21 nëntorit 2004, duke përdorur të njëjtat kritere. Rezultatet përfundimtare u publikuan në Komunikatën për Vlerësimin Strategjik. Komisioni informoi Parlamentin dhe Këshillin siç i kërkohej, duke dhënë dhe arsyet e tërheqjes së 10 propozimeve në total<sup>26</sup>. Për shkak se kaloi një kohë e konsiderueshme pa reagim nga asnjëra palë, lista e tërheqjeve u publikua në fletoren zyrtare të 22 marsit 2007.

---

<sup>24</sup> Propozimi 2003/0160/AVC i përfshirë mes 68 propozimeve të përzgjedhura fillimisht për tu tërhequr u miratua nga Legjislatori dhe për rrjedhojë u hoq nga kjo listë.

<sup>25</sup> [OJ C 64 of 17.03.2006](#).

<sup>26</sup> Marrëveshja Kuadër e 26 majit 2005 mbi marrëdhëniet ndërmjet Parlamentit European dhe Komisionit (paragrafi 32).

### 3. MENAXHIMI RREGULLATOR

*Ky seksion merr në shqyrtim menaxhimin rregullator në Shtetet e Reja Anëtare.*

*Menaxhimi rregullator është procesi me anë të të cilit problemet me të cilat përballet një vend përzgjidhen për analizë të politikave, vendim dhe hartim/kthim në legjislacion. Vendimi për të formuluar politika dhe hartuar legjislacion merret nga qeveria ose një ministër, nëse është deleguar për ta bërë këtë. Pra, ky kapitull përqendrohet tek procesi i menaxhimit rregullator.*

#### Hyrje

Në disa vende dhe në institucionet e Bashkimit Europian, parimet në të cilat mbështetet menaxhimi rregullator shprehen në një dokument të qartë të politikave të konceptuar për të sjellë përmirësime në formulimin e politikave dhe në hartimin, futjen në fuqi dhe zbatimin e legjislacionit.

Treguesit kryesorë të një politike të menaxhimit rregullator përfshijnë:

- një politikë për Normim më të Mirë
- strategji për veprim dhe një proces për vendosjen e përparësive
- proces koherent dhe të rregullt për të formuluar politikë dhe hartuar legjislacion
- garantimin e cilësisë
- një numër të mjaftueshëm personeli të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme.

#### Politika për Normimin më të Mirë

##### *Politikë e qartë për Normim më të Mirë*

Gjatë vlerësimit të SHRA-ve, një numër i SHRA-ve filluan të hartonin një politikë të qartë mbi Normimin më të Mirë. Këtu përfshihej **Lituania, Malta, Polonia** dhe **Silovenia**. Në disa vende, nga koha e fillimit të projektit dhe përfundimit të raporteve të disa vendeve të caktuara, qeveritë në fjalë kishin krijuar programe reformash që i referoheshin qartë Normimit më të Mirë në kuadër të Strategjisë së Lisbonës.

Në **Republikën Çeke**, qeveria, edhe gjatë kohës kur po përmirësohej raporti, kishte zhvilluar një politikë që në përgjithësi ishte e ngjashme me politikën e BE-së për Normim më të Mirë. U miratua një Rezolutë e qeverisë<sup>27</sup> për Uljen e Barrës Administrative mbi bizneset. Kjo Rezolutë përfshin një Plan Veprimi për Uljen e Barrës Administrative mbi bizneset si dhe për Metodologjinë e Matjes së Barrës Administrative, mbështetur në Modelin Holandez të Kostos Standarde<sup>28</sup>.

**Polonia** ka ndërtuar një program mbresëlënës që pasqyron një rreze të gjerë ndikimesh. Përparësitë për programin e saj të reformës për Normim më të Mirë janë:

- identifikimi dhe zbatimi i zgjidhjeve legjislative për thjeshtimin e masave rregullatore vendase dhe të *acquis communautaire*.
- përmirësimi i sistemit të transferimit të direktivave të BE-së.

<sup>27</sup> Nr. 421/2005.

<sup>28</sup> Shih edhe Manualin e Modelit të Kostos Standarte në faqet 6 dhe 7 [www.administratievelasten.nl/default.asp?](http://www.administratievelasten.nl/default.asp?)

- ulja e barrave administrative.
- përmirësimi i sistemit VER.
- forcimi i kapaciteteve të qeverisë për menaxhim rregullator.

### ***Politikë e nënkuptuar për normim më të mirë***

Në **Hungari** dhe **Republikën Sllovaqe** mund të shihet një politikë për Normim më të Mirë nga një studim i praktikave të qeverisjes. Ekzistojnë disa instrumente për Normim më të Mirë. Politika parashikon mënyrën me të cilën formulohen politika dhe hartohet legjislacioni, dhe kjo bëhet kryesisht përkatësisht në Urdhrin për Organizimin e Zyrës së Qeverisë së **Republikës Sllovaqe** dhe në Ligjin e vitit 1987 për Legjislacionin në **Hungari**.

Në **Lituani**, Strategjia për Zhvillimin e Administratës Publike<sup>29</sup> theksonte se përparësi do t'i jepet fushave dhe veprimtarive të përmendura në Programin Afatmesëm 2004-2005, të miratuar nga Ministrat e BE-së të Administratës Publike. Një prej fushave të përmendura është *Normimi më i Mirë*. Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për vitin 2005-2006<sup>30</sup> përmban veprimet e planifikuara për të thjeshtuar procedurat e vendimmarrjes. Në **Lituani** ka pasur zhvillime të tjera që nga kryerja e vlerësimit, dhe në kohën kur shkruhej ky raport po hartohej një politikë e qartë për Normim më të Mirë.

Në **Letoni**, Normimi më i Mirë përmendet në planin e Zhvillimit Kombëtar 2007-2013 si një fushë me përparësi<sup>31</sup>.

Në vende të tjera, i referohet në mënyrë të nënkuptuar politikës së Normimit më të Mirë në shumë aspekte të menaxhimit të veprimtarive qeverisëse.

Të gjitha SHRA-të marrin pjesë në grupe ekspertësh për Normim më të Mirë. Këto përfshijnë Grupin e Nivelit të Lartë për Normim më të Mirë, i krijuar nga Komisioni Europian<sup>32</sup>, Drejtorët e Normimit më të Mirë<sup>33</sup>, dhe, sipas rastit, Grupi i Punës i OECD-së mbi menaxhimin rregullator. Disa vende, si p.sh. Polonia, kanë marrë pjesë në veprimtari standardizimi për të shkëmbyer praktika dhe përfituar nga përvoja e vendeve anëtare të OECD-së apo e shteteve anëtare të BE-së që kanë krijuar tashmë politika për Normim më të Mirë. Shumë prej vendeve të studiuara (**Republika Çeke, Qipro, Estonia, Hungaria, Letonia, dhe Polonia**) janë anëtare të Rrjetit për Modele të Kostos Standarde: komiteti drejtues<sup>34</sup>.

### ***Mbështetje politike për Normim më të Mirë***

Një prej faktorëve kyç për suksesin e Normimit më të Mirë është mbështetja politike. Ky faktor përmendet shpesh në raportet e OECD-së<sup>35</sup> dhe mbështetja politike për Normim më të Mirë në institucionet e Bashkimit Europian shpesh mbështetet në fjalime nga Komisionerë dhe zyrtarë të lartë dhe tani po shtrihet në fusha më specifike të politikave, si p.sh. një lëvizje për të thjeshtuar Politikën e Përbashkët Bujqësore<sup>36</sup>.

<sup>29</sup> 2004-2010, e miratuar nga qeveria e Lituaniës, Rezoluta Nr. 488 (*Fletorja Zyrtare, Nr. 69-2399*).

<sup>30</sup> Rezoluta Nr. 197 (*Fletorja Zyrtare 2005, Nr. 26-830*).

<sup>31</sup> Sipas terminologjisë të përdorur në Letoni deri në vitin 2006, veprimtaritë e Normimit më të Mirë kryheshin nën termin "vlerësimi i ndikimit".

<sup>32</sup> Vendimi i Komisionit i 28 shkurtit 2006 që krijonte një grup ekspertësh rregullatorë kombëtarë të nivelit të lartë (2006/210/EU).

<sup>33</sup> Grupi i ekspertëve kombëtarë që kryejnë punë për Normim më të Mirë në secilin Shtet Anëtar takohet dy herë në vit për të shkëmbyer informacion.

<sup>34</sup> Shih shënimet 107 dhe 108.

<sup>35</sup> Shih sidomos OECD (1997), *Analiza e Ndikimit Rregullator. Praktikat më të mira në vendet e OECD-ës*, Paris; *Rivlerësimi i reformës rregullatore*, 2005.

<sup>36</sup> Shih [http://europa.eu/agriculture/simplification/index\\_en.htm](http://europa.eu/agriculture/simplification/index_en.htm) dhe dokumenta të tjera nga konferenca për këtë temë.



Përgjegjësia për politikat e Normimit më të Mirë i besohet ministrive të ndryshme në vende të ndryshme. Tabela më poshtë jep një tablo të mënyrës si shpërndahe përgjegjësia për Normim më të Mirë në SHRA-të.

Shteti i Ri Anëtar	Ministria
Qipro	Ministria e Financave
Republika Çeke	Ministria e Brendshme <sup>37</sup>
Estonia <sup>38</sup>	Ministria e Drejtësisë
Letonia <sup>39</sup>	Ndahet mes Kancelarisë së Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, dhe Ministria e Ekonomisë ka përgjegjësi për sipërmarrësit.
Lituania	Ministria e Ekonomisë
Malta	Zyra e Kryeministrit
Polonia	Ministria e Ekonomisë
Republika Sllovaqe	Ministria e Ekonomisë
Sllovenia	Ministria e Administratës Publike

Problemi, i thënë shkurt nga një figurë politike në **Republikën Sllovaqe**, është se rezultatet nga Normimi më i Mirë janë tepër abstrakte për të dhënë vlerësime të qarta politike. Nga ana tjetër, dështimet rregullatore janë shumë të dukshme. Nëse një ministër merr përgjegjësi për Normim më të Mirë por gjërat shkojnë keq, ai shihet si fajtor. Nëse gjërat shkojnë mirë, nuk do të jenë të paktë kandidatët që do të pretendojnë se është suksesi i tyre.

#### *Programet qeveritare dhe dokumentet e ngjashme*

Mbështetje politike specifike për llojet e politikave të Normimit më të Mirë mund të gjenden edhe në deklaratat e qeverisë apo programet kombëtare të reformave. Këto kanë prirje të jenë formula. Pa afate kohore të shprehura qartë apo rezultate të përcaktuara, vlera e tyre është e dyshimtë.

*Programi Kombëtar për Reforma i Republikës së Qipros* ka përcaktuar përparësitë për zbatimin e një reforme të menaxhimit rregullator. Në atë rast, përparësi në atë program i ishte dhënë zhvillimit të një politike mbi vlerësimin e ndikimit dhe uljes së barrës rregullatore dhe administrative.

Në **Estoni**, Marrëveshja e Koalicionit të vitit 2003 përmendi vlerësimin e ndikimit të normimit dhe propozoi që të vlerësohej ndikimi i secilës projekt-rregulloreje mbi zhvillimin ekonomik dhe situatën demografike. Një përparësi tjetër e përmendur në atë Marrëveshje ishte politika e propozuar për të thjeshtuar rregullat për hapjen e bizneseve dhe nevojën për të analizuar rregulloret që kufizojnë veprimtaritë e biznesit në mënyrë të panevojshme. Marrëveshja e koalicionit aktual në Estoni i referohet nevojës për të thjeshtuar procedurat në lidhje me marrëdhëniet pushtet vendor-biznese.

Në **Republikën Çeke**, angazhimet e marra për të zbatuar axhendën e Normimit më të Mirë, sidomos në lidhje me vlerësimet e integruara të ndikimit dhe uljen e barrës administrative mbi bizneset, u rimorën në *Programin Kombëtar të Reformave të Republikës Çeke (2005-2008)* dhe në *Strategjinë për Zhvillimin Ekonomik në Republikën Çeke*.

<sup>37</sup> Në Republikën Çeke, përgjegjësia për Normim më të Mirë u transferua nga Zyra e Qeverisë tek Ministria e Brendshme me vendim qeverie në tetor të vitit 2006.

<sup>38</sup> Megjithatë, përveç Ministrisë së Drejtësisë përfshihen edhe ministri të tjera.

<sup>39</sup> Zbatimi i politikës së Normimit më të Mirë në Letoni i mbetet Kancelarisë së Shtetit. Megjithatë, edhe ministri të tjera, si p.sh. Ministria e Drejtësisë, ajo e Financave dhe ajo e Ekonomisë janë gjithashtu të përfshira.

Në **Hungari**, programi i vitit 2006 për qeverinë: *Hungaria e re – Liri dhe Solidaritet: Programi i Qeverisë së Hungarisë për një Hungari të Suksesshme, Moderne dhe të Drejtë* (2006-2010)<sup>40</sup> shpreh angazhimin e Hungarisë për përparim dhe pranon numrin në rritje të ndërmarrjeve të vogla e të mesme si dhe nevojën për të thjeshtuar një numër ligjesh për të lehtësuar konkurrueshmërinë e bizneseve të vogla.

Në **Letoni**, Deklarata e Qeverisë, një dokument i rëndësishëm i politikave kombëtare, përfshin një angazhim për të përmirësuar konkurrueshmërinë<sup>41</sup> dhe identifikon një sërë çështjesh të politikave që janë karakteristike të politikës së Normimit më të Mirë. Këtu përfshihet sidomos “thjeshtimi i vendimmarrjes” në lidhje me bizneset e vogla<sup>42</sup>.

Në **Maltë**, një skicë e përgjithshme e një politike për Normim më të Mirë përcaktohet në “Programin Kombëtar të Reformave: *Strategjia e Maltës për zhvillim dhe vende pune për periudhën 2005-2008*”<sup>43</sup>. Përveç kësaj, edhe dokumenti i projekt-buxhetit për vitet 2006-2010 diskuton gjithashtu reformën rregullatore dhe nevojën për të ulur barrën rregullatore mbi bizneset.

Në **Republikën Sllovaqe**, mbështetja për zbatimin e politikës së Normimit më të Mirë mund të gjendet në Programin Kombëtar për Reforma të Republikës Sllovaqe (2006 – 2008) dhe në dokumentin *Strategjia e Konkurrueshmërisë në Sllovaki deri në vitin 2010 – Strategjia Kombëtare e Lisbonës*, e cila prezanton katër përparësitë më të mëdha të qeverisë sllovaqe, njëra prej të cilave është rritja e cilësisë së mjedisit të biznesit.

#### ***Strukturat për zbatimin e një politike të Normimit më të Mirë (SHRA)***

Politika e Normimit më të Mirë ka më shumë mundësi të jetë efektive kur ekziston një strukturë për ta zbatuar atë. Mund të shihen tre qasje kryesore për krijimin e strukturave për të zbatuar politikën e Normimit më të Mirë: një task forcë, një person apo një organ qendror bashkërendues, ose një kombinim i këtyre dy qasjeve.

#### ***Task forca***

Në **Qipro**, një grup përfaqësues i një grupi të madh ministrish dhe interesash është caktuar të hartojë një politikë mbi vlerësimin e ndikimit dhe të përcaktojë se çfarë aspektesh të tjera të politikës së Normimit më të Mirë mund të zhvillohen. Në **Poloni**, një grup ndërministror (Task Forca për reformën rregullatore moderne në fushën e ekonomisë) u krijua në shkurt të vitit 2006 për të hartuar politikën në mënyrë që të mund të dërgohej për miratim tek Këshilli i Ministrave. Kjo Task Forcë do të vazhdojë punën e bërë nga ekipi i caktuar në vitin 2000 (Ekipi ndërministror për cilësinë rregullatore) dhe do të trajtojë çështje të ngjashme, por më shumë e përqëndruar në përmirësimin e mjedisit rregullator për biznesin dhe përdorimin më me efektivitet të instrumentave rregullatore. Në **Slloveni** është krijuar një grup pune ndërministror për të hartuar dhe menaxhuar një politikë për një reformë më të mirë rregullatore.

#### ***Një person apo organ qendror bashkërendues***

Në **Estoni**, përgjegjësia për politikën e reformës rregullatore është shpërndarë tek Ministria e Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Çështjeve Sociale dhe Ministria e Mjedisit. Megjithatë, një punonjëse është përgjegjësjë kryesore për marrjen dhe shpërndarjen e informacionit mbi politikën e reformës rregullatore. Ajo merr pjesë në takime ndërkombëtare mbi çështje të Normimit më të Mirë dhe siguron që informacioni mbi zhvillimet ndërkombëtare t’i përcillet pjesës tjetër të shërbimit publik.

Në **Republikën Çeke**, një njësi e Normimit më të Mirë (reformës rregullatore) u krijua brenda Departamentit për reforma në pushtetin qendror dhe reformën rregullatore të Zyrës së Qeverisë. Që nga nëntori i vitit 2006 kjo njësi ka kaluar tek Ministria e Brendshme. Ajo është përgjegjëse për

<sup>40</sup>[www.miniszterelnok.hu/domain2/files/modules/module15/1461461FB7EDBA8C3.pdf](http://www.miniszterelnok.hu/domain2/files/modules/module15/1461461FB7EDBA8C3.pdf).

<sup>41</sup>Deklarata e Këshillit të Ministrave, 1 dhjetor 2004. Deklarata është baza e punës së qeverisë. Shih më poshtë në tekst.

<sup>42</sup>Deklarata e Këshillit të Ministrave, 1 dhjetor 2004; [www.mk.gov.lv](http://www.mk.gov.lv).

<sup>43</sup>Paragrafi 14.3.

bashkërendimin e Reformës Rregullatore në të gjithë administratën shtetërore si dhe për përgatitjen e dokumenteve strategjike në këtë fushë.

Në **Hungari** është krijuar një departament i pavarur në Ministrinë e Drejtësisë, i quajtur Departamenti i analizës së ndikimit, rregullimit dhe regjistrimit të ligjit, për të dhënë mbështetje profesionale për legjislacion cilësor dhe për të përmirësuar cilësinë e vlerësimit të ndikimit. Megjithatë, kjo njësi u shpërbë në korrik 2006 si pjesë e shkurtimeve të sektorit publik. Funksionet e saj iu transferuan pjesërisht një sektori tjetër të Ministrisë së Drejtësisë.

Në **Letoni**, Departamenti i Kancelarisë së Shtetit për Bashkërendimin e Politikave është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe sistemit të planifikimit strategjik, ku përfshihet dhe politika për reformën rregullatore. Këto të fundit përgatiten në bashkëpunim me ministrinë e linjës, të cilat kanë përgjegjësi për kontrollin e cilësisë së vlerësimit të ndikimit, në përputhje me fushat përkatëse të kompetencave.

Në **Maltë**, Normimi më i Mirë është përgjegjësi e njësisë së reformës rregullatore brenda Njesisë së Eficiencës së Menaxhimit (NEM). NEM-i vepron brenda Zyrës së Kryeministrit dhe luan një rol unik si këshilltare e brendshme e qeverisë për menaxhimin. Ajo ka fituar disa përvoja në vlerësimin e ndikimit. Njësia e Normimit më të Mirë e krijuar në dhjetor të vitit 2005 në Maltë është pjesë e NEM-it dhe si rrjedhojë edhe e Zyrës së Kryeministrit. Mandati i kësaj njësie është monitorimi i zhvillimeve rregullatore dhe pakësimi i burokracive të panevojshme.

#### *Një kombinim i këtyre qasjeve*

Në **Poloni**, në shkurt të vitit 2006 u krijua një grup pune ndërministror (Task Forca për reformën rregullatore moderne në fushën e ekonomisë) për të hartuar politikën për Normimin më të Mirë, në mënyrë që të dorëzohet për miratim tek Këshilli i Ministrave. Ka gjithashtu një Departament të fortë, të menaxhuar mirë në Ministrinë e Ekonomisë, dhe kompetenca shtesë iu dhanë dhe Zyrës së Kryeministrit për të mbikëqyrur vlerësimet e ndikimeve. Gjithashtu është propozuar caktimi i një punonjësi në çdo ministri përgjegjës për reformën rregullatore.

Modeli polak pasqyron nevojën për të pasur në fuqi mekanizma bashkërendimi. Po ashtu, pranohet nevoja për të ndarë përgjegjësitë për zbatimin e politikës për reforma rregullatore me ministrinë e linjës, në mënyrë që të krijohet një ndjenjë përgjegjësie tek të gjithë nëpunësit shtetërorë për Normim më të Mirë.

#### **Strategjia për veprim dhe procesi i vendosjes së prioriteteve**

Qeveria është një grup institucionesh përgjegjëse për formulimin e politikave dhe marrjen e vendimeve të përbashkëta për shoqërinë. Këto vendime mund të merren në përputhje me një plan fiks, të centralizuar, një plan elastik, strategjik ose vendimet mund të merren *ad hoc* pa ndonjë planifikim, duke reaguar ndaj rrethanave që lindin. Të gjitha SHRA-të veprojnë me një përzierje të këtyre masave rregullatore. Qeveritë zakonisht vijnë në pushtet me një plan, i cili është një version i politikave, platformave të negociuara të cilat përshtaten me nevojat e një partneri në koalicion.

Planet qeveritare, ose strategjitë për të identifikuar problemet për veprim, duhet të përforcohen me tre elemente kryesore: një grup të qartë të përparësive në politika, procedura dhe institucione planifikimi të përfshira në bashkërendimin e planifikimit dhe procesin e zgjidhjes së konflikteve, kur ato ekzistojnë. Kjo e fundit është shumë e rëndësishme kur ka koalicione.

#### *Përparësitë në politika*

Në të gjitha SHRA-të, zbatimi i të drejtës europiane konsiderohet si përparësia më e lartë. Niveli tjetër i përparësisë janë programet qeveritare. **Litania** është rast unik pasi ka një strategji në vend që është në fuqi pavarësisht partive politike në fuqi.

Në **Letoni**, strategjitë dominuese janë përcaktuar në Deklaratën e qeverisë dhe në një strategji për ekonominë kombëtare.

Në **Republikën Sllovaqe**, plani strategjik i përgjithshëm për veprimtaritë e politikave përcaktohet në Programin e qeverisë sllovaqe. Kjo formë qasjeje është shumë e ngjashme për të gjitha vendet.

### **Procesi i planifikimit**

Një proces i planifikimit të politikave i strukturuar mirë është pjesë thelbësore e menaxhimit rregullator. Ai garanton që zbatohet strategjia e qeverisë për veprim të përbashkët. Përparësitë mund të identifikohen fillimisht nga qeveria, mbështetur në programet politike, ose mund të dalin si rrjedhojë e një procedure administrative të planifikimit. Dokumente kryesore të politikave ekzistojnë në të gjitha SHRA-të, megjithëse qasja për hartimin e tyre ndryshon, dhe shkalla në të cilën ato respektohen varet nga faktorë të tillë si disiplina e partisë brenda qeverisë.

Në **Hungari, Poloni, dhe Republikën Sllovaqe** disiplina në parti është e dobët dhe planifikimi është akoma më pak efektiv. Shpesh sillen amendamente dhe projektligje me propozime për politika të cilat e largojnë axhendën kombëtare nga plani i saj i përgjithshëm. Në këto vende, projekt-ligjet apo amendamentet mund të propozohen edhe nga anëtarë të së njëjtës parti që ka krijuar qeverinë. Kjo rrit paparashikueshmërinë e legjislacionit si dhe shtrembëron procesin e planifikimit.

Në **Republikën Çeke**, përparësitë e planifikimit identifikohen në sajë të dy proceseve. Përgatitet një Dokument për politikën e qeverisë, në bazë të një liste me përparësitë strategjike për legjislaturën e ardhshme katër vjeçare, e cila pasqyron përparësitë e përzgjedhura nga çdo ministri për fushën e saj të përgjegjësisë. Gjithashtu, Zyra e Qeverisë përgatit *Planin vjetor të veprimeve legjislative të qeverisë*, dhe *Planin vjetor të veprimeve jolegjislative të qeverisë*, mbështetur në Deklaratën e Politikave të Qeverisë, dhe miratohen nga qeveria çdo vit. Në **Sloveni** ndiqet i njëjti proces që ndan planet strategjike nga plani më taktik, dyvjeçar i buxhetit, si dhe plani legjislativ vjetor.

Në **Hungari** përparësitë e politikave vendosen kryesisht mbështetur në programin qeveritar (nxjerrë nga programet e partisë) ose janë rrjedhojë e çështjeve që dalin çdo ditë. Gjithashtu, çdo ministri ka një program që shpjegon me shumë hollësi qasjen e saj për zbatimin e programit të qeverisë. Gjithashtu ka dhe një plan gjashtë mujor për legjislacionin e cila përcakton programin legjislativ të qeverisë. Në Hungari, në praktikë, një sistem politik dinamik nxjerr çështje që zakonisht nuk parashikohen nga planet e tjera, dhe deri në 50% e rezultateve legjislative dalin nga propozime që nuk janë përfshirë në programin e qeverisë.

Në **Lituani**, këto plane përfshijnë planifikim afatgjatë (më shumë se 7 vjet), afatmesëm (3-7 vjet) dhe afatshkurtër (1-3 vjet). Ai vepron nga poshtë lart dhe nga lart poshtë. Strategjia afatgjatë për zhvillimin e vendit është në majë të piramidës së dokumenteve të ndryshëm të planifikimit dhe shërben si bazë për hartimin e strategjive sektorale për 3-7 vjet. Dhe e anasjellta, strategjitë sektorale mund të sjellin ndryshime në Strategjinë afatgjatë për zhvillimin e vendit.

Kur përgatisin planet e tyre strategjike tre vjeçare, ministrinë dhe institucionet e tjera publike marrin parasysh objektivat e përcaktuara në strategjitë sektorale. Planin i Veprimit për të vënë në zbatim Programin e Qeverisë, miratuar nga qeveria e sapoformuar, brenda tre muajve nga miratimi i Programit të Qeverisë, rendit veprimet specifike të qeverisë që do të ndërmerren brenda një periudhe katër vjeçare nga publikimi i tij. Forca e procesit të planifikimit qëndron në faktin se pavarësisht qeverisë që është në fuqi, ka një vazhdimësi të strategjisë për sa i përket synimeve kombëtare, përfshirë objektivat e menaxhimit rregullator. Në çdo nivel të procesit të planifikimit ka një nivel të lartë transparence, nga plani i madh për qeverinë në përgjithësi deri tek planet e vogla të departamenteve brenda ministrive, të cilët gjithashtu kanë plane për të vënë në zbatim objektivat e këtyre ministrive.

Në **Malte**<sup>44</sup> dalin propozime nga konsultimet me departamentet, agjencitë dhe komisionet, dhe përparësitë përcaktohen rast pas rasti, në varësi të rëndësisë dhe urgjencës së çështjes.

<sup>44</sup> Malta ka 3 dokumenta kryesore të politikave: “NJë cilësi më e mirë e jetës: Dokumenti mbi projekt-buxhetin për vitet 2006-2010” dhe “Programi Kombëtar i Reformave: Strategjia e Maltës për zhvillim dhe vende pune për periudhën 2005-2008 – Dokument për konsultim me publikun”, dhe “Referenca Strategjike Kombëtare”, e cila u hartua për të trajtuar çështjet në lidhje me shpërndarjen e Fondeve Strukturore “Objektivi Një”

Në **Republikën Sllovake**, planifikimi strategjik për veprimtaritë e politikave përcaktohet në Deklaratën e Programit të Qeverisë Sllovake, si një instrument makro, dhe në Planin për Detyrat Legjislative të Qeverisë, si një instrument mikro. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm propozimesh legjislative mbështetet në propozime që vijnë nga jashtë qeverisë. Këtu mund të përfshihen propozime të bëra nga anëtarë të partisë politike në pushtet.

### *Një strukturë efektive për të bashkërenduar planifikimin e politikave*

Efiçenca e një sistemi për planifikimin e politikave forcohet sa herë që një organ apo ministri merr përsipër përgjegjësi për të bashkërenduar planifikimin e politikave, por bashkërendimi në qendër të qeverisë duhet të jetë efektiv.

Në **Qipro**, përgjegjësia për planifikimin e veprimtarive strategjike dhe të politikave të zhvillimit i është besuar Zyrës së Planifikimit të Qipros. Planifikimi i nismave të tjera për politika bëhet nga ministrinë e veçanta. Zyra e Planifikimit u krijua me vendim të Këshillit të Ministrave dhe i raporton Ministrin të Financave. Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, ajo është përgjegjëse për planet strategjike 5 vjeçare që përcaktojnë të gjitha projektet për zhvillim, si dhe bashkërendon procedurat e planifikimit në të gjithë vendin.

Në **Letoni**, planifikimi i veprimeve të qeverisë, në kohën e vlerësimit nga Sigma, menaxhohej nga Departamenti i Bashkërendimit të Politikave në Kancelarinë e Shtetit.

Në **Lituani** përparësitë e qeverisë zakonisht përcaktohen në muajin mars, bashkë me procesin e formimit të buxhetit. Kur hartohen politika ndërsektoriale për të zbatuar përparësitë, të gjitha dokumentet e nevojshme të politikave duhet të diskutohen me palët dhe institucionet e interesuara. Pjesa më e madhe e dokumenteve strategjike diskutohen nga Komiteti Qeveritar për Planifikimin Strategjik, përpara se të miratohen nga qeveria. Ai është një platformë për vlerësimin e politikave si dhe një format i përshtatshëm për të ndërmjetësuar dhe zgjidhur çështjet e diskutueshme, si dhe për të bashkërenduar përparësitë.

### *Procedurat për të zgjidhur konfliktet mes përparësive*

Për të garantuar një menaxhim rregullator të saktë nevojitet një strategji e qartë për të identifikuar problemet e veprimit të përbashkët si dhe një proces përparësish i një politike apo ndërhyrjeje rregullatore.

Faktori vendimtar për zgjidhjen e konflikteve mes përparësive politike është shpesh shkalla në të cilën propozimet duhet të jenë brenda kufijve buxhetorë. Për shembull, në **Qipro** përparësi i jepet politikave të cilave u është caktuar buxhet brenda buxhetit vjetor. Në **Hungari**, Ministria e Financave ka marrë rolin e një ministrie të rëndësishme, që në kohën e reformave gjithëpërfshirëse në sistemin e buxhetimit publik që ndodhën në Hungari në vitet 1990. Në **Letoni** prioritetet afatmesme qeveritare përcaktohen me vendim qeverie. Në **Maltë**, ndryshimet në mendime midis të ministrive të ndryshme për sa i përket përparësive apo vendosjen e fondeve/burimeve zgjidhen në mënyrë dypalëshe apo në konsultim me Ministrinë e Financave.

Në të gjitha SHRA-të, konfliktet që nuk mund të zgjidhen në nivel ministrie e që kanë lidhje me planifikimin dhe prioritizimin e çështjeve të politikave, dorëzohen në mbledhje të qeverisë (Këshillit të Ministrave) për t'u zgjidhur. Autoriteti përfundimtar për të arbitruar dhe zgjidhur mosmarrëveshjet ndryshon në bazë të strukturës kushtetuese të vendit në fjalë. Ky funksion kryhet nga Presidenti i Republikës (**Qipro**) apo Kryeministri (**Lituani**). Në të gjitha SHRA-të, autoriteti përkatës, qoftë Presidenti apo Kryeministri, merr rregullisht raporte mbi përparimin dhe mbikëqyr hartimin dhe zbatimin e planeve.

Në **Republikën Çeke**, qeveria përfaqëson mekanizmin bashkërendues më të rëndësishëm në nivel të administratës shtetërore qendrore. Nëse nuk arrihet dot zgjidhja e një çështjeje të caktuar nga një nivel më i ulët, ajo ngrihet në nivel të zëvendësministrave dhe pastaj i paraqitet Kabinetit si një "çështje e pazgjidhur", nëse mosmarrëveshja vazhdon. Pastaj ky i fundit merr vendimin në lidhje me këto çështje.

Në **Hungari**, në vitin 2000, në Zyrën e Kryeministrit u krijua një sistem i ri i bashkërendimit të politikave, i quajtur Referatura. Ky organ i posaçëm, sipas modelit të atij që ekziston në Kancelarinë gjermane, përbëhet nga një grup ekspertësh të cilët ndjekin veprimtaritë e çdo ministrie. Bashkë me një jurist nga

Departamenti Ligjor i Zyrës së Kryeministrit, ata përgatisin një dokument të përbashkët mbi të gjitha dokumentet e dorëzuara. Dokumenti i përbashkët përshkruan propozimin, rezultatit e konsultimeve ndërministrrore, çështjet e pazgjidhura dhe propozimet për përmirësim.

Në **Letoni**, projekt-dokumentet kryesore të politikave dhe projekt-rregulloret kryesore, për të cilat është ngritur një grup pune i posaçëm<sup>45</sup>, qarkullohen nëpër ministri përpara se të dorëzohen në takimin javor të Sekretarëve të Shtetit (punonjësit civilë të rangut më të lartë në të gjitha ministrinë). Në bazë të Rregullave të Procedurës së Qeverisë, përgatitet një përmbledhje me të gjitha propozimet e ministrive, përfshirë argumentet për miratimin apo refuzimin e çdo propozimi, dhe kjo i bashkëngjitet projekt-dokumentit kur ky kthehet në takimin e Sekretarëve të Shtetit dhe i dorëzohet qeverisë për miratim.

Përveç mbledhjeve të qeverisë, në **Lituani** përdoren edhe mbledhjet e rregullta ndërministrrore si një strukturë e rëndësishme për zgjidhjen e konflikteve mes përparësive, përpara se propozimet për politika t'i dorëzohen qeverisë për të marrë vendimin përfundimtar. Në Maltë, mbledhjet ndërministrrore në nivel teknik dhe politik mbahen rregullisht, por nuk ka procedura të formalizuara<sup>46</sup>.

Një procedurë e ngjashme ekziston edhe në **Hungari**, ku faza e parafundit e procesit legjislativ është një mbledhje e Sekretarëve të Administratës së Shtetit. Në këtë rast, dokumentet e politikave qarkullohen nëpër ministri përpara takimit të Sekretarëve të Shtetit nëse është krijuar një grup pune i posaçëm për të hartuar një politikë.

Shumë qeveri koalicioni në **Letoni** kanë pasur një organ alternativ për vendime, të quajtur Këshilli i Koalicionit. Ai ka përfaqësim të barabartë të të gjitha partive të përfaqësuara në koalicionin qeveritar dhe nën disa qeveri ka fituar një rol jozyrtar, megjithatë kyç, në procesin e vendimmarrjes. Këshilli i Koalicionit mund të përdoret si një vend për të zgjidhur çështjet delikate politike, dhe për të marrë vendime të cilat miratohen pastaj zyrtarisht në mbledhjet e Kabinetit të Ministrave. Çështjet e diskutuara në Këshillin e Koalicionit janë projekt-propozime për politika dhe projekt-ligje të cilat janë konsultuar më parë në nivel të ministrive. Ky forum alternativ vepron jashtë kanaleve zyrtare, nuk ndjek procedurat e përcaktuara për politikëbërje, dhe nuk është i hapur për shqyrtim nga publiku.

Në **Poloni**, të gjitha projekt-ligjet duhet të vlerësohen brenda Komitetit të Kabinetit në nivelin e Sekretarit të Shtetit përpara se t'i dorëzohen Kabinetit.

Në **Republikën Sllovake**, ndryshimet në mendime ndërmjet ministrive në lidhje me projekt-ligjet zgjidhen me anë të diskutimeve dypalëshe ose me anë të një takimi të Drejtorëve të Përgjithshëm. Legjislacioni nuk mund të çohet në Këshillin e Ministrave pa u zgjidhur këto mosmarrëveshje. Megjithatë, në rast se ka komente të rëndësishme, konflikti mund të zgjidhet edhe nga Këshilli i Ministrave.

## Një proces transparent dhe i strukturuar mirë

Të gjitha SHRA-të e analizuara kishin një proces transparent dhe të mirëstrukturuar për formulimin e politikave dhe hartimin e legjislacionit. Ato kanë rregulla apo sisteme për të formuluar politika, hartuar legjislacion dhe dorëzuar rezultatet tek qeveria. Të gjitha SHRA-të kanë miratuar një kuadër ligjor shumë

<sup>45</sup> Fjala rregullore përdoret këtu duke përfshirë legjislacionin parësor dhe dytësor. Dokumentet e politikave për të cilat nuk janë ngritur grupe pune dërgohen në ministri vetëm pas takimit të Sekretarëve të Shtetit.

<sup>46</sup> Në nivel teknik ka: mbledhje mujore të Sekretarëve të Përhershme të kryesuara nga Kryesekretari i Përhershëm, si dhe takime javore të Drejtorëve të Çështjeve të BE-së. Takime të tjera të rregullta: Forumi për Drejtorët e Shërbimeve të Korporatave (burimet njerëzore, financa), Forumi për Drejtorët e Hartimit të Politikave, Forumi për Drejtorët e Zbatimit të Programeve, Forumi për ICT. Diskutimet e bëra në këto forume i raportohen Sekretarëve të Përhershëm. Në nivel politik, ka: takim javor të Kabinetit në bazë të dokumentave të qarkulluara më parë, takime javore të Kryeministrit, Sekretarëve të Përhershëm për Financat si dhe Kryesekretarëve të Përhershëm. Takime mujore të njësisë mbështetëse të Komitetit të Kabinetit: ka një komitet kabineti për çdo sektor kryesor (mjedisi, turizmi, projektet qendrore, konkurrueshmëria). Këto Komitete drejtohen nga Kryeministri, dhe përfshihen ministrinë kyçe, si p.sh.: Kryesekretari i përhershëm, Sekretarët e Kabineteve dhe disa aktorë.

të ngjashëm me atë të rekomanduar në Listën e Kontrollit të Referencave të OECD-së për Vendimmarrje Rregullatore<sup>47</sup>; më konkretisht, kur hartohen politika duhet të bëhen pyetjet e mëposhtme:

- A është përcaktuar si duhet problemi?
- A justifikohet veprimi i qeverisë?
- A është normimi forma më e mirë e veprimit qeveritar?
- A ka një bazë ligjore për normim?
- Cili është/cilat janë nivelet e përshtatshme të qeverisë për këtë veprim?
- A i justifikon kostot përfitimi nga ky rregullim ligjor?
- A është transparent efekti i shpërndarjes në shoqëri?
- A është rregullorja e qartë, e qëndrueshme, e kuptueshme dhe e lehtë për përdoruesit?
- A kanë pasur mundësi të gjitha palët e interesuara të paraqesin mendimet e tyre?
- Si do të garantohet respektimi i rregulloreve?

Vendimi për të hartuar një politikë mund të merret nga qeveria ose një ministër individual. Lloji i vendimit (vendim qeveritar apo ministror) varet nga madhësia dhe kompleksiteti i problemit që duhet zgjidhur dhe sasia e burimeve që nevojiten. Në rastin e parë, vendimet e qeverisë zakonisht paraprihen nga një proces ku përfshihet konsultimi brenda dhe mes ministrive. Në rastin e legjislacionit dytësor, procesi është më i thjeshtë dhe konsultimi ndërministror zakonisht nuk është i nevojshëm.

Megjithatë, në **Maltë** propozimet për legjislacionin dytësor duhet të njoftohen dhe miratohen nga Zyra e Kryeministrit. Kjo qasje shmang hartimin e rregulloreve nga ministrat, rregullore të cilat mund të bien ndesh me politikat e qeverisë si një e tërë, ose hartimin e rregulloreve që bien ndesh me rregullore të bëra nga ministra të tjerë. Në **Qipro**, legjislacioni dytësor i nënshtrohet një vlerësimi akoma më të hollësishëm në parlament, sesa bëhet zakonisht në ndonjë SHRA tjetër.

### ***Rendi përsëritës***

Në të gjitha SHRA-të, procesi i formulimit të politikave fillon me një vendim në parim, në nivel politik, për të nisur ciklin e hartimit të politikës. Vendimi mund të vijë nga një prej shumë burimeve. Burimet e politikave janë të ngjashme në të gjitha vendet, megjithëse përzierja ndryshon. Politikat mund të vijnë nga manifeste qeverish, marrëveshje koalicioni, çështje gjyqësore, emergjenca afatshkurtra, detyrime ndërkombëtare.

Pas vendimit në parim, për të nisur ciklin e hartimit të politikave, formulimi i politikave ndjek një rend të ngjashëm përsëritës në të gjitha SHRA-të. Punonjësi i interesuar për politikën, fillimisht kryen kërkim mbi problemin dhe identifikon nëse problemi është trajtuar në fushën kombëtare apo ndërkombëtare, dhe përgatit një zgjidhje në konsultim me kolegë nga brenda ministrisë së tij/saj dhe nga ministri të tjera, si dhe me aktorë të tjerë të interesuar. Në **Sloveni**, Rregullat e Procedurës Qeveritare kërkojnë që punonjësit të kryejnë një studim krahasues të tre vendeve të tjera si pjesë e kësaj faze të procesit.

### ***Dallimi mes formulimit të politikave dhe hartimit të rregulloreve***

Dallimi më i madh mes procedurave të formulimit të politikave dhe hartimit të rregulloreve në SHRA-të zakonisht mund të gjendet në faktin nëse vendet ndikohen nga traditat e të drejtës zakonore apo asaj civile. Gjithashtu, vendet që më parë binin nën sferën e ndikimit komunist i janë nënshtuar një modernizimi të konsiderueshëm të strukturave dhe proceseve të tyre, madje disa kanë përjetuar një ndryshim të plotë të personelit. Në disa SHRA, sidomos në **Letoni** dhe **Estoni**, nivelet e përvojës dhe kujtesës institucionale ishin goxha më të ulëta sesa në të tjerat. Megjithatë, në shumicën e SHRA-ve ka një numër të kufizuar

<sup>47</sup> OECD, Rekomandimet e OECD-së mbi Përmirësimin e Cilësisë së Normimit të Qeverisjes (Miratuar më 9 mars 1995). Shih edhe Parimet Drejtuese të OECD-së për Cilësinë dhe Performancën Rregullatore, miratuar nga Këshilli i OECD-së më 28 prill 2005, OCDE/GD/95(95).

punonjësish me përvojë në hartimin e legjislacionit. Ky problem është kuptuar dhe po trajtohet në **Poloni** dhe **Hungari**, ku ka disa kurse për trajnimin e punonjësve për të hartuar legjislacion.

Përveç **Republikës Çeke** dhe **Republikës Sllovaqe**, në vendet e tjera ka pak dallim formal mes formulimit të politikave dhe hartimit të rregulloreve. Kjo është e arsyeshme në rastin e veprimtarive të thjeshta për politika, pasi shpesh ka pak nevojë për t'i ndarë këto dy procese. Megjithatë, për çështje të rëndësishme të politikave, zakonisht shihet e vlefshme të ndahet veprimtaria e formulimit të politikave nga ajo e hartimit të ligjeve. Në praktikë, shumica e njerëzve të intervistuar e me njohuri në të gjitha SHRA-të kishin mendimin se duhet të ketë një farë ndarjeje të punës, ose të paktën një ndarje të të dyja detyrave.

Në **Republikën Çeke** dhe **Republikën Sllovaqe** ka një dallim mjaft të qartë mes fazës së formulimit të politikave dhe fazës së hartimit të rregulloreve, sidomos në lidhje me çështjet më të rëndësishme të politikave. Në rastin e parë, në parim vendimi merret nga qeveria për të vazhduar me një politikë të propozuar, dhe kur ai vendim është marrë, fillon hartimi i legjislacionit.

Asnjë prej vendeve në këtë studim nuk ka një organ qendror që të merret vetëm me hartimin e ligjeve<sup>48</sup>. Kjo nuk është e çuditshme për vendet që mbështeten tek e drejta civile, ku punonjësit që formulojnë politika pritet të jenë në gjendje edhe të hartojnë legjislacion.

Në disa vende, p.sh. **Republika Çeke**, **Hungaria** dhe **Sllovakia**, zyra juridike në një ministri shpeshherë pritet që të hartojë legjislacion për të cilin një punonjës tjetër ka formuluar një politikë. Megjithatë, nuk mund të nxirret ndonjë përfundim i përgjithshëm nga ndryshimi i praktikave në këto vende. Praktika ndryshon në përputhje me punonjësit e përfshirë dhe njohuritë e tyre mbi temën e politikës që duhet të rregullohet me ligj, si dhe aftësitë e tyre për të hartuar legjislacion.

Pak SHRA përdorin një qasje shumëplanëshe ndaj përgatitjes së legjislacionit. Në **Estoni** dhe **Letoni**, rregulloret, sidomos kur ato normojnë çështje të ndërlikuara, hartohen nga grupe pune prej shumë disiplinave, ku mund të përfshihen edhe përfaqësues të ekspertëve të jashtëm dhe OJQ-ve. Përdorimi i këtyre grupeve të punës është i përhapur në të gjitha SHRA-të, sidomos për çështje të ndërlikuara dhe që nevojiten njohuri specifike, teknike, të cilat mund të mos i ketë sektori publik, por mund të ofrohen nga sektori privat.

### *Traditat e të drejtës civile dhe asaj zakonore: rregullat dhe zakonet procedurale*

Në vendet me të drejtë civile, procesi i formulimit të politikave dhe hartimit të legjislacionit ndërmerret në përputhje me një numër rregullash të shkruara. Disa vende me të drejtë civile, si p.sh. **Estonia**, kanë detyrime kushtetuese për të identifikuar autoritetet të cilave u është besuar nisja e hartimit të ligjeve.

Në Shtetet e Reja Anëtare rregulla të ndryshme përshkruajnë si të përgatiten politikat dhe si t'i prezantohen qeverisë dhe parlamentit. Ka disa rregulla të përgjithshme për për tema të posaçme për krijimin e politikave dhe hartimin e legjislacionit<sup>49</sup>. Rregulla të posaçme janë përcaktuar edhe për zbatimin e llojeve të caktuara të strategjive dhe planeve të veprimit, p.sh. në sektorin e energjisë, pyjeve dhe bujqësisë.

Në **Hungari**, procedura legjislative rregullohet nga Kushtetuta dhe Ligji për Legjislacionin i vitit 1987. Kapitulli 2 i atij ligji parashikon se propozimet për ligje të reja duhet t'i nënshtrohen studimeve paraprake dhe të përdorin gjuhë të qartë, dhe se çështjet identike apo të ngjashme duhet të rregullohen në të njëjtat ligje. Gjithashtu ai parashikon se shtetasit duhet të marrin pjesë në hartimin e legjislacionit. Një vendim qeverie në lidhje me Procedurat Qeveritare<sup>50</sup> parashtron, ndërmjet të tjerash, hollësitë e mekanizmit miratues brenda qeverisë dhe përmbajtjen, të detyrueshme me ligj në Hungari, të çdo propozimi që i dërgohet qeverisë.

<sup>48</sup> Për një analizë të argumenteve pro dhe kundër një organi qendror shih SIGMA (1997), *Listëkontrolli mbi Hartimin e Ligjeve dhe Menaxhimin Rregullator në Europën Qendrore dhe Lindore*, Dokumenti i SIGMA-s Paper Nr. 15, <http://www.oecd.org/dataoecd/42/21/1823473.pdf>.

<sup>49</sup> P.sh., Konventa e Arhus-it kërkon një Vlerësim Strategjik të Ndikimit në Mjedis.

<sup>50</sup> Nr. 1088/1994.



**Letonia** ka miratuar një Ligj të Procedurave Administrative<sup>51</sup> i cili përmban dispozita të përgjithshme për funksionimin e administratës. Rregullat e Procedurës së Qeverisë<sup>52</sup> rregullojnë procedurat e qeverisë. Politikat duhet të krijohen në përputhje me këto rregulla, ku përfshihen p.sh. klasifikimi dhe struktura e dokumenteve të politikave si dhe Procedura për plotësimin e vëzhgimeve, komenteve mbi projekt-rregulloret<sup>53</sup>. Komentet janë materialet shpjeguese që shoqërojnë një projekt-rregullore që i dërgohet Këshillit të Ministrave dhe Parlamentit. Ato përfshijnë një vlerësim të ndikimeve ekonomike dhe shoqërore të projekt-rregullores të marrë në shqyrtim, si dhe ndikimin që ajo mund të ketë mbi buxhetin e shtetit.

Materiale të ngjashme në legjislacionin lituanez mund të gjenden në Ligjin mbi Qeverinë, që përcakton mënyrën si do të zbatohet programi i qeverisë. Gjithashtu ka udhëzime të përgatitura nga Ministra e Drejtësisë, të cilat specifikojnë procedurën që duhet të ndiqet për të paraqitur propozimet për rregullore<sup>54</sup>. Rregullat për konsultim dhe bashkërendim ndërministror përcaktohen në Rregullat e Procedurës Qeveritare, të miratuara me një rezolutë të qeverisë<sup>55</sup>. Paragrafi 49 i Rregullave mbi Konsultimin, “Kërkesat për hartimin dhe miratimin e legjislacionit”, përmban një listë të institucioneve me të cilat duhet të diskutohen rregulloret përpara se të çohen në qeveri.

Në Poloni, procedura për hartimin e legjislacionit parësor nga qeveria përcaktohet në Ligjin mbi Organizimin dhe Rregullat e Procedurës së Këshillit të Ministrave dhe në Fushën e Kompetencave të Ministrave të 8 gushtit 1996, së bashku me rregulloret për zbatimin e saj. Punonjësit që formulojnë politika dhe hartojnë legjislacion duhet të kenë parasysh edhe Parimet e Teknikës Legjislative, të përcaktuara në një rregullore të Urdhrit të Kryeministrit mbi Parimet e Teknikave Legjislative<sup>56</sup>.

Urdhri Organizativ i Zyrës së Qeverisë së Republikës Sllovaqe përcakton parimet bazë për menaxhimin e përgjithshëm të administratës shtetërore. Hollësi të mëtejshme në lidhje me rolin e Zyrës së Qeverisë në këtë aspekt përcaktohen në Statutin e Zyrës së Qeverisë së Republikës Sllovaqe. Megjithatë, Republika Sllovaqe është një rast i veçantë, pasi ndarja e punës mes punonjësve që përgatisin politika dhe atyre që hartojnë legjislacion është pasqyrim i procedurës së ndjekur në vendet me traditë të së drejtës zakonore apo që kanë qenë të ndikuar nga një traditë e tillë, ku legjislacioni hartohet nga juristë me aftësi të posaçme për hartimin e legjislacionit.

Rregullat e Procedurës së qeverisë së Sllovenisë dhe Rregullat e Procedurës së Asamblesë Kombëtare të Sllovenisë normojnë përkatësisht organizimin e qeverisë dhe të parlamentit. Rregullat e Procedurës së qeverisë ndër të tjera flasin dhe për rolin e kryeministrit, organizimin e punës së qeverisë, grupet e punës të qeverisë, këshillat qeveritarë, formatin e dokumenteve qeveritare si dhe çështjet e zakonshme që kanë lidhje me organizimin e qeverisë.

Ky model ndiqet në pjesën më të madhe të vendeve të studiuara që mbështeten tek e drejta civile, megjithëse terminologjia ndryshon dhe kjo fushë trajtohet nga një sërë titujsh legjislativë, përfshirë Ligjet për Procedurat Administrative, Ligjin për qeverinë ose për urdhrat organizativë.

Në SHRA-të të cilat janë ndikuar nga traditat e së drejtës zakonore zakonisht nuk ka procedura administrative të standardizuara të kërkuara me ligj për të garantuar se hartimi i politikës kryhet në nivelin

<sup>51</sup> Nëntor 2001.

<sup>52</sup> Mars 2002.

<sup>53</sup> Këshilli i Ministrave i Republikës së Letonisë, 18 shtator 2001. Shih edhe amendamentet e 12 korrikut 2002 dhe 11 qershorit 2004.

<sup>54</sup> Struktura që duhet ndjekur: ligji duhet të ketë një bazë ligjore; duhet të ketë një vlerësim ligjor të saktë të propozimit; duhet të ketë referenca tek ligjet përkatëse dhe duhet të merren hapa për të shmangur përplasjet apo mbivendosjet me ligje të tjera; duhet të jepet shpjegim pse është i nevojshëm ligji; duhet të jepet shpjegim se si është zgjidhur në vende të tjera ky problem; duhet të ketë referenca tek ligje të tjera të BE-së apo ndërkombëtare, nëse ka; propozimi duhet të shpjegojë plotësisht qëllimin e tij; duhet të vlerësohen dhe referohen efektet financiare, ekonomike, etj. të propozimit; duhet të përmendet edhe struktura e ligjit, kur të jetë gati drafti; duhet të përmendet edhe çdo ligj tjetër që do të amendohet.

<sup>55</sup> Nr. 728 (OG 1994, Nr. 63-1238).

<sup>56</sup> 20 qershor 2002.

e duhur të qeverisë. Pjesa më e madhe e procesit të politikë-bërjes rregullohet sipas traditës apo me anë të procedurave të hartuara nga ministrinë.

Në **Qipro** dhe **Maltë**, procesi i formulimit të politikave dhe hartimit të legjislacionit është më shumë një çështje zakoni, tradite apo qarkoresh të nxjerra për përdorim të brendshëm sesa diçka që rregullohet me ligj apo procedura siç ndodh në vendet që përdorin të drejtën civile.

### **Sigurimi i cilësisë — institucionet**

Përvoja në vendet e OECD-së tregon se menaxhimi rregullator i mirë kërkon një proces të sigurimit të cilësisë që verifikon rrjedhën e rregulloreve të propozuara përkundrejt parimeve rregullatore të mira. Menaxhimi rregullator duhet të trajtojë edhe stokun e rregulloreve. Kjo është një çështje me rëndësi të madhe për të gjitha SHRA-të, për shkak të ritmit dhe modelit të zbatimit të *acquis communautaire*. Nuk mund të merret e mirëqenë se nuk janë vendosur barra të panevojshme rregullatore ose se të gjitha ligjet e miratuara pas pavarësisë janë në përputhje të shkëlqyer me rregulloret ekzistuese. Punonjësit në të gjitha SHRA-të e pranojnë se *acquis* ishte miratuar me një shpejtësi të madhe dhe se nevojitet një periudhë vlerësimi dhe reflektimi në mënyrë që të konfirmohet se *acquis* është zbatuar si duhet.

Mund të thuhet se një proces i sigurimit të cilësisë duhet të funksionojë horizontalisht, për sa i përket zbatimit të një politike dominuese mbi menaxhimin rregullator, dhe vertikalisht brenda çdo organi përgjegjës për hartimin e rregulloreve. Prosesi i sigurimit të cilësisë mund të përgjithësohet për rrjedhën e rregulloreve dhe mund të përgjithësohet për stokun e rregulloreve ose mund të ndërmerret në sektorë të veçantë.

Ka dy modele kryesore të vlerësimit të cilësisë në SHRA-të. I pari është kur vlerësimi i cilësisë ndërmerret përmes një numri analizash brenda ministrive dhe ndërmjet ministrish, dhe ndonjëherë me organe të jashtme. Këtu përfshihen analiza nga:

- Zyra e Kryeministrit (sido që të quhet).
- Ministria e Drejtësisë.
- Ministria e Financave.
- Analiza ndërmjet ministrive dhe brenda ministrive.
- Gjykatat.

Modeli i dytë është kur vlerësimet ndërmerren nga një komitet ose organ i krijuar posaçërisht. Qasja e parë dominon, dhe e dyta ka prirje të kufizohet për çështje teknike, ligjore. Asnjë SHRA nuk vlerëson në veçanti cilësinë e legjislacionit për të përcaktuar shkallën në të cilën legjislacioni i ri përputhet me parimet e Normimit më të Mirë. Në të gjitha SHRA-të, organet e përfshira në kontrollin e cilësisë së normimit kanë ngarkesë shumë të madhe pune, e cila sjell vonesa në përgatitjen e legjislacionit.

### **Vlerësimi nga Zyra e Kryeministrit apo organ tjetër në qendër të qeverisë**

Zakonisht, Zyra e Kryeministrit përfshihet nga këndvështrimi i përputhjes së propozimeve me politikën e qeverisë. Roli ndryshon në përputhje me faktin sa figurë e fuqishme është kryeministri në atë sistem. Në disa SHRA, në kohën e vlerësimit të Sigma-s, p.sh. në **Hungari, Letoni, Lituani, Maltë dhe Slloveni**, kryeministri dhe zyra e tij ishin shumë të fuqishëm.

Në **Hungari**, një njësi e posaçme e përbërë nga këshilltarë dhe e krijuar në shkurt të vitit 2006 brenda Zyrës së Kryeministrit, është përgjegjëse për përmbledhjen e mendimeve të shprehura në lidhje me rregullore të propozuara nga qeveria gjatë procesit teknik të harmonizimit të politikave. Kjo ka për qëllim të nxjerrë problemet që kanë lidhje me cilësinë e legjislacionit të propozuar apo nevojën për legjislacionin e propozuar. Propozimet e përgatitura dobët hidhen poshtë në këtë fazë.

Në **Letoni**, Kancelaria e Shtetit luan një rol shumë qendror në një sërë mënyrash, sidomos duke vlerësuar projekt-ligje për të garantuar përputhjen e tyre me planet strategjike, përparësitë politike dhe çështjet

teknike ligjore. Gjithashtu, ajo kontrollon cilësinë e legjislacionit nëpërmjet procesit të “komenteve”. Kancelaria e Shtetit është organi përgjegjës për zbatimin e procedurave dhe rregullave për sa i përket hartimit të politikave dhe planifikimit strategjik. Propozimet që nuk janë përfunduar në përputhje me ligjin i kthehen mbrapsht ministrive dhe nuk trajtohen derisa të kenë marrë formën e duhur.

Në **Lituani**, Zyra e Qeverisë luan një rol të rëndësishëm në procesin e sigurimit të cilësisë. Këto detyra kryhen në Kancelari nga një numër drejtorish, ku përfshihet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria Europiane dhe Drejtoria Juridike.

Vlerësimi nga Zyra e Qeverisë garanton përputhjen me planet dhe strategjitë kombëtare. Zyra e Qeverisë, Seksioni Juridik, vlerëson edhe draftet për sa i përket ligjshmërisë dhe çështjeve teknike ligjore. Megjithatë, Seksioni Juridik ka avantazhin se është i përfaqësuar në takimin javor të Sekretarëve të Shtetit, i cili shqyrton propozimet përpara se ato të çohen përfundimisht në qeveri. Kjo i jep Seksionit Juridik ndikimin, në mos pushtetin, për të bllokuar një propozim nëse ai mund të ketë probleme ligjore.

### ***Ministria e Drejtësisë***

Në të gjitha SHRA-të me përjashtim të **Qipros**, Ministria e Drejtësisë kontrollon këndvështrimin kushtetues dhe juridik të çështjeve. Në **Estoni**, p.sh. Ministria e Drejtësisë është ministria përgjegjëse për cilësinë juridike në fillim të procesit të hartimit. Pasi koncepti i projekt-ligjit miratohet nga Ministria e Drejtësisë, ai mund të kthehet në legjislacion. Edhe Kancelari Juridik ka një rol në procesin e sigurimit të cilësisë.

Në **Hungari**, Ministria e Drejtësisë ka një rol në çështjet e Normimit më të Mirë, megjithëse ky rol u zvogëlua gjatë procesit të vlerësimit. Në vitin 2005, në ministri u krijua një njësi e posaçme (Departamenti i analizës së ndikimit, normimit dhe regjistrimit të ligjeve). Ajo njësi do të ishte përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së vlerësimeve të ndikimit; megjithatë, ajo u shpërbë në korrik të vitit 2006.

Në **Letoni**, Ministria e Drejtësisë vlerëson i draftet nga këndvështrimi i teknikaliteteve juridike, përputhjes me Kushtetutën, me parimet e përgjithshme të ligjit dhe të rregulloreve ekzistuese, si dhe përputhjes me planet strategjike, me përparësitë politike dhe normat e së drejtës ndërkombëtare. Kjo përgjegjësi përfshin edhe vlerësimin e drafteve për të garantuar përputhshmërinë me normat europiane. Kancelaria e Shtetit, së bashku me Ministrinë e Drejtësisë, garanton qartësi dhe koherencë të drafteve.

### ***Vlerësimi nga Ministria e Financave***

Në të gjitha SHRA-të, Ministria e Financave vlerëson draftet nga këndvështrimi buxhetor, për tu siguruar që propozimet janë brenda kufijve buxhetorë. P.sh., në **Qipro**, projektligjet që i çohen Këshillit të Ministrave duhet të shoqërohen me një mendim me shkrim nga Ministria e Financave, me përjashtim të rasteve kur nuk kanë lidhje me çështje buxhetore. Kushtetuta vë në dukje se çdo projektligj që dërgohet në Parlament duhet të shoqërohet me një raport të quajtur “Çështje dhe arsye”, të firmosur nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës.

### ***Vlerësimi mes ministrive dhe brenda tyre***

Në disa SHRA, departamentet juridike të çdo ministrie kanë rol në vlerësimin e cilësisë së legjislacionit të hartuar brenda ministrisë së tyre dhe në ministri të tjera.

Në **Hungari**, Departamenti Juridik i një ministrie është i detyruar të sigurojë se rregullimi i bërë nga një ministri është në përputhje me sistemin ligjor dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Përveç kësaj, brenda një ministrie ka Rregulla Operacionale të krijuara për të siguruar uniformitet brenda asaj ministrie. Vlerësimi nga ministri të tjera, p.sh. në **Republikën Çeke**, **Hungari** dhe në **Republikën Sllovaqe** është një formë e vlerësimit të cilësisë. Në teori, vlerësimi përfundimtar i cilësisë kryhet nga qeveria (Këshilli i Ministrave) kur kjo shqyrton projektin e legjislacionit.

Në **Estoni**, qarkullimi i drafteve organizohet nga një sistem elektronik i quajtur ligji elektronik (*e-digus*), i administruar nga Ministria e Drejtësisë. Ky sistem mundëson një qarkullim të gjerë të të gjitha materialeve

përkatese dhe një proces të drejtpërdrejtë të komentimit mbi projekt-ligjet. Nga momenti që ministria përgatit një koncept të një projektligji, ai futet në sistemin e koordinimit elektronik dhe i dërgohet Ministrisë së Drejtësisë, elektronikisht, nëpërmjet atij sistemi, për miratim. Më vonë gjatë këtij procesi, kur projektligji duhet të miratohet nga ministrinë e linjës, drafti së bashku me një notë shpjeguese dhe të gjitha shtojcat mund të futet në sistemin e koordinimit elektronik, i cili i dërgon automatikisht një mesazh ministrisë e cila duhet të dërgojë mendimin e saj mbi atë draft. Nga ky moment, të gjitha dokumentet që kanë lidhje me të mund të konsultohen nga publiku<sup>57</sup>.

Në **Letoni** procesi i konsultimit ndërministror organizohet nga qarkullimi elektronik i dokumenteve në faqen e internetit të qeverisë. Nga momenti i “njoftimit” për një draft në Takimin e Sekretarëve të Shtetit, çdo draft dhe komentet për ligjin si dhe instrumenta të tjerë ligjorë vihen në dispozicion për konsultim publik. Ministrinë tani përdorin vetëm formën elektronike të dokumenteve në procesin e analizimit dhe dhënies së mendimeve mbi draftet e propozuara. Organizohen edhe mbledhje qeverie për qarkullimin elektronik të dokumenteve (e-portfolio).

Një sistem i ngjashëm do të futet edhe në **Sloveni**, me një funksion redaktimi të ngjashëm me kontrollin e drejtshkrimin, i cili do të lejojë punonjësit të verifikojnë përdorimet e stilit.

Në **Poloni**, Komiteti i Përhershëm i Kabinetit (KPK) mund të vonojë shqyrtimin e legjislacionit të propozuar duke i kërkuar departamentit të korrigjojë defektet formale, si p.sh. mungesën e një liste të ndryshimeve, vlerësimin e përputhjes me BE-në si dhe konsultimet publike. Nëse këto probleme nuk zgjidhen brenda 14 ditëve, sekretari ka kompetencë për ta ndaluar shqyrtimin e dokumentit nga KPK.

### **Roli i gjykatave**

Në të gjitha SHRA-të, Kushtetuta mundëson ekzistencën e një mekanizmi që garanton kushtetushmërinë e ligjeve nëpërmjet krijimit të një Gjykate të Lartë apo Gjykate Kushtetuese. Ajo shqyrton kushtetushmërinë apo përputhjen e ligjit me traktatet ndërkombëtare dhe të drejtën europiane. Vendimet e saj kanë një karakter normues, ato merren në konsideratë dhe pastaj politikat dhe legjislacioni ndryshohen sipas tyre.

Në **Qipro** pati një problem i cili përfundoi me deklarin nga Gjykata e Lartë si antikushtetues të një dispozite ligjore të krijuar për zbatimin e një Direktive. Ky problem tani është zgjidhur nga ligji 127 (I) i vitit 2006 i cili solli një amendim të Kushtetutës së Republikës së Qipros, në mënyrë që të vendosej epërsia e *acquis communautaire* ndaj dispozitave kushtetuese.

Një çështje e pazgjidhur në **Hungari** në lidhje me rolin e Gjykatës së Lartë është juridiksioni i saj për sa i përket kontrollit të transpozimit të direktivave në sistemin juridik hungarez.

Në **Hungari** Gjykata Kushtetuese luan një rol shumë aktiv në vlerësimin e cilësisë së rregulloreve. Vendimet e Gjykatës kanë një ndikim domethënës në përmbajtjen e rregullores, pasi punonjësit që hartojnë legjislacionin duhet të marrin parasysh vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Roli i saj në kontrollin e cilësisë ka ndryshuar që nga koha e krijimit të saj. Gjatë 8-9 viteve të para, detyra kryesore ishte lehtësimi i kalimit nga një regjim juridik në tjetrin. Në fazën e dytë të zhvillimit të gjykatës, dy fushat kryesore të veprimtarisë ishin: kontrolli i kushtetueshmërisë së legjislacionit të propozuar si dhe mbikëqyrja e veprimtarive të organeve shtetërore nga një këndvështrim kushtetues.

Gjykata Kushtetuese e Hungarisë ka nxjerrë edhe vendime në mbështetje të instrumenteve të Normimit më të Mirë, të cilat kanë kontribuar tërthorazi në forcimin e kontrollit të cilësisë së legjislacionit. Asaj i është kërkuar të marrë në konsideratë pasojat e moskonsultimit për një dokument legjislativ. Çështja kishte të bënte me legjislacion mjedisor, i cili përfshinte një detyrim ligjor për tu konsultuar. Ky konsultim nuk u krye, kështu që u kërkuar ndihma e Gjykatës Kushtetuese për të përcaktuar nëse një rregullore e bërë pa konsultimin e nevojshëm mund të deklarohet antikushtetuese<sup>58</sup>. Gjykata vendosi se moskonsultimi me Këshillin Mjedisor, në përputhje me ligjin, e bënte të pavlefshëm ligjin e hartuar pa u ndjekur procesi i

<sup>57</sup> Kjo bie në kontrast edhe me konfidencialitetin dhe formalitetin që rrethon këtë formë procesi në demokracitë më të vjetra.

<sup>58</sup> Rezoluta Nr. 30/2000.

duhur i konsultimit. Megjithatë, në një rast tjetër, Gjykata vendosi se në rastin e ligjeve të Kuvendit Kombëtar, moskonsultimi i qeverisë me një grup të posaçëm nuk e bënte të pavlefshëm një ligj.

### ***Organe të specializuara përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë***

Në disa vende janë ngritur organe për të shqyrtuar nëse projektligjet janë në përputhje me Kushtetutën si dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës.

Në **Qipro**, në bazë të Kushtetutës, Prokurori i Përgjithshëm i Republikës është këshilltari ligjor i qeverisë. Të gjitha draftet e legjislacionit të propozuar duhet të shihen nga Prokurori i Përgjithshëm përpara se t'i dërgohen Këshillit të Ministrave. I gjithë projekt legjislacioni duhet të kalojë nëpërmjet Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm. Në disa raste, kjo sjell rihartimin e projekteve nga kjo zyrë për të garantuar ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë.

Në **Republikën Çeke**, procesi i vlerësimit të cilësisë sigurohet nga Këshilli Legjislativ i Qeverisë (KLQ) i cili shqyrton aspektet ligjore të draftit. Disa kritere për këtë janë përcaktuar në Rregullat Legjislative të Qeverisë. Këto bëjnë që t'i kushtohet vëmendje cilësisë së tekstit ligjor dhe çështjeve si organizimi, qartësia dhe kuptueshmëria e drafteve.

KLQ-ë është një komitet i pavarur, i përbërë nga nëpunës civilë, ekspertë dhe akademikë të pavarur, dhe kryesohet nga ministri përgjegjës për legjislacionin. Këshilli është i ndarë në disa grupe pune, secili përgjegjës për një fushë përkatëse të së drejtës publike, private apo penale. Ai mbështetet nga një Sekretariat i përhershëm i quajtur Zyra Qeveritare e Legjislacionit, e cila është pjesë e Zyrës së Qeverisë.

Në **Maltë**, Prokurori i Përgjithshëm ka një rol të ngjashëm me atë të Kryejuristit në **Qipro** dhe shqyrton të gjitha draftet e legjislacionit parësor e dytësor për kushtetutshmëri dhe përputhje me parimet e përgjithshme të së drejtës. Pasi hartohet, projekti i çohet Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm për vlerësim dhe për tu përkthyer në gjuhën malteze përpara se të dërgohet në qeveri (legjislacioni parësor) apo ministrit për firmë (legjislacioni dytësor). Të gjithë legjislacionet hartohen në gjuhën malteze dhe atë angleze. Në rast mosmarrëveshjes mbizotëron versioni në gjuhën malteze.

Në **Poloni** ka dy organe që merren me cilësinë e legjislacionit: Qendra Qeveritare e Legjislacionit (QQL) dhe Këshilli Legjislativ. QQL u krijua fillimisht nën Kancelarinë e Kryeministrit, por në vitin 2000 u kthye në një organ të pavarur<sup>59</sup>. Megjithatë, ajo raporton tek kryeministri.

QQL koordinon veprimtarinë legjislative të qeverisë, i jep këshilla ligjore qeverisë, përgatit drafte qeveritare dhe këshillon mbi draftet e parlamentit<sup>60</sup>. Kreu i saj merr pjesë në takimet e Komitetit të Përhershëm të Këshillit të Ministrave dhe me zyrën e tij konsultohet çdo ditë Seksioni i çështjeve social-ekonomike, Departamenti i Kancelarisë së Kryeministrit<sup>61</sup>.

Këshilli Legjislativ është organi i lartë këshillimor ligjor për Kryeministrin<sup>62</sup>. Ai këshillon mbi miratimin e legjislacionit parësor e dytësor dhe vlerëson situatën e ligjit, sidomos në lidhje me përputhjen e tij me Kushtetutën dhe të drejtën europiane. Nxirren rregullisht raporte vlerësimi<sup>63</sup>. Megjithatë, në praktikë, Këshillit Legjislativ mund t'i kërkohet mendim nga Komiteti i Kabinetit dhe Kabineti vetëm nëse për këtë është marrë një vendim i përbashkët<sup>64</sup>. Rreth 60% e projektligjeve dërgohen tek ky Këshill, por mendimi i tij nuk është detyrues për departamentin.

<sup>59</sup> OECD (2002), *Shqyrtimi i Reformës Rregullatore, Polonia – Nga tranzicioni tek sfidat e reja rregullatore*.

<sup>60</sup> OECD (2002), po aty.

<sup>61</sup> Goetz K.H., Zubek R. (2005), *Hartimi i ligjeve në Poloni: rregullat dhe modelet e legjislacionit*, Raport i kërkuar nga Ernst & Young Polonia në kuadër të Programit Qeverisje më e Mirë, Ernst & Young, prill 2005.

<sup>62</sup> K.H. Goetz, R. Zubek, po aty.

<sup>63</sup> OECD (2002), po aty.

<sup>64</sup> K.H. Goetz, R. Zubek, po aty.

Në **Republikën Sllovaqe**, pas procedurës së ndryshimeve nga ministritë e linjës, draftet i çohen Këshillit Legjislativ të Qeverisë, i cili është një pjesë përbërëse e Zyrës së Kryeministrit. Ai trajton çështje teknike, ligjore, si p.sh. mungesa e përputhjes me Kushtetutën, dhe i rishikon draftet për të përmirësuar cilësinë e tyre. Sekretariati i Këshillit Legjislativ jep mendim mbi çdo draft, mendim i cili përgatitet pas diskutimeve me nëpunësin e ministrisë përgjegjëse për atë projekt-ligj.

Gjithashtu, herëpashere mbahet një takim dy-ditor, ku Këshilli Legjislativ vlerëson punën e tij dhe Kryetari takohet me punonjës të përfshirë në procesin e hartimit të legjislacionit si dhe me Sekretariatit e Këshillit për të gjetur mënyra si të përmirësohet hartimi i legjislacionit. Vëmendje e madhe i kushtohet edhe përputhjes së ligjeve me Kushtetutën dhe parimet e përgjithshme të së drejtës. Instituti për Përafrimin e Ligjit kontrollon për përputhjen e projekt-ligjit me të drejtën europiane.

Në **Slloveni**, i gjithë legjislacioni duhet të çohet për shqyrtim tek Zyra e Qeverisë për Legjislacionin për ta kontrolluar nëse përputhet me Kushtetutën, parimet e përgjithshme të së drejtës sllovene, *acquis communautaire*, si dhe me stilin e legjislacionit slloven.

### **Sigurimi i cilësisë – instrumentet**

Në shumicën e vendeve duhen dorëzuar raporte shpjeguese tek organet vlerësuese dhe parlamenti, në mënyrë që t'u mundësohet atyre të luajnë rolin e tyre si garantues të cilësisë. Si rrjedhojë, në disa vende, projekt-rregulloret mund t'u kthehen ministrive që i kanë hartuar, në rast se informacioni i dhënë me anë të dokumenteve shoqëruese nuk është i mjaftueshëm (**Letonia, Sllovenia**).

Raportet mund të kenë emra të ndryshëm në vende të ndryshme: dokumente të politikave, komente, letra shoqëruese, letra koncepti juridik, raporte shpjeguese dhe listë-kontrolle ligjore. Sidoqoftë, në përgjithësi në SHRA, përmbajtja e këtyre raporteve është shumë e ngjashme. Ato zakonisht përfshijnë informacion të tillë si arsyetimi/justifikimi, qëllimi i propozimit dhe vërtetimi se ai përputhet me të drejtën europiane. Disa raporte mund të përmbajnë një vlerësim të ndikimeve të ndryshme që një projekt-rregullore mund të ketë, përfshirë këtu shpeshherë ndikimet financiare (**Letonia, Republika Sllovaqe, dhe Sllovenia**). Në teori, në të gjitha vendet, me përjashtim të Qipros dhe Maltës, të gjitha propozimet që i dërgohen qeverisë duhet të shoqërohen me një vlerësim të ndikimit, por në praktikë cilësia e këtyre propozimeve ndryshon shumë.

Në disa vende, detyrimi për të shoqëruar një projekt-rregullore me një shënim shpjegues nuk zbatohet për të gjithë legjislacionin. Në **Maltë**, listë-kontrolli ligjor duhet të plotësohet vetëm për legjislacionin dytësor. Gjithashtu, disa listë-kontrolle apo raporte specifike mund të kërkohen edhe në rastin e rregulloreve parësore apo dytësore që tranzpozojnë direktivat e BE-së (**Qipro dhe Lituania**).

Në vendet ku krijimi i politikave dhe hartimi i rregulloreve janë të ndara qartë, mund të ketë dy forma të raporteve, një dokument për politikën dhe një raport shpjegues, si në rastin e **Estonisë dhe Letonisë**. Megjithatë, në shumicën e vendeve, projektligji shoqërohet me një dokument të vetëm që nga faza e hartimit deri në fazën kur i paraqitet para parlamentit.

### **Materialet e nevojshme për të informuar Prokurorin e Përgjithshëm në Qipro**

Puna e bërë në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm bëhet më e lehtë kur i jepen udhëzime të mira për të hartuar legjislacion, apo udhëzime të mira se cilat çështje kanë nevojë për vëmendje. Detyra e tij bëhet më e lehtë për shkak të detyrimit që kanë punonjësit që dorëzojnë projekt-legjislacion për të dërguar gjithmonë, bashkë me draftin, informacion të mjaftueshëm që kjo zyrë të mund të kryejë me efektivitet funksionin e saj. Ky informacion përfshin:

- ▶ informacion të mjaftueshëm mbi historikun e problemit, një shpjegim të hollësishëm të propozimit legjislativ që synon të korrigjojë (p.sh. diskutimet që janë kryer, propozimet e komitetit *ad hoc*, vendime gjyqësore, etj.).
- ▶ synimet kryesore të propozimit legjislativ, me një raport mbi nevojën për çdo rezervë të

mundshme apo klauzola kalimtare.

- ▶ mjetet me atë të cilave do të arrihen synimet kryesore të legjislacionit (d.m.th. mekanizmat që priten të hyjnë në fuqi, kompetencat që mendohet të jepen, etj.).
- ▶ të gjitha vështirësitë dhe rezultatet e njohura (ligjore, shoqërore, administrative) që mund të shkaktohen nga legjislacioni, si dhe kostot e pritshme të zbatimit të tij në aspektin publik dhe/ose privat.

### ***Koncepti i ligjit model dhe shkresa shpjeguese në Estoni***

Në **Estoni**, organeve vlerësuese u dorëzohen dy dokumente në faza të ndryshme të procesit të krijimit të rregullave. Shkresa e Konceptit të Ligjit hartohet në fazën e nisjes së politikës, kurse shkresa shpjeguese qarkullohet në fazën e hartimit të legjislacionit.

Në një fazë të hershme të procesit të formulimit të politikës, një ministri që propozon futjen e legjislacionit të ri duhet t'i dërgojë Ministrisë së Drejtësisë propozimin në vija të trasha, në formën e një Shkrese të Konceptit të Ligjit, për miratim në parim.

#### **Modeli i konceptit të ligjit dhe i shkresës shpjeguese (Estoni)**

Shkresa e Konceptit të Ligjit mbështetet në një shkresë qarkore që i dërgohet të gjitha ministrive për t'i informuar se projekt-rregulloret që do të shqyrtohen nga qeveria duhet të përfshijnë:

- 1) përshkrimin e situatës në atë fushë.
- 2) qëllimin e rregulloreve të propozuara.
- 3) mjetet e mundshme për të arritur qëllimet e politikës.
- 4) fushën e veprimit të ligjit.
- 5) pasojat e rregulloreve të propozuara.
- 6) financimin.
- 7) afatin kohor që mendohet për përgatitjen e projekt-ligjit dhe emrin dhe informacionin për punonjësin përgjegjës, si dhe emrin dhe informacionin për punonjësin që ka njohuri juridike.

Po ashtu, projektligji duhet të shoqërohet edhe me një letër shpjeguese.

Rregullorja e qeverisë mbi rregullat teknike trajtojnë edhe strukturën e shkresave shpjeguese të një projektligji, dhe kërkon që shkresa shpjeguese të jetë e përbërë nga këto pjesë:

- 1) hyrja.
- 2) qëllimi i draftit.
- 3) analiza e përmbajtjes dhe ajo krahasuese e draftit.
- 4) terminologjia e projektligjit.
- 5) përputhja e draftit me të drejtën europiane, pasojat e normimit.
- 6) shpenzimet e nevojshme për zbatimin e rregullores, aktet zbatuese të rregullores, zbatimin e draftit.

### ***Komentet/shënimet në Letoni***

Në **Letoni**, projekt-ligjet dhe projekt-rregulloret që kanë ndikim social-ekonomik apo ndikim mbi mjedisin apo buxhetin e shtetit duhet të shoqërohen me një dokument të quajtur "koment", i cili jep një përmbledhje të ndikimeve që ato mund të kenë. Komenti garanton që draftet e dërguara në mbledhjen e Sekretarëve të Shtetit dhe, në fund, në qeveri, të jenë të mbështetura në studime dhe analizë të politikave. Më poshtë jepet një shpjegim i procesit të komentimit.

### **Komentet (Letoni)**

Komentet/shënimet janë të detyrueshme me ligj dhe draftet e dorëzuara pa shkallën e kërkuar të komenteve mund t'i kthehen ministrisë nga Kancelaria e Shtetit për tu rishikuar. Edhe pjesëmarrësit në mbledhjen e Sekretarëve të Shtetit mund të kërkojnë që të përgatitet një koment për një projektligj, nëse ky mungon.

Qëllimi i komentit është të garantojë vlerësimin e ndikimit social-ekonomik dhe ndikimin fiskal të politikave apo rregulloreve të propozuara mbi buxhetin e shtetit dhe mbi buxhetet e qeverive lokale, dhe të parandalojë miratimin e akteve rregullatore kontradiktore.

Komentet japin:

- ▶ situatën aktuale dhe një përshkrim të problemit që duhet zgjidhur;
- ▶ një përshkrim të treguesve kryesorë social-ekonomikë;
- ▶ rregulloret ligjore aktuale dhe amendimet e nevojshme;
- ▶ referimin tek Deklarata e Qeverisë apo një dokument politike që autorizon apo kërkon propozimin;
- ▶ qëllimin e propozimit dhe përmbledhjen e shkurtër të tij;
- ▶ vlerësimin e efektit financiar afatmesëm;
- ▶ referimin tek instrumentet ligjorë të BE-së dhe marrëveshjet ndërkombëtare;
- ▶ komunikimin me partnerët socialë të OJQ-ve;
- ▶ masat institucionale për zbatimin e projekt-rregulloreve.

Një koment i plotësuar si duhet të tregojë një analizë të ndikimit mbi zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomisë kombëtare, duke treguar ndryshimet e mundshme në mjedisin makro-ekonomik, klimën e biznesit dhe thjeshtimin e procedurave administrative, situatën shoqërore dhe mjedisore, dhe një analizë të ndikimit që ky propozim do të sjellë tek të drejtat e njeriut dhe mundësitë për meshkujt e femrat.

Më konkretisht, ndikimi duhet të vlerësohet duke pasur parasysh disa faktorë, si p.sh.:

- ▶ vëllimin e prodhimit të mallrave dhe shërbimeve;
- ▶ shkallën e punësimit;
- ▶ shkallën e papunësisë;
- ▶ çmimet;
- ▶ vëllimin e eksporteve;
- ▶ konkurrencën.

### ***Lista e kontrollit për ligjet në Maltë***

Që në vitin 2004 ka hyrë në fuqi një listë-kontrolli për ligjet. Megjithatë ajo ka vlerë vetëm për legjislacionin dytësor. Funkzioni i kësaj liste kontrolli është të garantohet informimi i Kryeministrit dhe Kabinetit mbi legjislacionin dytësor që hartohet dhe pse nevojitet ai. Lista e kontrollit mbulon fushat e mëposhtme:

- aspekte të përgjithshme (titullin e aktit ligjor të propozuar; objektivat, qëllimin dhe arsyet detyruese për publikim).
- veprimtarinë hartuese (nëse është kryer konsultimi me aktorët e përfshirë, dhe është kryer vlerësimi i ndikimit rregullator).
- ndikimin (ndikimi mbi sektorin privat – detyrimet e reja të krijuara, ose shtimi i detyrimeve, si dhe ndikimi procedural apo administrativ; ndikimi mbi qeverinë – me drejtim nga ministri dhe ente të tjera, dhe nëse propozimet do të ndikojnë në përparësitë e qeverisë dhe politikat kryesore)
- rezultatet (pozitive dhe negative; masa lehtësuese në rast se ka rezultat negativ).
- afatin kohor për publikim.



### *Deklarata shpjeguese në Poloni*

Projekt-ligjet, kur dërgohen në qeveri dhe parlament, duhet të shoqërohen me një deklaratë shpjeguese e cila, ndër të tjera, duhet të tregojë një vlerësim të pasojave të tyre shoqërore, ekonomike dhe financiare, burimet e financimit, një deklaram nëse projekt-ligji propozon të vendoset një barrë mbi buxhetin e shtetit, dhe një deklaram mbi përputhjen e projekt-ligjit me të drejtën europiane. Projekt-ligjet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave duhet të shoqërohen me propozime për legjislacionin dytësor bazë.

Në mbështetje të Rregullave Legjislative të Qeverisë së **Republikës Sllovake** dhe Udhëzimeve Metodologjike, projekt-ligjet duhet të shoqërohen me:

- një raport shoqërues që përmban një justifikim të përgjithshëm për legjislacionin, projekt-rezolutën qeveritare, projekt-rezolutën e parlamentit, si dhe projekt-rregulloren aktuale;
- një raport shpjegues që përmban një justifikim për secilën pjesë të draftit, hollësi mbi përputhjen e ligjit me Kushtetutën, ligje të tjera, traktate ndërkombëtare; për sa i përket legjislacionit të KE-së, raporti duhet të përmbajë një klauzolë të posaçme që vërteton qartë përputhjen e projekt-ligjit me të drejtën europiane; një vlerësim të procedurës së komenteve ndërministrare dhe vlerësimin e efekteve financiare, ekonomike, mjedisore dhe shoqërore të projektligjit.

### *Letra shpjeguese në Slloveni*

Rregullat e Procedurës së Qeverisë në **Slloveni**<sup>65</sup> kërkojnë që i gjithë legjislacioni parësor të shoqërohet me një shkresë shoqëruese, e cila të përfshijë:

- të dhëna për sa i përket identifikimit dhe procedurës për shqyrtimin e dokumentit të qeverisë.
- propozimin për vendimin e qeverisë. Nëse propozohen amendamente të një rregulloreje që po zbatohet, dokumenti duhet të përmbajë një propozim për miratimin e vendimit të qeverisë mbi përcaktimin e tekstit të konsoliduar.
- garanci nga propozuesi se është kryer vlerësimi i ndikimit të vendimeve qeveritare të propozuara dhe se është bërë koordinimi i detyrueshëm ndërmjet ministrave dhe konsultimi me përfaqësuesit e shoqërisë civile. Vlerësimi i ndikimit duhet të kryhet në fushën e financave publike, përputhjen me *acquis*, heqjen e pengesave administrative, si dhe në fushën e administratës publike, gjyqësorit, ekonomisë, mjedisit dhe situatës shoqërore të individëve. Propozuesi duhet të mbajë përgjegjësi për saktësinë e asaj pjese të garancisë që është në kompetencë të tij.
- shpjegimin e vendimeve të propozuara, përfshirë shpjegimin e pasojave të masave të propozuara dhe të të dhënave të tjera të kërkuara për vendimmarrjen cilësore të qeverisë, e cila do të përcaktohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë.
- të gjithë elementët e përcaktuar nga Rregullat e Procedurës së Asamblesë Kombëtare të Sllovenisë, nëse drafti dërgohet në Asamblenë Kombëtare.

Sekretariati i Përgjithshëm nxorri një udhëzim<sup>66</sup> që përmbante në Shtojcë një formular i cili duhet të plotësohet nga punonjësit kur hartojnë rregullore, dhe i referohet të gjithë elementëve të raportit shpjegues që duhet të shoqërojë një projekt tekst në përputhje me Rregullat e Procedurës.

### *Listë-kontrolli specifike dhe tabelë për transpozimin e legjislacionit të BE-së në Qipro, Lituani dhe Maltë*

Në **Lituani**, një tabelë harmonizimi që jepet me çdo draft për t'i dhënë fuqi një Direktive të KE-së, tregon prejardhjen nga Neni i Direktivës si dhe destinacionin, nenin në projekt-legjislacion. Kjo tabelë jep dhe një

---

<sup>65</sup> Neni 8.

<sup>66</sup> Udhëzimi Nr. 10 për zbatimin e parashikimeve në Rregullat e Procedurës së Qeverisë së Republikës së Sllovenisë.

shkallë transparence e cila vlen për ata që bëjnë interpretimin e legjislacionit, dhe për Komisionin European, i cili sigurohet që Shtetet Anëtare respektojnë detyrimet e tyre.

Në **Qipro**, ligjet që bëjnë harmonizimin me Direktivat e KE-së ndjekin të njëjtën rrugë si ligjet normale. Megjithatë, raporti shpjegues që i dërgohet Këshillit të Ministrave, së bashku me këto ligje harmonizuese si dhe procedurat e hartimit të tyre, ndryshon në njëfarë mase nga ai që dërgohet për ligjet normale.

Raporti që shoqëron një projekt-ligj në parlament paraqitet në përputhje me një pyetësor të strukturuar rreth qëllimit të harmonizimit. Ky dokument përfshin një listë-kontrolli specifike, të hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme përpara periudhës së anëtarësimit (në BE), e cila duhet të plotësohet nga departamenti përkatës, sipas udhëzimeve nga Ministria e Financave.

#### **Lista e kontrollit që duhet të shoqërojë projekt-ligjet e dërguara në parlament (Qipro)**

Lista e kontrollit përfshin këto elemente:

- ▶ qëllimi – fusha e veprimit e legjislacionit të ri
- ▶ referime – analizë e legjislacionit përkatës të BE-së
- ▶ angazhimi për kohën e miratimit
- ▶ mundësi për rregullimin/*acquis*
- ▶ lehtësi/fleksibilitet për masa kalimtare
- ▶ referimi krahasues ndaj legjislacionit ekzistues në Qipro, dhe në çfarë mase ndikohet nga legjislacioni i ri
- ▶ kapaciteti i vendit për të zbatuar dispozitën: mekanizmat e stafit
- ▶ vlerësimi ekonomik i ndikimeve të pritshme mbi shtetasit, organizatat apo interesa të tjera të vendit (efekte të përgjithshme, ekonomike, shoqërore, etj. të legjislacionit të propozuar)
- ▶ referimi ndaj mbledhjeve të organizuara
- ▶ kontaktet me organizatat, personat e tjerë të interesuar
- ▶ rruga e drejtpërdrejtë e zbatimit në një periudhë afatgjatë

Gjithashtu, në rastin e Direktivave të KE-së, plotësohet një program nga departamenti përkatës, për të siguruar harmonizimin në kohën e duhur; këtu përfshihen elementët e mëposhtëm:

- ▶ titulli i legjislacionit
- ▶ direktiva përkatëse e KE-së
- ▶ periudha e harmonizimit
- ▶ departamenti përgjegjës
- ▶ data e përfundimit të hartimit
- ▶ verifikimi ligjor: data e dorëzimit – data e përfundimit
- ▶ Këshilli i Ministrave: data e dorëzimit – data e miratimit, data e firmosjes nga ministri (për urdhrat)
- ▶ Parlamenti: data e dorëzimit – data e miratimit
- ▶ data e dërgimit në qeveri - printimi
- ▶ koha e publikimit

Në **Maltë**, përveç listë-kontrollit të përgatitur për përdorim nga ministrinë gjatë hartimit të legjislacionit dytësor, Autoriteti për Mjedisin dhe Planifikimin në Maltë (MEPA) ka hartuar një listë-kontrolli për hartimin e legjislacionit dytësor në zbatim të direktivave të BE-së.

Në përputhje me Udhëzimin e MEPA-s ngrihet një grup harmonizimi për çdo dokument legjislativ, i përbërë nga punonjësit e politikës, këshilltari ligjor i MEPA-s, koordinatori i BE-së për MEPA-n dhe specialistë teknikë nga agjenci të tjera, sipas nevojës. Grupi pastaj duhet të hartojë një plan harmonizimi, me afatet kohore dhe burimet e nevojshme për të harmonizuar legjislacionin si duhet dhe në kohë. Projekt-plani duhet të identifikojë personat e përfshirë në këtë proces. Ai duhet të deklarojë objektivat e

harmonizimit dhe një program me afate kohore të sakta për organizimin e konsultimeve të brendshme dhe me publikun, si dhe për vlerësimin pas konsultimit. Gjithashtu, ai duhet të përcaktojë rreziqet apo vështirësitë me të cilat mund të përballen gjatë procesit të harmonizimit.

### **Numër i mjaftueshëm personeli të trajnuar mirë**

Nuk ka ndonjë rregull mbi numrin ideal të personelit të trajnuar mirë. Efikasiteti i një sistemi të caktuar mund të varet nga kualifikimet, përvoja dhe qëndrimi i punonjësve dhe mënyra se si drejtohen ata. Ka shumë faktorë të ndryshueshëm përsa i përket nivelit të aftësisë, arsimit dhe sistemeve, prandaj krahasimet ekzakte sasiore janë të vështira, për të mos thënë të pamundura.

Në shumë vende, personat me nivel të mjaftueshëm të aftësive për të formuluar politika dhe hartuar legjislacion mund të jetë shumë i kërkuar në sektorin privat, kështu që nuk janë të prirur të qëndrojnë gjatë në sektorin publik. Kjo është vënë re sidomos në **Letoni** dhe **Republikën Sllovaqe**. Në shumicën e SHRA-ve, zyrtarët e intervistuar përmendën mungesën e personave me aftësitë e duhura për të hartuar legjislacion.

Në **Qipro**, Prokuroria e Përgjithshme ka një personel prej 80 nëpunësish (juristë dhe staf mbështetës). Ministrinë nuk kanë një shërbim të veçantë juridik, por shumica e personave që punojnë në ministri kanë formim juridik. Megjithatë, niveli i personelit në Prokurori do të përmirësohej.

Në **Republikën Çeke**, Këshilli Legjislativ i Qeverisë (KLQ) është një komitet i pavarur, që përbëhet nga nëpunës civilë, ekspertë dhe akademikë të pavarur, të kryesuar nga ministri përgjegjës për legjislacionin. Ai është i përbërë nga rreth 25 anëtarë. Grupet e punës (posaçërisht për të drejtën publike, të drejtën private dhe atë penale) kanë 10-15 persona të cilët nuk janë nëpunës civilë me kohë të plotë. Anëtarët e KLQ-së emërohen nga qeveria dhe duhet të jenë juristë të njohur, të respektuar nga sektori publik apo privat, dhe të mos jenë të përfshirë aktivisht në politikat e partisë.

Në **Hungari**, në Ministrinë e Drejtësisë ka rreth<sup>67</sup> 250 juristë dhe zakonisht 2 zyrtarë janë përgjegjës për projekt-legjislacionin: njëri përgatit draftin dhe tjetri mbikëqyr punën. Megjithatë, në Departamentin Juridik të Ministrisë së Ekonomisë dhe Transporteve ka vetëm 10 nëpunës. Ky numër u zvogëluar me 50% me arsyetimin se ministria nuk kishte nevojë për juristë, dhe se për çështjet ligjore të saj mund të kontraktoshin juristë nga jashtë institucionit.

Në **Lituani**, Departamenti Juridik i Zyrës së Qeverisë ka 9 juristë për të shqyrtuar të gjitha propozimet që i dërgohen qeverisë. Megjithëse 3 prej tyre kanë mbi 15 vite përvojë, ky duket një kapacitet i vogël, duke parë se për të shqyrtuar propozimet legjislative jepen vetëm 4 ditë kohë (ose 7 për propozime shumë të rëndësishme), gjë që tregon se ose ky detyrim interpretohet në mënyrë shumë fleksibël, ose se stafi i Zyrës së Qeverisë ka një ngarkesë pune shumë të madhe.

Në **Poloni**, Qendra Qeveritare për Legjislacionin ka 100 juristë. Shumica e tyre kanë të paktën tre vite përvojë në hartimin e legjislacionit në një ministri linje. Megjithatë, Këshilli Legjislativ përbëhet nga 10 juristë të njohur, të cilët i kryejnë detyrat e tyre brenda Këshillit, përveç veprimtarive të tjera profesionale. Kohët e fundit, për shkak të rinovimit të anëtarësisë së tij, stafi i Këshillit Legjislativ u pakësua. Në përbërjen e tij të fundit, ai nuk ka staf mbështetës për të ndihmuar anëtarët e tij.

Në **Republikën Sllovaqe**, p.sh., ka një Këshill Legjislativ të përbërë nga 18 anëtarë, secili i zgjedhur nga Kryetari i Këshillit, në bazë të specialitetit të tyre në një larmi fushash legjislative. Anëtarët e Këshillit nuk shpërblehen dhe vazhdojnë të marrin përgjegjësi profesionale në fushat e tyre përkatëse. Këshilli mbështetet nga një sekretariat me kohë të plotë, i përbërë nga 15 juristë dhe disa punonjës mbështetës. Këshilli Legjislativ punon me afate kohore shumë të shkurtra dhe duhet të shqyrtojë një vëllim shumë të madh legjislacioni.

<sup>67</sup> Fjala "rreth" u përdor si përgjigje ndaj pyetjeve gjatë intervistave dhe tregon se here pas here punonjësit largohen për leje vjetore, leje lindje dhe arsye të tjera.

Disa SHRA (si p.sh. **Letonia**) kanë nisur një proces për shtimin e numrit të personelit në këtë fushë dhe për të reformuar shërbimin civil në mënyrë që të fusin më shumë fleksibilitet në departamentet përgjegjëse për hartimin e ligjeve.

Në **Estoni**, në procesin e hartimit mund të ftohen të marrin pjesë edhe ekspertë nga ministri të tjera apo organe joqeveritare. Sistemi tregon një shkallë të lartë elasticiteti i cili ndihmon për të kompensuar disi kapacitetin e dobët krahasuar me shërbime më të mëdha publike. Ekziston një listë me ekspertë me një përshkrim të aftësive<sup>68</sup> të tyre, gjë që u lejon grupeve të punës të ngritura për vlerësimin e ndikimit të gjejnë ekspertë me njohuritë e duhura.

Në **Maltë**, Prokuroria e Përgjithshme ka një numër të vogël juristësh, disa prej të cilëve kanë detyrë kryesore shqyrtimin dhe rihartimin e legjislacionit. Tani po rekrutohen më shumë juristë në atë zyrë, dhe do të krijohet një si agjenci, për të pasur më shumë elasticitetin përsa i përket rekrutimit dhe shpërblimit. Në kohën e shkrimit të këtij raporti, në Ministrinë e Drejtësisë punonin 40 juristë; vetëm dy ose tre ishin përgjegjës për shqyrtimin e të gjithë legjislacionit dhe një person ishte përgjegjës për përkthimin.

### *Nevoja për trajnim mbi shkrimin e legjislacionit*

Në shumicën e vendeve, punonjësit përgjegjës për hartimin e legjislacionit nuk marrin trajnim të posaçëm për këtë detyrë. Në botën e të drejtës zakonore thuhet se duhen 5-10 vjet për të trajnuar një hartues legjislacioni. Në botën e të drejtës civile, nga të gjithë punonjësit pritet që si pjesë e detyrave të tyre të përditshme, ata të jenë në gjendje të hartojnë legjislacion në kuadër të fushës së tyre të punës. Por, kjo veprimtari ka të bëjë shumë me aftësitë e një personi, dhe disa individë kanë më shumë dhunti për këtë lloj veprimtarie sesa disa të tjerë. Edhe në botën e të drejtës zakonore, me rrjetin e saj të gjerë të zyrave profesionale, ka vetëm një numër të vogël institucionesh që ofrojnë trajnim mbi këtë temë.

Në të gjitha SHRA-të po bëhen përpjekje për të rritur aftësitë e shërbimit publik. Në **Estoni**<sup>69</sup>, Komiteti i Terminologjisë Juridike ka botimin e tij periodik. Ai përmban artikuj mbi përdorimin e gjuhës në tekstet ligjore, mbi terminologjinë juridike, mbi përkthimin e teksteve ligjore si dhe propozime konkrete mbi mënyrat si të formulohen disa rregulla. Megjithatë propozimet e Komitetit të Terminologjisë Juridike nuk janë të detyrueshme për hartuesit e legjislacionit, pasi nuk kanë fuqi ligjore, ato merren shumë shpesh në konsideratë.

Në **Qipro** ka filluar puna për ofrimin e kurseve rreth hartimit legjislativ për nëpunësit. Në **Letoni**, kurset për studimin e hartimit të ligjeve janë pjesë e programit mësimor të Fakultetit të Drejtësisë të një universiteti. Shkolla e Administrimit Publik ofron kurse mbi vlerësimin e ndikimit, hartimin e politikave dhe planifikimin strategjik. Po ashtu, Komiteti për Terminologjinë Juridike organizon seminare dhe uorkshope për hartuesit e ligjit për t'iu shpjeguar probleme të ndryshme gjuhësore.

**Hungaria** dhe **Polonia** kanë përgatitur trajnime formale për shkrimin e legjislacionit. Në shumicën e SHRA-ve, projekt-legjislacioni trajtohet nga nëpunësit, në përputhje me nivelin e tyre të përvojës. Ideja është që nëpunësit me përvojë mund të shkruajnë me nivelin e nevojshëm për të prodhuar drafte të një cilësie të lartë. Megjithatë, në shumë SHRA, moshën mesatare e punonjësve është shumë e re. Sidomos në **Estoni** dhe **Letoni**, ku ka pasur një fluks të madh të të rinjve në shërbimin publik dhe ku punonjësit me pesë vite përvojë pune konsiderohen si me shumë përvojë.

Mungesa e përvojës së stafit të përfshirë në shkrimin e legjislacionit mund të kompensohet nga ekzistenca e rregullave për hartimin e legjislacionit (**Estoni**) ose nga publikimi i kritereve të shkruara të përdorura për vlerësimin e projekt-legjislacionit (**Letoni**). Do të duhej një studim shumë i hollësishëm për të vlerësuar cilësinë e hartimit të legjislacionit në çdo Shtet Anëtar, po të merren parasysh dallimet gjuhësore dhe qasjet e ndryshme juridike për hartimin e legjislacionit.

<sup>68</sup> Për shembull, lista i ndan nëpunësit sipas shkollimit (trajnimit): biologë, gjeografë humanë, inxhinierë, ekonomistë, sociologë, juristë, menaxherë për administratën publike, etj.

<sup>69</sup> Botimi "Õiguskeel" (gjuha juridike) botohet pesë herë në vit.

#### 4. INSTRUMENTAT E NORMIMIT MË TË MIRË NË SHTETET E REJA ANËTARE

*Kjo pjesë përshkruan instrumentet e përdorur në Shtetet e Reja Anëtare: vlerësimi i ndikimit rregullator (VNR), konsultimi, alternativat, thjeshtimi dhe përdorshmëria. Ai i shqyrton ato për të parë pse janë përdorur, si janë përdorur (metodologjitë), kush i përdor ato (masat institucionale, sipas nevojës) dhe kur janë përdorur në SHRA-të.*

##### **Vlerësimi i ndikimit — në përgjithësi**

Vlerësimi i ndikimit<sup>70</sup> ka për qëllim të ndihmojë për përzgjedhjen e alternativës rregullatore më efektive dhe efektive, duke krijuar një kuadër sistematik dhe të qëndrueshëm për vlerësimin e ndikimeve të mundshme të veprimeve të qeverisë. Ai garanton formulimin e politikave të mbështetura në të dhëna, teksa siguron informacionin e nevojshëm për të marrë vendime më të mira rregullatore. Vlerësimi i ndikimit gjithashtu përmirëson transparencën dhe përshpejton ndryshimin kulturor.

Nuk ka një model të vetëm për një program të mirë të vlerësimit të ndikimit. Kur hartohet një program për vlerësimin e ndikimit, është e nevojshme të merren parasysh kontekstet institucionale, shoqërore, kulturore dhe ligjore në vendin në fjalë. Një studim i OECD-së identifikoi një sërë praktikash të mira në shtetet anëtare të cilat çojnë në maksimum përfitimet që nxirren nga zbatimi i një programi të vlerësimit të ndikimeve<sup>71</sup>.

Vlerësimi i ndikimit duhet të shqyrtohet nga një organ qendror për të siguruar konsistencë ndërmjet dhe brenda ministrive. Organi qendror duhet t'i shtojë vlerë këtij procesi duke u siguruar që ministritë të mos e përdorin vlerësimin e ndikimit për të justifikuar vendimet e marra dhe duke mundësuar dialogun mes ministrive dhe duke zgjidhur mosmarrëveshjet për “kompetenca” mes ministrive.

Vlerësimi i ndikimit mund të shihet nga dy këndvështrime: si një instrument për të përmirësuar hartimin e politikave dhe si një metodologji specifike e përdorur për të vlerësuar ndikimet e rregulloreve të caktuara. Vlerësimi i ndikimit duhet të jetë pjesë e një strategjie të përgjithshme mbi Normimin më të Mirë, siç është propozuar edhe në Raportin e Mandelkern<sup>72</sup>. Ky raport zbuloi tre probleme të përbashkëta në lidhje me zbatimin e politikës së VNR-eve. Këto janë: vështirësitë në praktikë, rezistenca kulturore dhe presioni politik. Vështirësitë praktike mund të kapërcehen duke rritur ndërgjegjësimin nëpërmjet trajnimit, caktimit të një numri të mjaftueshëm personeli dhe identifikimit të burimeve të mira të të dhënave për analizën e

<sup>70</sup> Zakonisht quhet vlerësimi i ndikimit rregullator, ose VNR, por më thjesht njihet si vlerësim ndikimi.

<sup>71</sup> Praktikant më të mira VNR në vendet OECD-së: Maksimizimi i angazhimit politik për VNR-në; caktimi me kujdes i përgjegjësisë për elementët e programit VNR; trajnimi i rregullatorëve; përdorimi i një metode analitike konsistente por fleksibël; hartimi dhe zbatimi i strategjive për mbledhjen e të dhënave; shenjestrimi i përpjekjeve për VNR-në; Integrimi i VNR-së me procesin e hartimit të politikave, duke filluar sa më herët; komunikimi i rezultateve; përfshirja gjerësisht e publikut; përdorimi i VNR-së në rregulloret ekzistuese dhe të reja.

<sup>72</sup> Raporti Mandelkern theksonte se kishte 7 kushte për një politikë të suksesshme VNR-ë. Këto ia vlen të përsëriten shpesh, pasi janë ende një bazë e mirë për të përdorur në mënyrë të kombinuar instrumentat e Normimit më të Mirë:

- Procesi VNR duhet të jetë një pjesë integrale e një strategjie të përgjithshme për të përmirësuar mjedisin rregullator;
- Duhet të ketë mbështetje politike në nivel të lartë për konceptin e VNR-së dhe zbatimin e tij në praktikë;
- Përgatitja e një VNR-së, aty ku mundet, duhet të bëhet nga punonjësit e politikave dhe duhet të fillojë sa më herët të jetë e mundur në procesin e hartimit të politikave, dhe të vazhdojë si pjesë thelbësore e tij;
- Rezultatet e vlerësimit duhet të informohen nga dhe t'i nënshtrohen konsultimit formal e informal me palët e interesuara dhe të tjerë;
- Kjo punë është më efektive kur mbikëqyret nga një strukturë e posaçme që merret me Normimin më të Mirë, dhe mbështetet nga udhëzime të qarta e trajnime; dhe
- Burime të mjaftueshme (në cilësi dhe sasi) duhet t'i vihen në dispozicion kësaj strukture.

politikave. Sfidat kulturore e politike janë të lidhura ngushtë dhe të dyja mund të kapërcehen përmes angazhimit politik dhe përdorimit të instrumenteve në menaxhimin e përditshëm rregullator.

Duhet të shmangen tre gabime të zakonshme gjatë krijimit të një sistemi për vlerësimin e ndikimit<sup>73</sup>. Vlerësimi i ndikimit nuk duhet të përdoret:

- si një justifikim *pas faktit (ex post)* i propozimit për politikë;
- për të krijuar një burokraci tjetër;
- për të përcaktuar problemet që duhet të rregullohen brenda strukturave ekzistuese (disa probleme dalin jashtë kufijve tradicionalë të ministrive, dhe ky fakt duhet të pranohet në këtë proces).

Për sa i përket metodologjisë së vlerësimit të ndikimit, duhet menduar se cilat çështje duhet të kthehen në përparësi për vlerësimin e ndikimit, dhe këtu futen: efekti ekonomik, ndikimi mbi mjedisin, ndikimi mbi bizneset e vogla, si dhe ndikimi mbi vetë shërbimin publik.

Në përgjithësi, shkalla në të cilën mund të zbatohet legjislacioni ose të garantohet respektimi i tij, nuk merret parasysh nga qeveritë përpara se të miratojnë një legjislacion të ri. Megjithatë, në Holandë, Tabela e Njëmbëdhjetëshes, e krijuar nga administrata holandeze, është një instrument për të menduar për respektimin, dhe për të rritur mundësinë që rregulloret të respektohen, nëpërmjet një vlerësimi përputhshmërie *ex ante* (mbështetur mbi parashikimet). Ka 11 aspekte të një rregullimi të propozuar, secili prej të cilëve mund të ulin ose rrisin mundësinë e respektimit të tij. Në marrjen në konsideratë sesi të shkruhet me saktësi legjislacioni dhe sesi të zbatohet dhe publikohet ai, Tabela e Njëmbëdhjetëshes është e dobishme sepse nxjerr në pah ato aspekte që ka mundësi të ulin mundësinë e respektimit, gjë që i bën hartuesit e rregulloreve t'i shkruajnë ato në mënyrë të atillë që ato të bëhen sa më vetë-zbatuese që të jetë e mundur.

---

<sup>73</sup> Gjatë 20 viteve të fundit janë nxjerrë dhe dokumentuar shumë mësimë. Bibliografia gjendet tek Shtojca 5.

**Tabela me njëmbëdhjetë faktorë  
Hartuar në Holandë**

Njëmbëdhjetë faktorët janë:

- ▶ Aspekte të respektimit spontan:
  - njohuri mbi rregulloren
  - kostot e respektimit/përfitimet nga mosrespektimi
  - shkalla e pranimit të këtij normimi nga ana e biznesit dhe popullit
  - besnikëria dhe bindja e natyrshme ndaj formës së normuar
  - shkalla e monitorimit informal
- ▶ aspektet e monitorimit:
  - mundësia për raportim nëpërmjet kanaleve informale
  - mundësia e inspektimit
  - mundësia e zbulimit
  - mundësia e inspektorit
- ▶ aspektet e sanksioneve
  - mundësia për sanksione
  - ashpërsia e sanksioneve

Një hap tjetër në hartimin e një politike efikase për vlerësimin e ndikimit është të kryhen një sërë projektsh pilot për vlerësim ndikimi në disa fusha, përzgjedhur në bazë të një mekanizmi përzgjedhës. Duhet të merren vendime nëse duhet ndjekur i njëjti proces në të gjitha politikat e propozuara, apo duhet të ketë një qasje me dy hapa për të gjitha politikat e propozuara, një hap që ka ndikim më sipërfaqësor, dhe një hap më i hollësishëm për politikat me një ndikim më të thellë.

***Vlerësimi i ndikimit pas faktit (ex post)***

Vlerësimet pas faktit (*ex post*) kanë një qasje shumë të ngjashme me vlerësimin *ex ante* të politikave. Vlerësimet *ex post* mund të përfshijnë një proces konsultimi, për të marrë mendime nga aktorët e interesuar dhe, nëse është e nevojshme, për t'i bërë përmirësime legjislacionit në fjalë.

*Dokumenti i punës i stafit të Komisionit Europian mbi Vlerësimin e ndikimit dhe vlerësimi mbështetur mbi parashikime*<sup>74</sup> nënvizon nevojën për të kryer vlerësime *ex ante* dhe *ex post*. Pak Shtete Anëtare të BE-së kanë procedura për vlerësim të rregullt të veprimtarisë dhe efikasitetit të ligjeve ekzistuese. Në disa Shtete Anëtare<sup>75</sup>, vlerësimet *ex post* kryhen duke shqyrtuar me hollësi një pjesë të përzgjedhur rastësisht të legjislacionit, çdo tremujor. Vlerësimet *ex post* zakonisht kryhen kur bëhen shqyrtime të përgjithshme të legjislacionit ekzistues, p.sh. në kuadër të programit të thjeshtimit. Në raste të tjera, koha kur kryhet vlerësimi *ex post* mund të vendoset kur përgatitet rregullorja e re, dhe, në rrethanat e duhura, mund të përfshihet në tekstin ligjor.

<sup>74</sup> COM(2005)119 përfundimtare, [http://ec.europa.eu/research/future/pdf/comm\\_sec\\_2005\\_0430\\_1\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/research/future/pdf/comm_sec_2005_0430_1_en.pdf).

<sup>75</sup> P.sh. në Mbretërinë e Bashkuar.

### Pyetje të zakonshme të bëra në vlerësimin *ex post*

- ▶ A janë arritur objektivat fillestarë në cilësi, sasi dhe kohë, kur maten përkundrejt bazës, pra se çfarë do të kishte ndodhur pa ndërhyrje?
- ▶ Deri në çfarë shkalle ka sjellë ndërhyrja arritjen e objektiveve, ose ka shkaktuar veprimtari që përndryshe nuk do të kishin ndodhur pa ndërhyrje?
- ▶ A është ndikuar zbatimi, pozitivisht apo negativisht, nga faktorë të jashtëm?
- ▶ A janë shkaktuar efekte anësore të papritura?
- ▶ A kanë qenë si pritëshin kontributet nga qeveria dhe sektori privat?
- ▶ A janë shpërdoruar burimet e caktuara?
- ▶ Sa efikas ka qenë administrimi i skemës?
- ▶ A ka shkaktuar padrejtësi apo disavantazh për ndonjë sektor të komunitetit kjo skemë?
- ▶ A mund të ishte përdorur një qasje më ekonomike?
- ▶ Çfarë përmirësimesh mund t'i bëhen skemës për ta bërë më efektive ose më ekonomike?
- ▶ Në përgjithësi, a është e përshtatshme skema për të arritur objektivat e dëshiruara?

*Burimi:* Përgatitja, hartimi dhe menaxhimi i projekteve legjislative, nga Profesor Keith Patchett — Sigma, janar 2003.

#### ***Pse është i rëndësishëm vlerësimi i ndikimit?***

Vlerësimi i ndikimit është ndoshta instrumenti më i dobishëm, pasi përdorimi i tij sjell analizë ekonomike dhe, nëse përdoret si duhet, mund të jetë një nxitës shkencor për një qasje më të mbështetur në të dhëna për hartimin e politikave. Vlerësimi i ndikimit ndihmon në vendimmarrjen e saktë dhe i bën transparente kostot dhe përfitimet nga alternativat e ndryshme rregullatore e jorregullatore që mund të propozohen nga ministrinë. Megjithatë, vlerësimi i ndikimit nuk zëvendëson llogaridhënien politike.

Vlerësimi i ndikimit nuk është instrument i ri. Ai u përdor në Zyrën e Menaxhimit dhe të Buxhetit (një pjesë e Zyrës së Presidentit të Shteteve të Bashkuara) në vitet 1970 dhe është përdorur nga shumë vende që atëherë. Sa vjen e më shumë qeveri dhe institucione të Bashkimit Europian po e konsiderojnë vlerësimin e ndikimit si një instrument thelbësor të qeverisjes.

Kryerja e vlerësimit të ndikimit mund të kontribuojë edhe në përmirësimin e respektimit të legjislacionit, si në rastin e vlerësimit *ex ante*, nëpërmjet përdorimit të vlerësimit të përputhshmërisë, ashtu dhe në rastin e vlerësimit *ex post*, meqë vlerësimet *ex post* mund të ndihmojnë në identifikimin e pasojave rregullatore të papritura, me qëllim përmirësimin e rregulloreve aty ku nuk janë arritur objektivat fillestarë.

#### ***Sistemi i vlerësimit të ndikimit në BE***

Komisioni Europian ka nisur një sistem të ri të vlerësimit të ndikimit në vitin 2003. Ky sistem është ndërtuar duke u mbështetur pjesërisht në përvojën me paraardhësin e tij, Vlerësimi i Ndikimit mbi Biznesin. Një përmbledhje e tij u përfshi në Deklaratën mbi Vlerësimin e Ndikimit<sup>76</sup>, i cili ishte pjesë e Planit të Veprimit për Normim më të Mirë<sup>77</sup>. Vlerësimi i ndikimit u përmirësua më tej në vitin 2005<sup>78</sup>. Procedura e re ka për synim të përmirësojë cilësinë e propozimeve të Komisionit për politika për sa i përket efikasitetit, efektivitetit dhe koherencës së tyre. Ajo identifikon alternativa të ndryshme politikash dhe ndikimet e tyre të mundshme, pozitive apo negative, duke u përqendruar në mënyrë të barabartë mbi pasojat ekonomike, mjedisore dhe shoqërore, në përputhje me Strategjinë e BE-së për Zhvillim të Qëndrueshëm<sup>79</sup>. Në mars të vitit 2006, Udhëzimet për Vlerësimin e Ndikimit të vitit 2005, u përditësuan,

<sup>76</sup> COM(2002)276 finale, po aty.

<sup>77</sup> COM(2002)278 finale, po aty.

<sup>78</sup> Komisioni Europian (2005), Udhëzimet për Vlerësimin e Ri të Ndikimit, qershor 2005, SEC(2005)791, [http://ec.europa.eu/governance/impact/docs/SEC2005\\_791\\_IA%20guidelines\\_annexes.pdf](http://ec.europa.eu/governance/impact/docs/SEC2005_791_IA%20guidelines_annexes.pdf).

<sup>79</sup> COM(2001)264 finale, [http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/com/2001/com2001\\_0264en01.pdf](http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/com/2001/com2001_0264en01.pdf).



duke e kthyer tani vlerësimin e kostove administrative në një veprim të detyrueshëm dhe një pjesë përbërëse të vlerësimeve të ndikimit.

Për të përforcuar kontrollin e cilësisë, Komisioni njoftoi me anë të Komunikatës së Vlerësimit Strategjik<sup>80</sup> krijimin e një Bordi për Vlerësimin e Ndikimit. Ai përbëhet nga zyrtarë të nivelit të lartë të Komisionit nga DG-të ECFIN, ENV, EMPL dhe ENTR, dhe kryesohet nga Zv. Sekretari i Përgjithshëm. Bordi vepron në mënyrë të pavarur nga departamentet që hartojnë politika, dhe raporton drejtpërsëdrejti tek Presidenti i Komisionit. Ai jep mendime mbi cilësinë e vlerësimeve të ndikimit. Në ndihmë të tij, Bordi mund të zgjedhë të kërkojë ndihmë nga ekspertë të jashtëm. Bordi ka filluar punë në dhjetor të vitit 2006 dhe tashmë ka dhënë disa mendime.

Sistemi i vlerësimit të ndikimit i Komisionit, në përgjithësi, iu nënshtroa një shqyrtimi të plotë e të pavarur nga këshilltarë të jashtëm gjatë vitit 2006, dhe raporti përfundimtar iu dorëzua Komisionit kohët e fundit. Ai do të përdoret për të identifikuar fushat që kanë nevojë për përmirësim.

### **Vlerësimi i ndikimit në Shtetet e Reja Anëtare**

Në kohën e vlerësimeve, **Qipro dhe Malta** nuk kishin një politikë të zhvilluar plotësisht mbi vlerësimin e ndikimit, megjithëse ajo çështje ishte duke u marrë në konsideratë në të dyja vendet. Nevoja për vlerësimin e ndikimit kuptohej dhe përdorej në kuadër të vlerësimeve të ndikimit në mjedis në të dyja vendet dhe për disa projekte në shkallë të gjerë ku përfshiheshin shuma të mëdha parash. Vlerësimi i ndikimit, efektit nuk përdorej si një instrument për të përmirësuar cilësinë e krijimit të politikave apo hartimit të legjislacionit. **Qipro** krijoi një task forcë për të trajtuar këtë çështje, kurse në **Maltë**, Njësia për Normim më të Mirë në Sektorin e Eficiencës së Menaxhimit ka filluar disa veprimtari që do të çojnë në përdorimin e vlerësimit të ndikimit.

Të gjitha SHRA-të e tjera e kanë filluar vlerësimin e ndikimit në një formë apo në tjetrën. Megjithatë, disa SHRA (**Republika Çeke, Lituania, Polonia dhe Republika Sllovake**) kishin arritur në atë fazë ku pranonin se vlerësimi i ndikimit ekzistonte më shumë në formë sesa në thelb. Në të gjitha SHRA-të, me përjashtim të **Qipros dhe Maltës**, vlerësimi i ndikimit ishte i detyruar me ligj në rastin e propozimeve që duhet të çohen në qeveri.

### **Baza ligjore**

Në **Republikën Çeke**, Rregullat e Procedurave të Qeverisë (RPQ)<sup>81</sup> kërkojnë që të gjitha propozimet për politika të përfshijnë një analizë të ndikimit në klimën e biznesit dhe të efektit mbi trajtimin e barabartë të meshkujve dhe femrave. Masa të ngjashme ligjore ka në fuqi dhe në **Hungari, Lituani, Poloni, Republikën Sllovake dhe Slloveni**. Në mungesë të një kontrolli qendror mbi cilësinë e tyre, këto masa zakonisht lihen mënjanë.

Në **Estoni**, vlerësimet e ndikimit ishin të detyrueshme për të gjitha propozimet për legjislacion të ri. Vlerësimet e ndikimit rregullator u përfshinë si pjesë e një dokumenti shpjegues për projektligjet që nga viti 1996 e në vazhdim. Një ministri që harton legjislacion, në përputhje me Rregullat e Qeverisë, përgatit një analizë të ndikimeve të mundshme. Si parlamenti (*Riigikogu*) ashtu dhe qeveria respektojnë rregullat teknike të hartimit të legjislacionit, të cilat përfshijnë nevojën për të shqyrtuar një listë të pasojave që duhet të vlerësohen kur hartohet legjislacion. Në shkurt të vitit 2005 hyri një fuqi një rregull i ri, sipas të cilit çdo ministër dhe sekretar shteti mund të japë rekomandime shtesë në lidhje me metodologjinë e vlerësimit të ndikimit rregullator në fushat e tyre përkatëse të kompetencave.

Në **Letoni**, në vitin 1998, në Rregullat e Procedurave të Qeverisë u fut dhe sistemi i vlerësimit të ndikimit. Metodologjia e hollësishme e vlerësimit të ndikimit përshkruhet në një udhëzim qeveritar.

---

<sup>80</sup> COM(2006) 689 finale.

<sup>81</sup> Që në vitin 2001.

### *Transparenca e vlerësimeve të ndikimit*

Në disa Shtete të Reja Anëtare janë publikuar vlerësimet e ndikimit. Për shembull, në **Letoni**, përpara se të hartohet një rregullore, merret në shqyrtim nevoja për normim dhe përshkrimi i sistemit aktual duhet të përfshihet në Dokumentin e Konceptit<sup>82</sup>. Projektligjet në **Estoni** duhet të shoqërohen me një shkresë shpjeguese. Kjo shkresë shpjeguese bëhet që të detyrojë hartuesin e ligjit të propozuar të shpjegojë kuptimin e projektligjit në gjuhë të thjeshtë. Përfshirja e analizës krahasuese dhe vlerësimeve të ndikimit në këtë shkresë është një mënyrë e dobishme për të shpjeguar pse janë parapëlqyer disa zgjidhje të caktuara.

### *Metodologjitë*

Të gjitha SHRA-të që kryejnë vlerësime të ndikimit kanë metodologji të ndryshme për to. Mund të shihen dy prirje kryesore: disa SHRA kanë udhëzime ose janë duke rishikuar udhëzimet ekzistuese; të tjerat e lënë metodologjinë në dorën e ministrisë që kryen atë vlerësim.

Në **Republikën Çeke** udhëzimet për vlerësimin e ndikimit rregullator (2006) u zhvilluan mbështetur në metodologjinë e Mbretërisë së Bashkuar dhe metodologjinë e re të BE-së. Kjo punë ishte planifikuar të përfundonte deri në fund të vitit 2006. 50 nëpunës civilë morën një trajnim nga Instituti i Administratës Shtetërore (Njësia Qendrore e Trajnimit) mbi këtë koncept dhe metodologjinë e BE-së.

Në **Hungari**, që në janar të vitit 2006 u zbatua një procedurë e re mbi Metodologjinë e Vlerësimit të Ndikimit të Rregullimeve, mbështetur në një manual të hartuar nga Departamenti i Analizës së Ndikimit, Normimit dhe Regjistrimit të Ligjit. Ai zbatohet gjatë fazës përgatitore të hartimit të ligjeve dhe rregulloreve. Masat e përshkruara në manual mund të përdoren gjatë përgatitjes së propozimeve legjislative, dhe (me disa ndryshime) mund të zbatohen edhe në organizata të tjera administrative.

Në **Letoni**, në Udhëzimet mbi Planifikimin e Politikave (2001) është përcaktuar një qasje e përgjithshme për vlerësimin e ndikimit në dokumentet rregullatore. Metodologjia e vlerësimit të ndikimit rregullator është përcaktuar në Udhëzimin Qeveritar të titulluar "plotësimi i komenteve mbi projekt-ligjet"<sup>83</sup>. Ka edhe një Manual mbi Metodën e Vlerësimit të Ndikimit, i cili përdoret gjatë planifikimit të politikave dhe hartimit të ligjit. Ai manual u përgatit nga Kancelaria e Shtetit dhe u publikua në vitin 2005. Ai trajton metodat sasiore që përdoren në vlerësimet e ndikimit, të tilla si p.sh. analizën kosto-përfitim, analizën e efektivitetit të koston dhe analizën e rrezikut.

Në **Lituani** është hartuar një Manual mbi Vlerësimin e Ndikimit Rregullator. Ai rekomandon që institucionet që merren me legjislacionin e BE-së, ose që hartojnë propozime që mund të kenë efekte të konsiderueshme ekonomike apo shoqërore, duhet të kryejnë Vlerësimin e Ndikimit Rregullator duke përdorur instrumente të ndryshme si analizën kosto-përfitim apo studime të tjera gjithëpërfshirëse.

Në **Poloni**, që të rritet efikasiteti i procesit të VER-it, Ministria e Ekonomisë përgatiti Udhëzime të reja për VER, të cilat u miratuan në tetor të vitit 2006. Pasi të përdoren këto udhëzime për 12 muaj, është planifikuar të vlerësohet efikasiteti i tyre. Në vitin 2006 u zbatuan masa institucionale për VER-in në mënyrë që të forcohej sistemi i VER-it, përfshirë këtu caktimin e përgjegjësive për shqyrtimin e VER-it në Kancelarinë e Kryeministrit, dhe jo më në Qendrën Qeveritare të Legjislacionit, ku ishte deri në korrik të vitit 2006.

Udhëzimet e reja sqarojnë hapat kryesorë analitikë që duhet të merren gjatë një VER-i. Udhëzimet përbëhen nga një grup hapash logjike të cilat strukturojnë përgatitjen e propozimeve për politika që nga identifikimi i problemit, përzgjedhja e objektivave dhe alternativave kryesore të politikave, duke krahasuar alternativat e mundshme, duke vlerësuar kostot dhe përfitimet e çdo alternative e deri tek rekomandimi në fund i zgjidhjes më të mirë.

---

<sup>82</sup> Procedurat për plotësimin e komenteve për projekt-rregullore 18.09.2001.

<sup>83</sup> Udhëzimi Nr. 4, 18.09.2001.

Theksi në udhëzimet e rishikuara iu vu:

- vlerësimin të ndikimit nga ana sasiore, cilësore dhe monetare, aty ku është e mundur dhe e përshtatshme;
- vlerësimin të ndikimit mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- kryerjes së konsultimit të gjerë përpara se të propozohet një legjislacion.

**Republika Sllovaqe** jep një shembull të mirë se si një politikë e vlerësimit të ndikimit mund të cenohet nëse nuk ka një metodologji të unifikuar për vlerësimin e ndikimeve. Ministria e Drejtësisë kreu një studim mbi cilësinë e përgjithshme të Shtojcave të dorëzuara në Këshillin e Ministrave. U vërejtën problemet e mëposhtme:

- Shumë Shtojca ishin të paqarta, të pasakta apo përmbanin të dhëna jo të plota;
- Një numër i madh Shtojcash nuk ishin përgatitur në përputhje me rregullat për përgatitjen e tyre;
- Disa Shtojca nuk përmbanin të gjithë informacionin përkatës;
- Në disa raste, dokumentet e dorëzuara në Këshillin e Ministrave nuk përmbanin një Shtojcë;
- Shumë shpesh, autori i dokumentit apo draftit nuk ka dorëzuar propozimin për mbulimin e kostove të parashikuara;
- Pjesa e dytë e Shtojcës (ndikimi mbi biznesin dhe shtetasit) është përgatitur pothuajse gjithmonë në mënyrë shumë të përgjithshme dhe pa kostot përkatëse.

Këto probleme vinin pjesërisht për shkak të mungesës së kapaciteteve analitike dhe arsimimit dhe trajnimit të pamjaftueshëm të personelit të ministrive. Punonjësit që hartojnë legjislacionin duket se kishin qasje të ndryshme për dhënien e informacionit, dhe kishin prirje të përqendroheshin tek nevoja për të përshpejtuar procesin legjislativ dhe shmangur konfliktet me Ministrinë e Financave.

Duhet trajtuar pika e dobët e këtij procesi. Këshilli i Ministrave në korrik të vitit 2005<sup>84</sup> nxori një vendim i cili detyron Ministrinë e Financave, Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Çështjeve Sociale dhe Ministrinë e Ekonomisë që të hartojnë metodologji të unifikuara për vlerësimin në Shtojcën për ndikimet financiare, ekonomike, mjedisore, shoqërore dhe mbi klimën e biznesit.

Në **Slloveni**, Grupi për Normim më të Mirë (reformën rregullatore)<sup>85</sup> është përgjegjës për hartimin e një metodologjie për vlerësimin e ndikimit. Gjithashtu, Zyra Qeveritare për Legjislacionin si dhe Departamenti i Fletores Zyrtare bashkëpunojnë për të krijuar një e-portal<sup>86</sup>. Ai do t'u mundësojë përdoruesve të kryejnë një vlerësim të ndikimit apo të kontrollojnë dhe verifikojnë rezultatet e vlerësimeve të tyre me aktorët e interesuar. Në praktikë, nëpërmjet këtij portali, shtetasit do të kenë mundësinë të komentojnë rreth një projektligji, dhe rezultatet e procesit të konsultimit do të përpunohen automatikisht dhe do të integrohen në një raport të formatuar më parë.

### **Masat institucionale**

Në **Republikën Çeke**, një Departament për Reformën Rregullatore dhe Cilësinë e Administratës Publike, i krijuar pas transferimit të Njësisë së Normimit më të Mirë nga Zyra e Qeverisë tek Ministria e Brendshme në nëntor të vitit 2006, luan rolin e një pozicioni ndihme dhe kontrollon cilësinë e vlerësimeve të ndikimeve të kryera për të gjitha rregulloret e propozuara.

Në **Estoni**, qasja ndaj vlerësimit të ndikimit ndryshon nga ministria në ministri, dhe nuk ka një organ qendror për të analizuar cilësinë e tij. Për shembull, Ministria e Çështjeve Sociale, si pjesë e nismave të saj për menaxhimin e procesit, ka hartuar një procedurë për hartimin e legjislacionit që përfshin si konsultimin me publikun (gjatë fazës së hershme të bërjes së politikës) ashtu dhe vlerësimet e ndikimit rregullator.

<sup>84</sup> Rezoluta e Kabinetit Nr. 557/2005.

<sup>85</sup> Përfshin përfaqësues nga Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Ekonomisë.

<sup>86</sup> Portali e- Sodelovanje [www.esodelovanje.si](http://www.esodelovanje.si).

Ministria e Financave dhe Ministria e Mjedisit kanë ndërmarrë nisma të ngjashme. Disa individë në disa ministri janë më të përkushtuar për përmirësimin e vlerësimit të efektit sesa disa të tjerë, dhe në Ministrinë e Mjedisit është ngritur një komitet për të shqyrtuar dhe përmirësuar qasjen e saj për vlerësimin e efektit.

Në **Hungari** u krijua një Departament për Analizën e Efektit, Normimin dhe Regjistrimin e Ligjit, por nuk iu dha asnjëherë zyrtarisht përgjegjësia e përgjithshme për shqyrtimin e cilësisë së vlerësimeve të efektit. Ky departament u shpërbë në korrik të vitit 2006. Megjithatë, Departamenti Juridik në Zyrën e Qeverisë, megjithëse nuk ka rol në shqyrtimin apo kryerjen e vlerësimit të efektit në nivel qendror, mund ta vërë në dukje mungesën e kësaj analize në raportin e tij drejtuar qeverisë.

Në **Letoni**, vlerësimet e efektit janë të detyrueshme për të gjitha propozimet për politika dhe projektligjet që kanë një pasojë social-ekonomike apo një ndikim në buxhetin e shtetit. Vlerësimet e efektit shqyrtohen në Kancelarinë e Shtetit dhe në ministrinë e linjës, në përputhje me kompetencat e tyre përkatëse. Vlerësimet e efektit që nuk janë të standardit të kërkuar i kthehen ministrisë.

### ***Çfarë vlerësohet?***

Tabela e mëposhtme jep një pamje të përgjithshme të një kampioni përfaqësues të efekteve të vlerësuara.

Në disa vende zbatohet një qasje me dy hapa, ku vlerësimi i thellë është i nevojshëm vetëm për ato dokumente legjislativë që pritet të kenë një ndikim mbi mjedisin e biznesit.

Në **Slovaki**, metodologjia për vlerësimin e ndikimit tek biznesi që po hartohet në Ministrinë e Ekonomisë gjatë kohës kur shkruhet ky raport<sup>87</sup> mbështetur në metodologjinë holandeze, kërkon që Ministria të kryejë një “kontroll të shpejtë” për të dalë me një vlerësim të përafërt të efekteve të mundshme. Vlerësimi i plotë, i hollësishëm është i detyrueshëm për ato dokumente legjislativë që normojnë çështje të rëndësishme. Një qasje e ngjashme ndiqet edhe në **Poloni**.

---

<sup>87</sup> Mars 2006.

<p><i>Efektet që vlerësohen në Estoni</i></p>	<p>Efekti i një projekt-ligji në buxhetin e shtetit apo buxhetet e pushtetit vendor.</p> <p>Efekti mbi situatën social-ekonomike, jetën dhe mundësitë e përditshme të grupeve të shënjestruara [personat me role të caktuara] (p.sh. cilat grupe social-ekonomike do të përfitojnë apo humbasin në aspektin ligjor, ekonomik apo shoqëror).</p> <p>Efekti mbi ekonominë dhe situatën e bizneseve, p.sh. inflacioni, konkurrenca, etj.</p> <p>Efekti mbi organizimin e punës së institucioneve të shtetit dhe pushtetit vendor (p.sh. ndryshimet në strukturë dhe funksione, në shërbimet publike, në numrin e punonjësve, delegimin e detyrave).</p>
<p><i>Efektet që vlerësohen në Letoni</i></p>	<p>Efekti social-ekonomik</p> <p>Efekti makro-ekonomik</p> <p>Efekti mbi klimën e biznesit</p> <p>Efekti social i legjislacionit të propozuar</p> <p>Ndikimi në mjedis</p> <p>Efekti mbi buxhetin e shtetit dhe ato të pushtetit vendor</p> <p>Efekti i projekt-rregulloreve mbi sistemin ligjor</p> <p>Efekti mbi detyrimet ndërkombëtare (sidomos të BE-së).</p>

<p><i>Efektet që vlerësohen në Poloni</i></p>	<p>Në një vlerësim efekti në Poloni duhet të referohen pikat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Tregoni kush ndikohet;</li> <li>▪ Paraqitni rezultatet e ndonjë konsultimi të kryer;</li> <li>▪ Identifikoni efektet mbi: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ financat publike, përfshirë buxhetin e shtetit dhe atë vendor,</li> <li>○ tregun e punës,</li> <li>○ konkurrencën,</li> <li>○ sipërmarrjet,</li> <li>○ zhvillimin rajonal;</li> </ul> </li> <li>▪ Tregoni burimet financiare.</li> </ul> <p>Metoda e vlerësimit varet nga qëllimi i propozimit (draftit). Në rastin e rregullimeve të rëndësishme, duhet të bëhet një vlerësim sasior. Në rastin e rregullimeve të tjera, vlerësimi kufizohet në një analizë cilësore. Metoda më e zakonshme sasiore e përdorur është analiza kosto-përfitim. Megjithatë, ka dhe disa metoda të tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ analiza e efektivitetit të kostos,</li> <li>▪ vlerësimi i kostos (preventivi),</li> <li>▪ vlerësimi i përfitimit.</li> </ul>
<p><i>Efektet që vlerësohen në Republikën Sllovaqe</i></p>	<p>vlerësimi i efekteve mbi financat publike, vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin, vlerësimi i ndikimit mbi punësimin, vlerësimi i efekteve mbi shtetasit dhe bizneset, vlerësimi i efekteve mbi klimën e biznesit</p>

### ***Pas faktit (ex post)***

Në **Qipro dhe Maltë**, përgjegjësia për kryerjen e analizës *ex post* të rregulloreve dhe programeve të zbatimit të politikave bie mbi departamente të veçanta të politikave, ose shërbimet kërkimore të posaçme të ministrive. Disa ministri kanë kryer studime për të vlerësuar efektivitetin e politikave, duke përdorur metoda të ndryshme.

Në **Estoni**, përgjegjësia për kryerjen e analizave të efektit *ex post* të rregulloreve dhe programeve të zbatimit të politikave bie gjithashtu mbi departamente të veçanta të politikave ose mbi shërbime kërkimore të posaçme të ministrive. Nuk bëhet vlerësim i jashtëm i zbatimit të politikave apo efektivitetit të rregulloreve. Për shembull, Ministria e Mjedisit (Departamenti i Pyjeve) në vitin 1996 urdhëroi kryerjen e një vlerësimi efekti *ex post* rreth Ligjit mbi Pyjet.

Ministri të tjera kanë kryer studime për të vlerësuar efektivitetin e politikave, përfshirë aspekte të tatimit mbi të ardhurat, sigurimet shoqërore, skemat e pensionit, përfitimet prindërore, taksat dhe financimit të OJQ-ve, politikat e zhvillimit rajonal, reformën e pronësisë në zonat rurale dhe përfitimet e studentëve. Vlerësimet kryhen rregullore pas rregulloreje, dhe çështje pas çështjeje.

Vlerësimet *ex post* ndërmerren duke përdorur metoda të ndryshme; disa përqëndrohen më shumë në praktikën, disa më shumë në aspektet shoqërore. Shumë varet nga vetë çështja që po vlerësohet. Disa politika shqyrtohen si pjesë e planifikimit të buxhetit për vitin pasardhës, dhe kjo veprimtari mund të shihet

e pasqyruar në planin vjetor të veprimtarive të ministrisë. Përfaqësuesit e grupeve të synuara dhe palëve të tjera të interesuara (p.sh. qendra kërkimore apo ministri të tjera) përfshihen në vlerësimin dhe vlerësimin e efektit *ex post* të rregulloreve ekzistuese. Për shembull, në mars të vitit 2005, grupi i punës për Ligjin e ri të Pyjeve përfshinte të gjitha palët e interesuara.

### **Konsultimi në përgjithësi**

Konsultimi mund të përkufizohet si një “angazhim i strukturuar publik, i cili përfshin kërkimin, marrjen, analizimin dhe përgjigjen ndaj komenteve të aktorëve të interesuar”. Ai përfshin përcaktimin e qëllimit dhe temën e konsultimit (nismë për politikë, ndryshim rregullorë, propozim legjislativ). Në shumicën e vendeve, konsultimi zakonisht kryhet për legjislacion parësor, dhe shumë rrallë për legjislacionin dytësor. Ai gjithashtu përfshin hartimin e një metodologjie konsultimi, përfshirë kriteret për identifikimin e aktorëve të përfshirë.

Mundësia për konsultim është funksion i forcës së shoqërisë civile dhe i procedurave të përdorura, kështu që parimet e shtruara për konsultim duhet të marrin parasysh disa faktorë të brendshëm kulturorë e shoqërorë, si dhe organizimin institucional kombëtar.

Disa vende kanë miratuar udhëzime mbi konsultimin, duke dhënë në këtë mënyrë mbështetjen e nevojshme politike për procesin e konsultimit brenda sistemit shtetëror. Udhëzimet duhet të jenë elastike dhe të marrin në konsideratë nivelet e ndryshme të organizimit nga aktorët e interesuar. Duhet të përcaktohet një afat kohor i përgjithshëm për konsultimet për projektligjet, dhe respektimi i parimeve duhet të shqyrtohet në qendër të qeverisë. Procesi i konsultimit duhet të lidhet ngushtë me procesin e vlerësimit të efektit rregullator.

Elementët e nevojshëm janë si më poshtë:

- Rekomandime si të përzgjidhen aktorët, për të siguruar një kontribut të gjerë e të dobishëm.
- Një kohë minimale për konsultim të jashtëm duhet të përcaktohet.
- Sisteme për të garantuar se rekomandimet për përzgjedhje dhe kohën minimale do të respektohen.
- Përhapja e praktikave më të mira.

Duhet të bëhet dallim mes konsultimit brenda qeverisë në fazën e procedurës së dhënies së mendimeve ndërministrorë, dhe konsultimit me publikun në përgjithësi, që mund të kryhet nëpërmjet disa procedurave të ndryshme. Në këtë aspekt mund të identifikohen tre forma konsultimi me publikun:

- konsultim me organe të krijuara, si p.sh. komitete trepalëshe;
- konsultim me grupe këshilluese *ad hoc*;
- njoftim publik i publikuar në internet dhe i dorëzuar për koment publik, i cili mund të ndihmojë konsultimet në proces e sipër.

### ***Pse duhet bërë konsultimi?***

Përdorimi i konsultimit publik ka pasoja të ndryshme për përmirësimin e kuadrit rregullator.

Së pari, nëse ai kryhet në kohën dhe mënyrën e duhur, konsultimi tërheq inteligjencën kolektive të një shoqërie. Ai po përdoret gjithnjë e më shumë për të mbledhur informacion praktik për qëllime analitike, e sidomos si një parakusht për ecjen drejt modeleve të mbështetura tek analiza të proceseve vendimmarrëse (p.sh. përdorimi i vlerësimeve të efektit për të matur efektin e rregulloreve). Pra konsultimi është një burim ekonomik të dhënash, si dhe burim informacioni mbi çështje si pranueshmëria e politikave të ndryshme, që mund të jetë thelbësore në përcaktimin e praktikitetit dhe hartimin e strategjive për përputhshmëri e zbatim. Si rrjedhojë, një proces konsultimi është një instrument i vlefshëm për të përmirësuar legjitimitetin dhe besueshmërinë e veprimeve të qeverisë. Gjithashtu, në disa vende, këto të dhëna dhe ky informacion mund të përdoren kur kryhen vlerësime të efektit rregullator.

Së dyti, mekanizmat e konsultimit po karakterizohen sa vjen e më shumë nga një hapje dhe akses më i madh, sidomos për interesa më të vogla e më pak të organizuara. Kjo pasqyron një largim nga mënyrat korporatiste të qeverisjes, drejt qasjeve më pluraliste. Konsultimi është një tipar thelbësor i qeverisjes transparente dhe efektive.

Së fundmi, konsultimi është një proces partneriteti që mund të përmirësojë cilësinë e legjislacionit duke përfshirë ekspertizën e shoqërisë civile.

### ***Konsultimi në BE***

Komisioni ka një traditë të gjatë të konsultimit me palët e interesuara mbi politikat dhe propozimet e tij rregullatore. Në mënyrë që të përmirësohen proceset e tij konsultuese, Komisioni ka miratuar “*Parimet e Përgjithshme dhe Standardet Minimale për Konsultim me Palët e Interesuara*”<sup>88</sup>. BE-ja e vlerëson shumë konsultimin me palët e interesuara<sup>89</sup>, dhe mbledhjen dhe përdorimin e ekspertizës<sup>90</sup>, të cilat janë të dyja një pjesë përbërëse të procesit.

Këto parime dhe standarde sigurojnë një kuadër për konsultimin me shoqërinë civile dhe aktorët, gjë që garanton transparencë dhe akses në konsultime, mendime për kontribuuesit dhe një kohë përgjigjeje prej minimumi 8 javësh. Ky veprim lidhet me procedurën e vlerësimit të efektit dhe, si hap i parë, zbatohet në ato nisma që i nënshtrohen vlerësimeve të efektit. Megjithatë, shërbimet e Komisionit nxiten për t’i zbatuar ato rregulla edhe në çdo konsultim që dëshirojnë të kryejnë.

Të gjitha konsultimet me interes të veçantë për bizneset dhe organizatat profesionale mund të shihen nëpërmjet faqes së internetit të dedikuar të “DG Enterprise and Industry”, *Ndërmarrjet dhe Industria në Dialog*. Informacion mbi konsultimet e “DG Enterprise and Industry” mund të merren edhe nëpërmjet “Zëri juaj në Europë” (*Your Voice in Europe*), pikës së vetme të aksesit që ka Komisioni për të gjitha konsultimet e tij publike.

### **Konsultimi në Shtetet e Reja Anëtare**

#### ***Baza ligjore***

Në pjesën më të madhe të SHRA-ve (**Estonia, Letonia, Lituania, Polonia, Republika Sllovaqe dhe Sllovenia**), konsultimi është një kërkesë e detyrueshme në procesin e hartimit të politikave. Në **Lituani**, megjithëse konsultimet publike lihen në dorë të institucioneve, disa ligje të rëndësishme si Ligji mbi Administratën Publike dhe Ligji mbi Vetëqeverisjen Vendore e bëjnë konsultimin të detyrueshëm.

#### ***Metodologjia***

Të gjitha SHRA-të kanë përzgjedhur metoda të ndryshme të kryerjes së konsultimeve. Megjithatë, procedurat e konsultimit nuk janë standardizuar në asnjë SHRA, dhe madje ndryshojnë nga njëra ministri në tjetrën. Gjithashtu, forma e konsultimit varet shumë shpesh edhe nga çështja dhe kompleksiteti i saj, si dhe nga organi apo personat e konsultuar. Këto ndryshime mund të rrezikojnë besueshmërinë e konsultimeve. Faktori i vetëm i përbashkët që kanë është se asnjë nga vendet nuk ka një politikë të shkruar e koherente.

Në vendet ku shoqëria civile është më e zhvilluar (**Qipro, Estoni dhe Maltë**), proceset e konsultimit kryhen në faza të ndryshme të procesit të hartimit të rregulloreve, mbi bazën e një praktike të pranuar dhe të rrënjësuar në traditën e dialogut social dhe të konsensusit. Megjithatë, kjo nuk përjashton disa forma udhëzimesh apo procedurash të përcaktuara. Në **Letoni dhe Slloveni**, ku ka pak përvojë konsultimi nga Organizatat joqeveritare (OJQ), po hartohen politika për të trajnuar përfaqësues të OJQ-ve mbi metodologjitë e konsultimit.

<sup>88</sup> COM(2002)704 final, po aty.

<sup>89</sup> COM (2002) 704 final, po aty.

<sup>90</sup> COM(2002)713 final, [http://ec.europa.eu/governance/docs/comm\\_expertise\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/governance/docs/comm_expertise_en.pdf).



Në **Qipro** dhe **Maltë**, konsultimet nuk janë të detyrueshme dhe nuk ka procedura të miratuara për t'i kryer ato. Megjithatë, janë krijuar disa procedura konsultimi më të përcaktuara. Për shembull *Kodi i Praktikës së Konsultimit* i Autoritetit të Mjedisit dhe Planifikimit në Maltë përshkruan procesin e hartimit të politikave si dhe jep udhëzime mbi arsyet dhe mënyrat sesi do të kryhet konsultimit. Gjithashtu, lista e kontrollit e bën konsultimin të detyrueshëm në rastin e legjislacionit dytësor.

Megjithatë, përveç **Qipros** dhe **Maltës**, shumë prej vendeve të vlerësuara nuk kishin një traditë në procesin e konsultimit. Shumë zyrtarë me të cilët folëm gjatë vlerësimit shprehën mendimin se konsultimi ishte një proces i lodhshëm dhe se shoqëria civile nuk kishte kapacitetin për t'iu përgjigjur procedurave të konsultimit; megjithatë, këta zyrtarë nuk thanë se administrata e di çfarë është më e mirë për qytetarin.

### ***Konsultimi me publikun***

Në shumë SHRA, legjislacioni i miratuar kohët e fundit e bënte të detyrueshëm publikimin e projekt-rregulloreve në një faqe interneti zyrtare, në mënyrë që çdo shtetas të mund të komentonte mbi të. Megjithatë është tepër herët për të gjykuar se çfarë vlere i është shtuar nga konsultimet.

Në **Hungari**, në përputhje me seksionin 19 të Ligjit<sup>91</sup> mbi Mbrojtjen e të dhënave personale dhe aksesin e hapur të publikut për informacion, shteti, pushteti vendor apo organizata të tjera publike të përcaktuara me ligj kanë për detyrë të publikojnë në mënyrë elektronike apo në forma të tjera të gjitha të dhënat që kanë lidhje me veprimtaritë e tyre. Ministrinë afishojnë tekstet e projekt-rregulloreve në stendat e buletinit publik në të ashtuquajturin rrjet “Merimanga e Gjelbër”, mbështetur në konceptin e “legjislacionit të hapur”, sipas të cilit, në bazë të Ligjit mbi Lirinë e informacionit elektronik, projektligjet publikohen në internet, së bashku me një afat për dorëzimin e komenteve.

Në **Letoni**, të gjitha propozimet e rëndësishme vendosen në faqen e internetit të Kancelarisë së Shtetit përpara se të shqyrtohen në takimin e përjavshëm të Sekretarëve të Shtetit.

Në **Poloni**, që pas *Ligjit mbi Lobimin*, të gjitha politikat dhe nismat qeveritare duhet t'i komunikohen publikut (sidomos nëpërmjet faqeve të internetit të ministrive). Ai ligj garanton të drejtën e gjithsecilit për të bërë koment mbi propozimet legjislative. Gjithashtu, lobistët profesionistë e të licencuar i komunikojnë komentet e tyre mbi një draft të caktuar, dhe mund ta lexojnë draftin në Buletinin për Informimin e Publikut.<sup>92</sup> Megjithatë, shumica e materialit mbi aksesin në legjislacion është i përfshirë në Ligjin mbi Aksesin në Informacionin Publik.

Në **Republikën Sllovaqe**, në përputhje me Ligjin për lirinë e informacionit, të gjitha dokumentet legjislative, përfshirë udhëzime dhe projekt propozime për normim ligjor janë të disponueshme në faqet e internetit të qeverisë.

Vlen të përmenden disa praktika konsultimi: Në **Estoni**, nisma “Bashkëbisedim në Internet”<sup>93</sup> është një mënyrë inovative për të përfshirë shtetasit në formulimin e politikave dhe hartimin e legjislacionit. Gjithsecili ka mundësinë të regjistrohet në faqen e internetit dhe nëpërmjet asaj të marrë njoftime me postë elektronike rreth konsultimeve dhe ndryshimeve në planin e punës për hartimin e dokumenteve legjislative. Në **Letoni**, në vitin 2005 u hartua një Memorandum Mirëkuptimi mes qeverisë dhe OJQ-ve, si dhe u publikuan manuale për OJQ-të dhe u ofrua trajnim për punonjësit mbi teknikat e konsultimit. Gjithashtu, një përfaqësues i OJQ-ve mund të marrë pjesë në takimin e Sekretarëve të Shtetit dhe në takimet e Kabinetit të Ministrave si vëzhgues dhe mund të bëjë propozime.

### ***Konsultimi me organet e krijuara dhe me aktorët e interesuar***

Në SHRA konsultimi me përfaqësues të biznesit dhe shoqërisë civile shpesh kryhet nëpërmjet takimesh të rregullta të një komiteti të përbërë nga përfaqësues të organizatave shoqërore dhe OJQ-ve, si p.sh. në

<sup>91</sup> LXIII/1992 në fuqi që në 1 qershor 2005.

<sup>92</sup> Urdhëri Nr. 1/2006 (I. 7.) GKM mbi Komunikatën e Ministrisë.

<sup>93</sup> [www.mkm.ee/index.php?id=8252](http://www.mkm.ee/index.php?id=8252).

**Qipro, Hungari, Lituani dhe Poloni**, ose duke ndjekur nisma më *ad hoc*, ose dhe një kombinim të të dyjave, si në **Republikën e Sllovakisë**. Gjithsesi, nga këndvështrimi i palës konsultuese, nuk është gjithmonë e lehtë të identifikohen organizatat e përkatëse apo personat në organizata që janë më të përshtatshëm për tu marrë mendim.

Në **Qipro**, në varësi të çështjes dhe të legjislacionit ekzistues, mund të kërkohet shqyrtimi i propozimit nga një komitet si p.sh. Bordi Këshillimor i Punës ose Komiteti i Stafit të Përbashkët. Këtij të fundit i merret mendimi për çdo çështje që ka lidhje me termat dhe kushtet e punës të nëpunësve civilë, dhe përbëhet nga palë të interesuara nga sektori privat si dhe nga shërbimi civil.

Në **Republikën Çeke**, Rregullat Legjislative lejojnë të kryhet një formë e konsultimit publik. Megjithatë, autoriteti përgjegjës për përgatitjen e ligjeve mund të vendosë nëse dhe si ai do të konsultohet me organe të tilla si p.sh. OJQ-të. Në rastin e punës, mund të merret mendimi i Këshillit Tripalësh (qeveria, sindikatat dhe punonjësit). Gjithashtu, pas ndryshimit të fundit në Rregullat Legjislative të Qeverisë, Dhoma Ekonomike është bërë një pjesëmarrëse zyrtare në procedurën ndërministrorë të komentimit, dhe mund të dërgojë komentet e saj tek ministria përkatëse. Për më tepër, në vitin 2007 pritet miratimi i Metodologjisë së Konsultimeve Publike nga qeveria.

Në **Hungari** ka disa institucione shtetërore të krijuara për të garantuar përfshirjen e aktorëve të interesuar, p.sh. mekanizmi i punësimit, me përfshirjen e përfaqësuesve të punëdhënësve dhe të punëmarrësve<sup>94</sup>. Një organ tipik konsultimi është Këshilli Kombëtar i Mjedisit, i cili mblidhet një herë në javë dhe ka një sekretariat të drejtuar nga Ministria e Mjedisit.

Në **Lituani**, në vitin 1995 u krijua një Këshill Trepalësh (qeveri, interesat e biznesit, sindikata) për t'u marrë me çështjet sociale, ekonomike dhe të punës.

Në **Poloni**, në varësi të çështjes së normuar, qeveria kërkon mendimin e organeve të krijuara, ku përfshihen:

- Komiteti i Përbashkët i Qeverisë Qendrore dhe Qeverisë Territoriale, në çdo rast kur drafti ndikon në veprimtarinë e qeverisë territoriale.
- Komiteti Trepalësh për Çështjet Sociale dhe Ekonomike i përbërë nga përfaqësues të punonjësve, punëdhënësve dhe qeverisë qendrore.
- Komiteti i të Drejtave të Autorit
- Rregullatorë sektorialë

Në **Republikën Sllovake**, shumë ministri kanë organe këshillimore të cilave iu merret mendimi për propozimet e reja të rëndësishme. Ministri i Ekonomisë ka ngritur një Bord për Mjedisin e Biznesit, të përbërë nga përfaqësues të Dhomës Sllovake të Industrisë dhe shoqata të tjera biznesi. Projektligjet dhe propozimet për politika në lidhje me çështje ekonomike dhe sociale diskutohen në kuadër të Këshillit për Marrëveshjen Sociale dhe Ekonomike. Gjithashtu, në shumë raste, ngrihet dhe një komitet apo grup pune këshillimor *ad hoc* me nëpunës civilë dhe ekspertë. Organizohet edhe konsultim i gjerë me institucione joqeveritare (p.sh. Shoqata e qyteteve dhe bashkive sllovake, Unioni i Kooperativave Bujqësore të Sllovakisë, etj).

#### ***SHRA-të: Mësime mbi marrjen parasysht të rezultateve të konsultimeve***

Cilado qoftë procedura e konsultimit, ajo mbetet formale derisa zbatohet një politikë sistematike për të vlerësuar komentet e bëra nga publiku dhe për të marrë parasysht ato me vlerë. Në **Estoni**, qeveria vlerëson se rreth 5% e amendamenteve që propozohen në kuadër të procesit të bashkëbisedimit në internet pranohen si të vlefshme.

<sup>94</sup> Z. Kovacsy (2005), Rrjedha dhe Cilësia e Informacionit mbi Vlerësimin e Ndikimit në Propozimet e dërguara Qeverisë për projektligje në Hungari.

**Letonia** ka krijuar disa procedura për të garantuar përfshirjen e mendimeve të shoqërisë civile në rregulloret e saj. Faza e parë është publikimi apo njoftimi për draftin. Pas publikimit, mbledhen komentet e bëra dhe, nëse është e nevojshme, organizohen takime për të shqyrtuar komentet, bëhet një përmbledhje e të gjitha propozimeve të ministrive, ku përfshihen diskutimet për të pranuar apo kundërshtuar secilin propozim, i cili shoqëron draftin kur kthehet për miratim në takimin e Sekretarëve të Shtetit.

Po ashtu, një OJQ-ë që ka interes për çështjet që do të diskutohen në mbledhjen e Kabinetit të Ministrave, mund të aplikojë pranë Drejtorit të Kancelarisë së Shtetit për të marrë pjesë në takimin e Kabinetit të Ministrave. Në rrethana të jashtëzakonshme, OJQ-së mund t'i jepet mundësia, me leje të Kryeministrit, që të bëjë dhe një deklaratë gjatë asaj mbledhjeje. Një përfaqësues i OJQ-ve që merr pjesë në një takim të Sekretarëve të Shtetit mund të japë mendimet e tij, dhe, nëse këto nuk merren parasysh, duhet të jepen arsyet pse.

Në **Poloni**, në përputhje me Rregullat e Procedurës së Këshillit të Ministrave dhe Urdhrave të Përhershëm<sup>95</sup>, rezultatet e konsultimeve publike të kryera për një rregullore specifike duhet të përfshihen në VER-in përkatës. Gjithashtu, disa ministri kanë krijuar procedura të brendshme për të trajtuar komentet publike. Për shembull, komentet e bëra nga publiku mbi një rregullore të hartuar nga departamenti juridik i Ministrisë së Drejtësisë i dërgohen Komitetit të Kodifikimit për legjislacionin civil apo Komitetit të Kodifikimit për legjislacionin penal, i cili vendos nëse vërejtjet janë të justifikuar dhe nëse duhet të përfshihen në draft.

Megjithatë, në praktikë, VER-et rrallëherë përmbajnë rezultatet e konsultimeve të kryera; ky informacion zëvendësohet nga një angazhim i shtuar në tekstin e VER-it, sipas të cilit “rezultatet e këtij konsultimi do të përfshihen më vonë”. Kur aktorët e interesuar bëjnë komente mbi një projekt-rregullore, ata nuk marrin vlerësime në mënyrë sistematike nga ministritë.

Në **Republikën Sllovaqe**, në rast se për një propozim bëhen komente nga 500 apo më shumë njerëz, mendimet e tyre duhet të merren në konsideratë. Nëse ai propozim nuk pranohet nga qeveria, ajo duhet t'u japë arsyet për këtë shtetasve të cilët paraqitën propozimet.

Ndonjëherë mund të jetë e vështirë të kombinohen të gjitha komentet e bëra nga publiku dhe aktorë të ndryshëm të interesuar gjatë një procesi konsultimi. Komentet e bëra në këtë proces mund të bien në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Në **Slloveni** u krye një projekt pilot mbi Ligjin për Arkivimin Elektronik, duke përdorur portalin *eSodelovanje*: 86% e pjesëmarrësve deklaruan se do të merrnin pjesë sërish nëpërmjet këtij portali, dhe 75% e të gjitha komenteve të marra u përfshinë në versionin përfundimtar të projekt-ligjit.

Nuk është e lehtë për asnjë vend që të vlerësojë përshtatshmërinë e komenteve dhe të përcaktojë nëse ato përfaqësojnë një gamë të gjerë pikëpamjesh. Gjithashtu, nuk është e lehtë as të shmangët rreziku i teprimit me konsultime.

### **Alternativa ndaj rregulloreve tradicionale — në përgjithësi**

Alternativat ndaj legjislacionit tradicional “komandë e kontroll” shfaqen në disa forma. Disa prej tyre janë:

- Forma e normimit tradicional më elastik, më pak detyrues, i mbështetur në performancë dhe nxitës. Kjo lejon që ato çështje që normohen të zhvillojnë metodën e tyre për të arritur rezultatet e dëshiruara. Kjo rrit elasticitetin dhe inovacionin teksa arrin objektivat e dëshiruara. Shembuj janë respektimi i kërkesave për shëndetin dhe sigurinë në punë, detyrimet për shkarkimet në mjedis dhe rregullimi i çmimeve të firmave me fuqi monopoli.
- Bashkë-normimi dhe vetë-normimi, të tilla si kodet e sjelljes, për zbatimin e të cilave është përgjegjëse vetë industria.

<sup>95</sup> Neni 34.3 i Rregullave të Procedurës.

- Instrumente nxitës dhe të mbështetur në treg: taksat dhe subvencionet (për të mbështetur më mirë objektivat private dhe sociale); reformat në favor të konkurrencës (heqja e normimit dhe kufizimeve që pengojnë veprimtarinë e tregut); krijimi i tregjeve (lejet e transferueshme, tenderimi periodik për ofrimin e shërbimeve).
- Qasja e informimit: përdoren edukimi dhe bindja për të arritur objektivat e komunitetit; informacion i dhënë qeverisë; kërkesat për raportim; fushatat e reklamave.
- Asnjë veprim specifik, d.m.th. alternativa për të mos bërë asgjë.

Përdorimi i alternativave ndaj rregullimeve tradicionale në një vend të caktuar pasqyron shkallën në të cilën një qeveri trajton pyetjen “a është normimi mënyra më e mirë për të arritur rezultatet e politikës?”. Përvoja dhe njohuria e alternativave vazhdon të zhvillohet, por përdorimi i tyre varet shumë nga situata, dhe ndoshta qasja më efektive mund të jetë përdorimi i një sërë instrumentesh për të mbështetur një çështje të politikës, dhe përdorimi i një legjislacioni “komandë e kontroll” në ato raste kur dështojnë alternativat e tjera<sup>96</sup>.

Mundësia për të përdorur këto alternativa të politikave vjen si pasojë e përdorimit të një numri faktorësh, përfshirë respektimin e shtetit ligjor, qëndrueshmërinë politike, mungesën e korrupsionit dhe besimin se mund të arrihen rezultate edhe pa sanksionet përfundimtare si gjobë apo burgim. Shumica e raporteve të OECD-së mbi Reformën Rregullatore rekomandojnë që hartuesit e politikave t’i kushtojnë vëmendjen e duhur, sa herë të jetë e mundur, përdorimit të alternativave të tjera në krahasim me normimin tradicional “komandë e kontroll”.

#### ***Pse të përdoren alternativa përkundrejt rregulloreve?***

Nga qasja “komandë e kontroll” dalin shumë disavantazhe e probleme, si p.sh. dështimi rregullator, mungesa e fleksibilitetit dhe mungesa e burimeve të mjaftueshme për të zbatuar apo siguruar respektim të rregullave. Në praktikë, në shumë situata mund të ketë një numër zgjidhjesh përveç normimit tradicional “komandë e kontroll” në dispozicion të qeverisë për të arritur objektivat e saj.

Megjithëse hartuesit e politikave dhe publiku mund të jenë shumë skeptikë në lidhje me përdorimin e instrumenteve alternative, pranohet gjerësisht se normimi tradicional nuk është gjithmonë instrumenti normues më efikas për të garantuar zbatimin dhe respektimin e një politike, dhe se alternativat ndaj normimit tradicional duhet të merren në konsideratë në mënyrë më sistematike.

#### ***Alternativat ndaj normimit tradicional në BE***

Udhëzimet e rishikuara të Komisionit mbi vlerësimin e efektit kërkojnë që të gjitha alternativat jolegjislative, përfshirë alternativën “mos bëj asgjë” duhet të merren në konsideratë në mënyrë të njëjtë gjatë procesit të vlerësimit të efektit. Komisioni Europian e pranon parimin që qasjeve alternative ndaj normimit klasik duhet t’u kushtohet vëmendje në kohën e duhur dhe në mënyrë efikase, për të përdorur më shumë alternativat sesa legjislacionin tradicional, pa cenuar dispozitat e Traktatit apo të drejtat ekskluzive të ligjvënësit. Ai sugjeron se disa objektiva të politikave mund të arrihen me përdorimin e rregulloreve/normimit alternative, të tilla si Direktivat e Qasjeve të Reja, bashkënormimi, vetënormimi, marrëveshjet e partnerëve socialë, instrumente të mbështetur në treg, rekomandime dhe informacion apo udhëzim.

Kjo qasje u përforcua nga Marrëveshja ndërinstitucionale e vitit 2003 mbi Hartimin e Ligjeve më të Mira<sup>97</sup> e cila nxit përdorimin e alternativave përkundrejt normimit.

<sup>96</sup> Shih *Alternativat ndaj Normimit Tradicional*. Grupi i Punës mbi Menaxhimin dhe Reformën Rregullatore (OECD) GOV/PGC/REG (2006) 9.

<sup>97</sup> COM(2003)770, [http://ec.europa.eu/governance/impact/docs/com2005\\_0098en01.pdf](http://ec.europa.eu/governance/impact/docs/com2005_0098en01.pdf).

## **Alternativat ndaj rregulloreve tradicionale në Shtetet e Reja Anëtare**

Të gjitha SHRA-të kanë përdorur një apo më shumë alternativa në kohë të ndryshme, megjithëse pjesa më e madhe e punonjësve të intervistuar në **Qipro, Republikën Çeke, Hungari, Lituani, Republikën Sllovaqe** e **Slloveni** thanë që nuk ishin të familiarizuar me mundësinë për të përdorur alternativat si një alternativë për politikën, dhe se mbizotëron një mentalitet “komandë e kontroll”.

Alternativat ndaj rregulloreve mund të kenë forma të ndryshme, të tilla si p.sh. fushata ndërgjegjësimi. Në të gjitha Shtetet Anëtare ka pasur fushata ndërgjegjësimi në lidhje me çështje të ndryshme, si p.sh. pirateria e programeve kompjuterike. Në **Qipro** dhe **Lituani** përdoren kodet e etikës në një sërë fushash, sidomos në profesione normuese të tilla si p.sh. juristët.

Gjithashtu nëpunësit në **Estoni** e kishin merak të theksonin se ata nuk reagonin në mënyrë automatike duke normuar, por përpiqeshin të gjenin mënyrat më efikase dhe efektive për të arritur rezultatet e politikave.

Në **Maltë**, megjithëse nuk është e detyrueshme, disa ente kanë miratuar një politikë për vlerësimin e instrumenteve politikë alternativë përpara se të institucionalizojnë veprime të reja normuese. Këtu përfshihen ndërmjet të tjerash Ministria e Financave, Doganat, Ministria për Familjen dhe Solidaritetin Social, si dhe Autoriteti i Transmetimit.

Në **Poloni**, *Themelet Metodologjike të VNR-ve* si dhe *Udhëzimet për VNR-në*, që sapo janë miratuar, nxisin punën për gjetjen e mundësive alternative për të përzgjedhur zgjidhjen më të mirë. Megjithatë, meqë këto udhëzime për VNR-në u paraqitën vetëm në tetor të vitit 2006, është ende tepër herët për të vlerësuar efektivitetin e tyre.

## **Thjeshtimi në përgjithësi**

### *Pse nevojitet thjeshtimi?*

Në çdo program thjeshtimi përparësi i jepet kërkesës për të siguruar se të gjitha komunikimet me shkrim mes shtetit dhe shtetasve, ku përfshihen dhe ligjet, të jenë aq të thjeshta sa e lejon edhe tema. Mungesa e qartësisë në gjuhën e përdorur apo vështirësitë në marrjen e legjislacionit e zvogëlojnë respektin për ligjin, dhe mund të sjellin dështime rregullatore. Aksesit në rregullore është një element thelbësor i një sistemi transparent e të hapur të një qeverisjeje demokratike. Parimi i marrjes së informacionit mund të kërkojë një përpjekje të veçantë gjatë komunikimit nga ana e autoriteteve publike të përfshira. Për shembull, në disa raste informacioni duhet tu shkojë atyre personave të cilët, për shkak të situatës së tyre kanë vështirësi në afirmimin e të drejtave të tyre.

Aspekti i dytë i thjeshtimit është se ai është një mënyrë për të zvogëluar barrën administrative. Shtetet Anëtare të BE-së po bëhen më të ndërgjegjshme mbi kostot e barrave administrative dhe nevojën për t'i bërë detyrimet rregullatore sa më të thjeshta të mundshme. Në një kohë kur investitorët krahasojnë barrat administrative të vendeve të ndryshme kur marrin vendime ku të investojnë, asnjë vend nuk duhet të lërë mënjanë vlerësimin e kostove të barrave administrative, apo të mos hedhë hapat e duhur drejt thjeshtimit të normimit.

Përtej përpjekjeve të përgjithshme të ndërmarra në vendet e OECD-së për t'i mbajtur të përditësuar rregulloret e tyre në mënyrë që të ruajnë tiparet e tyre konkurruese, ka dhe dy arsye të tjera të posaçme për të rishikuar legjislacionin në SHRA-të e studiuara.

Në disa raste mund të ndërmerret një rishikim thelbësor i legjislacionit në periudhën menjëherë pas kalimit nga një regjim në tjetrin. Kështu ndodhi në pjesën më të madhe të vendeve të Europës Qendrore e Lindore gjatë periudhës menjëherë pas rënies së regjimit komunist. Në disa vende nuk ndodh një rishikim i tillë pasi janë marrë masa kushtetuese për t'i mbartur disa ligje të caktuara nga regjimi i mëparshëm.

Kur **Qipro** u bë republikë e pavarur në vitin 1960, Kushtetuta parashikoi vazhdimësinë e të drejtës zakonore angleze. Si rrjedhojë, shumë ligje qëndrojnë në fuqi, edhe megjithëse ato janë në anglisht dhe duhet të përkthehen në greqisht.

Së dyti, është shtuar një vëllim i madh rregulloresh si rrjedhojë e miratimit të *acquis communautaire*. Megjithatë, ritmi shumë i shpejtë i hartimit të ligjeve si dhe amendimet e shpeshta tregojnë se shumë tekste janë të vështira për tu lexuar. Është e nevojshme të shqyrtohet stoku i rregulloreve nga këndvështrimi i koherencës. Në shumicën e vendeve të studiuara u shpreh shqetësim në lidhje me cilësinë e procesit të përafrimit në kuadër të *acquis communautaire*.

### **Thjeshtimi në BE**

Raporti Mandelkern rekomandonte se thjeshtimi duhet të kthehet në një politikë të përgjithshme në sjelljen e Shteteve Anëtare dhe Institucioneve të BE-së. Kjo ka përfshirë krijimin e një programi të vazhdueshëm “SimpReg” (SR). Fusha e veprimit e tij u shtri në rregullimet përtej Tregut të Brendshëm, si dhe në normim që ka ndikim mbi shtetasit dhe mbi entet publike të ngarkuara me detyrën e zbatimit të tij, si dhe mbi bizneset; duke mbuluar kështu të gjithë sferën e normimit evropian.

Kjo punë ngrihet mbi disa nisma të mëparshme, kur Institucionet e Bashkimit Europian miratuan një politikë me udhëzime për hartimin e legjislacionit, e përfshirë në Marrëveshjen Ndërinstitucionale të dhjetorit 2008, në lidhje me cilësinë e hartimit të legjislacionit të Komunitetit. Ato garantuan zbatimin e udhëzimeve duke ristrukturuar organizimin e tyre të brendshëm, aq sa e menduan të nevojshëm.<sup>98</sup>

Këto nisma të mëparshme çuan në një program konsolidimi, i cili përfshiu Zyrën e Publikimeve të BE-së, si një përpjekje për të integruar instrumentet bazë të legjislacionit të Komunitetit, amendamentet dhe korrigjimet e tyre në dokumente unike, jozyrtare. Këto dokumente kanë për qëllim të sigurojnë më shumë transparencë dhe akses më të lehtë në legjislacionin e BE-së. Disa tekste ligjore, të publikuara zyrtarisht dhe fillimisht në numra të ndryshëm të “Fletores Zyrtare të Komuniteteve Europiane” janë kombinuar si një “familje e konsoliduar” në një dokument që është i lehtë për tu lexuar<sup>99</sup>.

Komisioni përdor një qasje të trefishtë për thjeshtimin e formës:

- shfuqizimin e rregulloreve që nuk përdoren më në praktikë.
- kodifikimin, i cili është një rindërtim i rregulloreve që janë amenduar shpesh, në mënyrë që të lexohen më lehtë, por pa e ndryshuar përmbajtjen.
- riorganizimin (procesi i rihartimit, në mënyrë që rregulloret të mund të lexohen më lehtë, nëpërmjet hartimit të rishikuar të masave shumë të ndërlikuara, dhe ndryshimet, aty ku nevojiten, për t’i bërë rregulloret më efikase).

Kjo veprimtari mbështetet mbi një veprimtari më të hershme, gjatë së cilës Komisioni i kërkoi Shteteve Anëtare, bizneseve dhe shtetasve të thonin ku mund të pakësohej burokracia dhe mbinormimi.

### **Shfuqizimi i rregulloreve që nuk kanë më vlerë praktike**

Institucionet e BE-së janë angazhuar të kryejnë një program shfuqizimi, d.m.th. një program për të hequr rregulloret e vjetra apo rregulloret që nuk kanë më vlerë praktike, apo legjislacionin e papërdorur nga *acquis*. Kjo punë është ndërmarrë në të njëjtën kohë me riorganizimin.

### **Kodifikimi**

Në institucionet e BE-së po punohet dhe për kodifikimin. Kodifikimi ndihmon shumë në uljen e vëllimit të legjislacionit komunitar. Të kodifikosh do të thotë të grumbullosh në të njëjtin tekst ligjor një akt ligjor origjinal, plus të gjitha aktet e ndryshuara më vonë.

<sup>98</sup> Deklarata 39, po aty, shënimi 8.

<sup>99</sup> Shih <http://europa.eu.int/eur-lex/en/information/help/help-consleg.html> për një tablo të plotë të procesit si dhe akses tek konsolidimet.

## **Riorganizimi**

Kjo është detyra e vlerësimit të formës dhe strukturës legjislative aty ku ndryshimi i shpeshtë dhe thelbësor e bën përmbajtjen e saj të vështirë për t'u ndjekur dhe ku ndryshimet në politika kërkojnë një rishikim të të gjithë fushës së legjislacionit në fjalë.

### ***Deklarata e vitit 2005 mbi thjeshtimin***

Përpyekjet e Komisionit për Normim më të Mirë përqendrohen në thjeshtimin dhe përditësimin e tërësisë ekzistuese të legjislacionit të BE-së. Komisioni nisi një fazë të re, ku përfshihej edhe programi i punës. Pas deklaratës së tij të quajtur: Një Strategji për Thjeshtimin e Mjedisit Rregullator<sup>100</sup>, rishikimi i *acquis communautaire* është kthyer në një proces të vazhdueshëm dhe sistematik, që i lejon legjislativit të rishikojë legjislacionin, duke marrë parasysh të gjitha interesat e arsyeshme të sektorit privat dhe atij publik. Kjo përfshin:

- një program zhvillimi të mbështetur në përvojën praktike të palëve të interesuara;
- një qasje të mbështetur në vlerësimin e thellë e të vazhdueshëm sektorial.

Pas një konsultimi të gjerë të Shteteve Anëtare dhe të palëve të interesuara, Komisioni propozoi të shfuqizojë, kodifikojë, riorganizojë apo të modifikojë 222 pjesë bazë të legjislacionit (tashmë të rigrupuara në 100) në tre vitet e ardhshme. Programi do të përditësohet rregullisht. Ai ka filluar me sektorët me më shumë rregullore siç janë automjetet, mbetjet dhe ndërtimi. Sektorët e tjerë si sektori i ushqimeve, kozmetikës, ilaçeve apo shërbimeve do të vijojnë më pas.

### ***Rishikimi strategjik i vitit 2006***

Një kapitull mbi thjeshtimin është përfshirë në Rishikimin Strategjik të Normimit më të Mirë në BE. Përveç kësaj, Dokumenti i Punës së Komisionit raporton për herë të parë përparimin e arriturë që nga fillimi i strategjisë më tetor të vitit 2005 dhe paraqet zhvillime të reja drejt reformimit të mëtejshëm të mjedisit rregullator. Në këtë kuadër do të ketë 43 nisma të reja, që do të pasurojnë programin e thjeshtimit të vazhdueshëm për periudhën 2006-2009. Për vitin 2007 janë planifikuar 58 nisma thjeshtimi.

### ***Veprimtaria e analizimit dhe tërheqjes***

Paralel me këtë, Komisioni ka zhvilluar një veprimtari analizuese, që përqendrohet mbi kalimin e propozimeve të cilat janë ende në pritje tek ligjvënësi. Pas analizës së 183 propozimeve për ligjet e BE-së, që presin në Parlamentin Europian dhe në Këshill, Komisioni përzgjedhi 67 propozime në pritje, që ishin tërhequr ligjërisht, kur lista e propozimeve u botua në Fletoren Zyrtare më 17 mars 2006. Këto propozime u tërhoqën pasi disa nuk ishin në përputhje me objektivat e nismës së re të "Partneritetit për Zhvillim dhe Punë" ose nuk arrinin standardet e Normimit më të Mirë. Propozime të tjera nuk po përparonin në procesin legjislativ ose thjesht ishin të vjetra.

Për të mbaruar ushtrimin e vitit 2005, u organizua një ushtrim i ri analizimi: 79 propozimet në pritje, të miratuara nga Komisioni mes 1 janarit 2004 dhe 21 nëntorit 2004 (fundi i mandatit të Komisionit të mëparshëm) u shqyrtuan duke përdorur të njëjtat kritere që u përdorën për analizën e vitit 2005. Rezultatet përfundimtare u botuan në Deklaratën e Vlerësimit Strategjik. Komisioni informoi Parlamentin dhe Këshillin siç kërkohej, duke dhënë një justifikim për tërheqjen e dhjetë propozimeve gjithsej<sup>101</sup>. Meqenëse koha e pranueshme kaloi pa ndonjë reagim nga ana e tyre, lista e tërheqjeve u botua në Fletoren Zyrtare të 22 marsit 2007.

<sup>100</sup> COM (2005) 535 finale, po aty.

<sup>101</sup> Marrëveshja Kuadër e 26 majit të vitit 2005, mbi marrëdhëniet mes Parlamentit Europian dhe Komisionit Europian (paragrafi 32).

## Matja e kostove administrative

Modeli Standard i Kostos (MSK) u krijua Ministria e Financave në Holandë për të matur barrën administrative të shkaktuar nga ndonjë rregullore e veçantë, apo një grup standardesh ligjore, brenda fushës së veprimit të një autoriteti të veçantë, gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe për të bërë të mundur krahasimin mes rregulloreve dhe departamenteve. Për të arritur barrën administrative të shkaktuar nga detyrimi që i ka vënë shteti, përmes rregulloreve, bizneseve për të informuar, bizneset duhet të kryejnë një sërë veprimesh. Një model i ngjashëm u zhvillua në Danimarkë.

**Kostoja e përmbushjes së detyrimit për të informuar = shuma e kostove të të gjitha veprimtarive të nevojshme për të përmbushur detyrimin.**

**Barra e përgjithshme administrative që rrjedh nga normimi = shuma e kostove të dalave gjatë përmbushjes së të gjitha detyrimeve për informim, që rrjedhin nga një normim i tillë.**

**Kosto P e kryerjes së një veprimtarie mund të llogaritet siç vijon:  $P = \text{tarifë} * \text{kohë}$ <sup>102</sup>.**

**Numri Q i veprimtarive të zhvilluara gjatë një periudhe të caktuar llogaritet siç vijon:**

**$Q = \text{numri i bizneseve} * \text{shpeshtësia}$ <sup>103</sup>.**

### *Kostot administrative (BE)*

Më 21 tetor 2005 Komisioni nxori një deklaratë ku paraqitej metodologjia e përbashkët për të llogaritur kostot administrative që krijoheshin nga propozimet e BE-së.

I miratuar pak kohë më parë, në 14 nëntor 2006, Dokumenti i Punës së Komisionit mbi Kostot Administrative, paraqet një strategji të gjerë drejt uljes së barrave administrative, duke përdorur disa rezultate të projektit pilot. Ky projekt pilot identifikon fushat e politikave që janë më përgjegjëse për krijimin e barrave administrative duke bërë krahasime ndërshtetërore të Shteteve Anëtare, që, tashmë e kanë kryer një matje sipas standardeve bazë.

Programi i Veprimit, i paraqitur më 24 janar 2007, tregon qartë në terma konkretë mënyrën me të cilën Komisioni synon të punojë me Shtetet Anëtare për të ulur barrat administrative mbi bizneset me 1/4 deri në vitin 2012. Programi u përqendrohet mbi detyrimet për informim në 13 fusha prioritare të përzgjedhura, ku përfshihen ligji mbi kompanitë, marrëdhëniet e punësimit, tatimet/TVSH-ja, statistikën, bujqësia dhe transporti. Po ashtu, Programi i Veprimit përfshin seritë e para të “veprimeve të korsisë së shpejtë”, ku mund të nxirren përfitimet më të rëndësishme përmes ndryshimeve relativisht të vogla në legjislacionin origjinal. Masat mund të ulin barrat mbi bizneset me 1.3 miliardë euro.

Komisioni synon të sfidojë barrën administrative, veçanërisht për bizneset e vogla, duke thjeshtuar, për shembull, statistikën e ngarkuar. Gjithsesi, rezultatet e duhura mund të arrihen vetëm nëse Parlamenti Europian dhe Këshilli Europian, si bashkë-ligjvënës, e mbështesin atë dhe të nisin punën për ta rritur këtë mbështetje.

Duhet theksuar se pjesa më e madhe e legjislacionit të KE-së mund të gjendet tek Direktivat, që u kërkojnë Vendeve Anëtare të arrijnë një rezultat të veçantë, por pa diktuar mjetet e arritjes së një rezultati të tillë. Rrjedhimisht, nga Vendet Anëtare u vendosën shumë barra administrative. Pra, detyrimi më i madh për të garantuar që procedurat e tyre administrative të jenë sa më efikase dhe me barra sa më të ulëta që të jetë e

<sup>102</sup> Ka dy lloje tarifash – të brendshme dhe të jashtme. Tarifa e brendshme përbëhet nga kostot e njësisë për çdo punëtor që kryen një veprimtari të caktuar brenda biznesit (kostot e listëpagesave për çdo orë + shpenzimet shtesë) dhe kostoja e materialeve. Tarifa e jashtme do të thotë, për shembull, përqindja për orë për punën e një specialisti të jashtëm të organizatës, që plotëson kriterin e informimit në emër të biznesit në fjalë. Koha nënkupton numrin e njësive të kohës (orë) që duhet të harxhohen për të kryer një veprimtari të kërkuar. Koha e kërkuar, e nevojshme mund të përcaktohet përmes intervistave me punëdhënësit dhe punëmarrësit.

<sup>103</sup> Numri i bizneseve lidhet me bizneset e prekura nga normimi, pra që duhet të zhvillojnë veprimtarinë në fjalë sipas normimit dhe detyrimit për të dhënë informacion. Shpeshtësia tregon se sa here në vit kryen një aktivitet një biznes.



mundur, në përputhje me problematikën dhe rreziqet që i përkasin një legjislacioni të veçantë, bie mbi Vendet Anëtare.

## **Thjeshtimi në Shtetet e Reja Anëtare**

### ***Planet e veprimit***

Pjesa më e madhe e SHRA-ve e kanë kuptuar nevojën për thjeshtimin e procedurave për të rritur konkurrueshmërinë e ekonomive të tyre. Ky shqetësim pasqyrohet në deklaratat qeveritare dhe programet e reformave që kanë lidhje me programin e Normimit më të Mirë.

Në **Republikën Çeke**, qeveria miratoi Planin e Veprimit të Uljes së Barrës Administrative për Bizneset në prill të vitit 2005 si dhe Metodologjinë e Matjes së Barrës Administrative, mbështetur në Modelin Standard të Kostos në Holandë. Në dhjetor të vitit 2005 u nis dhe u përfundua një llogaritje bazë e barrës administrative të vënë mbi bizneset. Rezultatet e llogaritjes së kryer nga ministrinë e veçanta dhe autoritetet e administratës qendrore të shtetit, u përmbledhën në raportin e Analizës së Barrës Administrative mbi Bizneset, i cili u botua në vitin 2006. Përfundimet u përdorën për të përgatitur propozimin për fazën tjetër të procesit, që duhej të dorëzohet për të marrë miratimin e qeverisë në vitin 2007. Parashikohet që të fillojë të përdoret një vlerësim i detyrueshëm, *ex ante*, i barrës administrative.

Në vitin 2006, Ministria e Drejtësisë në Estoni botoi një plan veprimi për të thjeshtuar një numër të madh të fushave që ndikonin tek bizneset. Këtu përfshiheshin:

- thjeshtimi i ligjit për kompanitë;
- propozime për të përmirësuar cilësinë e noterëve;
- reforma të kodit të punës;
- një propozim lidhur me tarifatat e mbështetura në kosto;
- përmirësime në ligjet e planifikimit dhe ndërtimit.

Përbërësit më të rëndësishëm të programit të gjerë për të racionalizuar administratën qeveritare deri në vitin 2006 ishin: eliminimi i përgjegjësive të tepërta apo paralele të ministrive dhe autoriteteve shtetërore, racionalizimi i brendshëm i funksionimit të ministrive dhe thjeshtimi i strukturës vertikale të autoriteteve. Për të racionalizuar administratën shtetërore qeveria caktoi një Komisioner.

Programi i Qeverisë (2006) ritheksoi angazhimin e qeverisë për t'i dhënë përparësi thjeshtimit të disa ligjeve si dhe për të ndërmarrë hapa për thjeshtimin e mjedisit rregullator të biznesit. Ai ka vendosur një numër qëllimesh, përfshirë atë të thjeshtimit të sistemit tatimor për bizneset e vogla, duke parë rëndësinë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për ekonominë hungareze.

Në **Letoni**, që në vitin 1999 u miratua nga qeveria një plan veprimi vjetor për të përmirësuar mjedisin e biznesit, i cili rishikohet rregullisht. Agjencia për Zhvillim dhe Investime në Letoni (LIDA) porositi rregullisht sondazhe dhe raportin për gjendjen e mjedisit të biznesit për të matur deri në çfarë mase ishte i suksesshëm plani përkatës i veprimit, si dhe për të identifikuar fushat e reja të prioritetëve dhe reformave.<sup>104</sup> Përveç kësaj, programi operativ *Burimet Njerëzore dhe Punësimi* përmban dispozita të hartuara për të zhvilluar projekte për uljen e barrave administrative për qytetarët dhe sipërmarrësit.

Në **Lituani**, *Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Zhvillimin e Administratës Publike deri në vitin 2010* përfshiu një sërë veprimesh që synonin thjeshtimin e rregulloreve të propozuara dhe atyre ekzistuese siç ishin:

<sup>104</sup> [http://www.liaa.gov.lv/eng/Incentives/Business\\_Environment/?doc=457](http://www.liaa.gov.lv/eng/Incentives/Business_Environment/?doc=457): Raporti i fundit (2005) tregon përmirësime të vazhdueshme në mjedisin letonez të biznesit.

- Përgatitja e një manuali që do të jetë baza për matjen dhe vlerësimin e kostove administrative për bizneset. Objektivi i këtij veprimi është të përcaktojë konceptin e kostove administrative dhe të përcaktojë metodat e vlerësimit të kostove administrative për bizneset.
- Marrja sërish nën shqyrtim e normave ligjore të fushave të ndryshme të biznesit për të ulur barrat administrative dhe për të thjeshtuar normat ligjore për biznesin.

Një nismë tjetër për të ulur barrat administrative ishte krijimi i Grupit të Punës nga Kryeministri<sup>105</sup> për të analizuar funksionet e institucioneve që kontrollojnë bizneset dhe për të paraqitur një propozim për përmirësimin e këtyre funksioneve. Grupi i Punës e paraqiti raportin e tij së bashku me planin e veprimit në vitin 2004 dhe tashmë kanë filluar veprimet pasuese.

Në **Sloveni**, Programi për Uljen e Barrës Administrative për vitin 2006 përbëhej nga 34 masa. Secila ministri dorëzoi tek Ministria e Administrimit Publik një sërë propozimesh për thjeshtim, shoqëruar me një koment shpjegues për secilin si dhe një program me afate kohore për zbatimin e thjeshtimit të propozuar, apo të uljes së barrave administrative të propozuara. Komenti shpjegues tregoi nëse ishte apo jo e nevojshme të ndryshohej legjislacioni që të arrihej rezultati i kërkuar. Mes 34 masave ishin edhe pakësimi i vonesave administrative, zgjatja e projektit “një sportel i vetëm” (one stop shop) për kompani të caktuara<sup>106</sup>, ulja e numrit të licencave për artizanatin<sup>107</sup>, thjeshtimi i procedurave për marrjen e lejes për planifikimin e ndërtimeve të reja, thjeshtimi i së drejtës për kujdestarinë prindërore dhe akses më i lehtë në prokurimin publik nga bizneset e vogla dhe të mesme (SME-të).

#### **Matja e kostove administrative – SHRA-të**

Në pjesën më të madhe të SHRA-ve nuk ka asnjë procedurë për të matur kostot administrative apo për të mbledhur të dhëna sasiore mbi ndikimet e ndryshme që mund të kenë rregulloret mbi bizneset dhe qytetarët. Është vënë re se mungesa e matjes së kostove administrative apo e një modeli nga i cili të bëhen krahasimet dobëson vlerësimet e ndikimit të kryera për legjislacionin e propozuar që do të vendosë një barrë, si dhe cenon mundësinë për të kryer vlerësime *ex post* dhe analiza *ex post* të normimeve.

Nevoja për të matur kostot administrative po merret në konsideratë në shumë vende dhe, për shembull në **Lituani**, është pranuar nga punonjësit se mungesa e treguesve themelorë i pengon hartuesit e politikave që të përcaktojnë nëse janë arritur me efektivitet rezultatet e planifikuara.

**Republika Çeke, Polonia dhe Republika Sllovake** kanë ndërmarrë projekte pilot ose kanë kryer sondazhe për të matur kostot administrative dhe për të vlerësuar se sa miqësor është kuadri rregullator për bizneset. Cilësia e punës ndryshon në përputhje me entuziazmin e punonjësve.

Në **Qipro** janë kryer disa sondazhe për nismën e Administratës Publike apo Departamentit të Personelit në Ministrinë e Financave, apo departamentit apo shërbimit përkatës, për uljen e burokracisë. Qipro njihet si vendi që ka një strukturë administrative që është miqësore ndaj biznesit.

Në **Estoni** u ndërmorën dy projekte pilotë në vitin 2006, me shumë interes, në Ministrinë e Punëve Ekonomike dhe Komunikacionit, për të testuar Modelin standard të kostos në Holandë. Disa ministri dhe zyra (p.sh. Ministria e Financave, Ministria e Punëve Sociale, Ministria e Mjedisit, Zyra e Statistikave dhe Bordi i Tatimeve dhe Doganave) u përfshinë në grupin drejtues për testimin e modelit.

Nga ana tjetër, një zyrtar hungarez komentoi se rezultatet e sondazheve të këtij lloji, ndonjëherë janë të papëlqyeshme pasi detyra e mbledhjes së informacionit për kostot administrative kryhet në mënyrë sporadike dhe se vërehet shpesh një hezitim i fuqishëm nga ana e zyrtarëve për të marrë pjesë në këto lloje projektesh.

<sup>105</sup> Urdhëri i Kryeministrit Nr. 239 “Mbi ngritjen e grupit të punës”, miratuar më 22 tetor, 2003.

<sup>106</sup> Një propozim për të hapur një sportel me një ndalesë për krijimin e kompanive.

<sup>107</sup> Për shembull, nevoja për të pasur një licensë për të menaxhuar një biznes parukerie apo për të punuar në një dyqan.

Gjithsesi, u nis një projekt i përbashkët mes Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë në **Hungari** për të vlerësuar barrat administrative të rregulloreve mbi TVSH-në. Ministri i Drejtësisë nisi një program të gjerë për uljen e barrave administrative, që u mbështet mbi Modelin Standard të Kostos, por plotësohet edhe me sondazhin mbi kostot ekonomike përtej fushës së biznesit (kostot për qytetarët). Faza e parë (hartat e përgjithshme e normimeve të vështira) u planifikua për gjysmën e parë të vitit 2005. Për shkak se buxheti i projektit u pakësua në minimum, ato po kryhen me burime më të pakta për një periudhë më të gjatë kohore. Rezultatet nuk priten të dalin përpara mesit të vitit 2007.

Në **Poloni** janë zbatuar tashmë tre projekte pilot:

- Një studim, i mbështetur nga Zyra e Komitetit për Integrimin Europian, përfundoi në dhjetor të vitit 2005 mbi MSK-në dhe mendimet për kostot administrative në sektorin e transportit rrugor.
- Një tjetër studim, i mbështetur nga Ministria e Financave, u krye për të matur kostot administrative lidhur me përputhshmërinë me detyrimet për informim të kërkuara për pagesit e TVSH-së në Poloni. Ky studim dha një panoramë shumë alarmuese të sektorit të taksave, meqë niveli i barrave administrative u llogarit afërsisht deri më 45.7% të të gjitha të ardhurave nga taksat në vitin 2004.
- Një studim i tretë u krye me nismën e Bankës Kombëtare të Polonisë mbi kostot administrative të lidhura me zbatimin e ligjit mbi bankat.

Një plan për uljen e barrës administrative u dorëzua për miratim tek Këshilli i Ministrave në gusht të vitit 2006, së bashku me Programin e gjerë të Reformës Rregullatore.

Mësimet e nxjerra gjatë matjes së parë të standardeve u përdorën për të përmirësuar metodologjinë. Në vitin 2005, **Polonia** dhe **Holanda** kanë zbatuar një legjislacion mbi standardizimin e transportit. Kjo është bërë sipas metodologjisë së standardizimit të përshkruar në manualin ndërkombëtar. Rezultatet e këtij standardi janë vendosur në Legjislacionin e BE-së mbi Standardizimin e Transportit, Polonia - Holanda<sup>108</sup>. Për **Poloninë**, standardi ishte pjesë e një studimi më të gjerë në legjislacionin e transportit<sup>109</sup>.

Në **Republikën Sllovake**, një dokument<sup>110</sup> i përgatitur me nismën e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NADSME), vlerësoi gjendjen dhe identifikoi faktorët më të rëndësishëm që kanë ndikim mbi klimën e biznesit në Sllovaki, në vitin 2004. Gjithsesi, dokumenti pranon faktin që nuk ka të dhëna të mjaftueshme në dispozicion për të matur kostot administrative që rëndojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

### **Thjeshtimi i formës**

Nuk mund të ketë modele koherente tek SHRA-të lidhur me thjeshtimin e formës (stilit, gjuhës, strukturës, koherencës, si dhe disponueshmërisë) së legjislacionit. Disa vende kanë ndërmarrë reforma të gjera, ndërsa vende të tjera i kryejnë ato kur është e nevojshme.

Në vitin 2005 u ndërmor një vlerësim sintetik i rregulloreve të Qeverisë, i bashkërenduar nga Kancelaria e Shtetit. Si rezultat i këtij vlerësimi, rregulloret që nuk kishin më vlerë praktike apo ishin *ultra vires*, u shfuqizuan<sup>111</sup>.

Çdo vit, Kancelari Ligjor në **Estoni** paraqet në Parlament një pamje të përgjithshme mbi përputhshmërinë e legjislacionit, në përgjithësi me Kushtetutën dhe parimet e përgjithshme të ligjit<sup>112</sup>. Kjo, zakonisht, çon

<sup>108</sup> Shiko: [www.administrative-burdens.com](http://www.administrative-burdens.com).

<sup>109</sup> Shiko: M. Gancarz., M. Kaluzynska (2005), *Modeli Standard i Kostos dhe perceptimet e barrave administrative në sektorin e transportit rrugor*, Zyra e Komitetit për Integrimin Europian, Poloni.

<sup>110</sup> 2004.

<sup>111</sup> Shikoni Ligjin e Procedurave Administrative, pjesa 93 (1): "Një rregullore është e vlefshme deri sa të shfuqizohet nga një autoritet administrativ i Gjykatës së Lartë ose deri sa t'i mbarojë afati kohor apo të shfuqizohet dispozita që delegon autoritetin.

<sup>112</sup> Shikoni versionin e vitit 2004 në gjuhën angleze të vëzhgimit në : <http://www.oiguskantsler.ee/files/36.pdf>.

në ndryshime që kryhen për të ndrequr gabimet e zbuluara në ligje. Një vlerësim sistematik i rregulloreve të qeverisë dhe ministrave, i bashkërenduar nga Kancelaria e Shtetit, u ndërmor në vitin 2005.

Është ndërmarrë një vlerësim<sup>113</sup> për të shfuqizuar legjislacionin e vjetër ose të papërdorur dhe është bërë përparim duke u kërkuar organeve publike që më shumë të kërkojnë informacion nga të dhënat e tyre sesa të vendosin detyrimin mbi qytetarët që të japin në mënyrë të përsëritur të njëjtin informacion.

Nuk ka politika për të thjeshtuar gjuhën e përdorur në legjislacion edhe pse Gjykata Kushtetuese vendosi që Neni 2 i Kushtetutës, që lidhet me parimin e sigurisë ligjore, përfshin gjithashtu dhe normat e qartësisë. Mbështetur në këtë, Gjykata e deklaroi të pavlefshme një rregullore pasi ishte shumë e ndërlikuar.

Në **Hungari**, pas rënies së komunizmit, u krye një veprimtari thjeshtimi, që u përqendrua tek forma dhe përmbajtja e legjislacionit të krijuar. Besohej se ishte shumë e rëndësishme të ulej numri i rregullave që nuk kishin më vlerë praktike dhe u zbatuan disa programe sistematike të përmirësimit të rregulloreve.

U ndërmorën nisma të mëtejshme për përmirësimin e normimeve, në vijim të parimeve dhe politikave të njëjta. Programi i vitit 2004 mbi Thjeshtimin e Legjislacionit kishte për detyrë hartimin e ndryshimeve në kostot administrative të shkaktuara nga legjislacioni i ri gjatë një periudhe katër mujore. Pasi mori përgjigjet nga ministrinë, njësia e koordinimit në Ministrinë e Drejtësisë ndërpreu këtë projekt dhe, në vend të tij, iu kërkoi ministrive ide nga përvoja e tyre për thjeshtimin. Propozimi i vitit 2005 u formulua duke marrë parasysh këto përvoja<sup>114</sup>.

Përveç kësaj, brenda kornizës së punës së një programi të gjerë kundër burokracisë, Ministria e Financave ka filluar të analizojë legjislacionin financiar për të identifikuar fushat e mundshme të thjeshtimit. Kodet ekzistojnë në disa fusha, siç janë e drejta penale dhe e drejta civile. Gjithsesi, mendohet që ka një tendencë për të pasur sa më shumë kode të veçanta.

Në **Letoni**, ku 50% apo më shumë e neneve të një projekt-rregulloreje duhet të ndryshohen, duhet të nxirret një variant i ri i rregullores.

### ***Thjeshtimi i procedurave***

SHRA-të kanë një larmi qasjesh ndaj thjeshtimit. Në disa SHRA, shqetësimi për thjeshtimin nxitet nga sektori i biznesit. Në **Republikën e Sllovakisë**, për shembull, kostot administrative u morën në shqyrtim në një dokument të vitit 2004, përgatitur me nismën e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme<sup>115</sup>, që vlerësoi gjendjen dhe zhvillimin e këtyre bizneseve në Republikën e Sllovakisë.

---

<sup>113</sup> Ka pasur projekte specifike të ndryshme për të vlerësuar mundësinë për të ulur detyrimet administrative të legjislacionit. Për shembull, në vitin 2001, u ndërmor një studim nga PRAXIS. Ai përfshiu tre fusha:

- Hartimi dhe analizimi i çështjeve të veçanta dhe procedurale që kanë lidhje me liçensimin e aktivitetit të biznesit si nga këndvështrimi qeveritar ashtu dhe këndvështrimi i korporatave. Qëllimi ishte të jepeshin udhëzime të veçanta për të bërë të mundur riorganizimin e procedurës aktuale të liçensimit dhe për të bërë klimën e biznesit në Estoni më miqësore për sipërmarrësit.
- Rishikimi i rregulloreve mbi Ligjin e Procedurës Administrative.
- Një studim i listave të kontrollit dhe përdorimin e tyre për të siguruar bashkëpunimin e duhur mes degëve legjislative dhe ekzekutive të qeverisë në përditësimin e procedurës administrative. Në këtë projekt, partnerët e PRAXIS ishin agjensitë qeveritare dhe *Riigikogu*. Grupi i projektit hartoi listat e kontrollit, që do të mundësonin analizim të shpejtë të projektligjit që përmbante procedurat administrative (veçanërisht liçensimin). Listat e kontrollit mund të përdroreshin si përfundim nga ligjvënësit dhe komisionet e *Riigikogu*. Qëllimi është të sigurojë normim standard qeveritar, të ulë kompleksitetin e procedurave administrative dhe të krijojë në mjet për bashkërendimin e hartimit të politikave.

<sup>114</sup> Veprimtaritë e kohëve të fundit të Reformës Rregullatore, po aty.

<sup>115</sup> Dokumenti nxori në dritë se faktorët më kyç në ndikimin e klimës së biznesit në Sllovakia në vitin 2004 ishin zbatimi i sistemit të ri tatimor, duke i bërë procedurat administrative të kërkuara për fillimin e biznesit më efëcente, ndryshimet në sistemin e mbrojtjes sociale në një sistema të sigurimeve shoqërore, përmirësimi i komunikimit me zyrat e tatimeve dhe adoptimi i legjislacionit më elastik mbi falimentimin.

Në pjesën më të madhe të SHRA-ve, ekzistojnë një sërë nismash dhe propozimesh thjeshtimi për uljen e detyrimeve administrative, por numri dhe shumëllojshmëria e tyre tregojnë nevojën për t'i konsoliduar ato, për të garantuar që ato të jenë të përqendruara dhe që të arrihen përfitimet e plota të këtyre politikave.

Një mënyrë për të ulur barrën administrative është të ulët sasia e rrethanave, ku i njëjti informacion kërkohet nga disa autoritete. Për shembull, në **Estoni** dhe **Letoni**, ligjet e reja analizohen për të garantuar që të mos kërkohet nga qytetarët dhënia e një informacioni, nëse ky informacion është tashmë në dispozicion të autoritetit.

Në **Estoni**, institucionet kanë të drejtë të vërtetojnë kopjet e dokumenteve origjinale të paraqitura tek to dhe të lëshuara nga to, në mënyrë që qytetarët të mos kenë nevojë të shkojnë tek noterët për t'i noterizuar.

Në **Letoni**, një organ shtetëror ka detyrimin për të parë nëse ajo e ka informacionin përpara se ta kërkojë nga personi apo biznesi i vogël. Është parashikuar dhe një auditim i procedurave burokratike për të garantuar thjeshtim të konsiderueshëm dhe vendimmarrje transparente. Është planifikuar të vlerësohet korpusi i legjislacionit për të garantuar zbatimin e parimit “kërkoje një herë, përdore shumë herë”.

#### *Qendrat me një ndalesë, sportelet (One stop shops)*

Një mënyrë tjetër është krijimi i një pike kontakti me qytetarët siç janë “sportelet me një ndalesë” ku qytetarët dhe bizneset mund të kryejnë shumë lloje të procedurave administrative.

Në **Qipro**, qendra e parë e “shërbimit në një sportel” për qytetarët u ofrua në dhjetor të vitit 2005 për të mundësuar akses më të mirë të qytetarëve në disa kategori të informacionit qeveritar dhe një larmi shërbimesh. Ky sportel bashkoi shërbimet e mëposhtme: dokumentet e identitetit, regjistrimin e makinave, përfitimet shëndetësore dhe shoqërore.

Në **Maltë**, Autoriteti Maltez i Turizmit vepron si një “qendër me një sportel” për bizneset që kanë lidhje me turizmin. Drejtoria e Biznesit të Vogël, brenda Divizionit të Tregtisë në Ministrinë e Konkurrencës dhe Komunikacionit, ka një linjë telefoni falas për bizneset e vogla që kanë probleme me burokracinë. Ajo i dërgon ankesat mbi burokracinë e tepërt të raportuara nga bizneset tek autoritetet përgjegjëse.

#### *Teknologjia e informacionit (IT).*

Në përgjithësi, pjesa më e madhe e nismave të marra varen nga përdorimi i mjeteve të teknologjisë së informacionit për të thjeshtuar procedurat dhe për të përmirësuar bashkërendimin mes autoriteteve dhe të gjithë aktorëve të përfshirë dhe, në përgjithësi, për të krijuar një administratë më miqësore ndaj qytetarëve.

Lidhur me përdorimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe qeverisjes elektronike në përgjithësi, disa SHRA janë shumë më të përparuara se sa të tjerat. Gjithsesi, zhvillimi i mjeteve të teknologjisë së informacionit mund të çojë në uljen e detyrimeve administrative, me kusht që aksesit në internet të jetë i zhvilluar mirë, gjë që nuk ndodh kështu në disa SHRA, p.sh. në Letoni.

Në vitin 1998, në **Qipro**, qeveria hartoi një “Strategji për Sistemet e Informacionit”. Në pesë vitet e fundit janë bërë përmirësime jo vetëm në numrin por dhe në nivelin e shërbimeve publike të ofruara përmes internetit. Pjesa më e madhe e ministrive, departamenteve apo shërbimeve qeveritare kanë faqet e tyre të internetit. Pjesa më e madhe e faqeve të internetit janë informative dhe mundësojnë shkarkimin e formularëve dhe dokumenteve të tjerë. Disa mbështesin edhe ndërveprimin e përdoruesve.

Në këto vitet e fundit janë bërë përmirësime, jo vetëm në numrin, por dhe në nivelin e shërbimeve elektronike të ofruara për publikun. Të gjitha ministrinë/departamentet/shërbimet qeveritare mirëmbajnë faqet e tyre të internetit<sup>116</sup>, që janë ose informative dhe mundësojnë shkarkimin e formularëve dhe dokumenteve të tjerë ose përballojnë dhe ndërveprimin e përdoruesve.

Zhvillimi në internet i sistemit të “përqendruar tek qytetari”, i kryer si pjesë e Strategjisë së Sistemeve të Informacionit, është një proces në vazhdim. Aktualisht, janë mundësuar nga qeveria një sërë shërbimesh

---

<sup>116</sup> Për të nxitur përfshirjen elektronike, faqet publike të internetit zhvillohen në bazë të Udhëzimeve për Aksesin Online.

elektronike për publikun, siç janë dërgimi në mënyrë elektronike i deklaratës mbi tatimin mbi fitimin, rinovimi i licencës dhe taksës së rrugës duke përdorur kartat e kreditit, pagesa e kontributeve shoqërore për punëmarrësit dhe për të vetë-punësuarit, duke përdorur metodën e “debitimit të drejtpërdrejtë”, etj.

Në **Republikën Çeke**, Portali<sup>117</sup> i Administratës Publike është në veprim që nga viti 2004. Ai shërben si një urë lidhëse mes administratës publike dhe qytetarëve, bizneseve dhe institucioneve. Portali përfshin listën e plotë të administratës publike, legjislacionin çek dhe atë europian, një bazë të dhënash të hollësishme, zgjidhjet e ofruara për mbi 300 transaksione të veçanta me autoritetet, regjistrin tregtar elektronik, një mjedis për të parë pjesë të Regjistrit të Tokës, një vështrim të përgjithshëm mbi prokurimet publike dhe lajme nga departamente të caktuara, etj.

Përmes Portalit të Administratës Publike ofrohen, në internet, për qytetarët disa shërbime, ku përfshihen: futjen në dosje të deklaratës për tatimin mbi fitimin, përdorimet për përfitime shoqërore dhe shërbimet e lidhura me kujdesin shëndetësor. Për kompanitë, shërbimet përfshijnë: futjen në dosje të deklaratave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punëmarrësve, të deklaratës për tatimin mbi fitimin, të deklaratave për detyrimin e akcizës, thjeshtimin e plotësimit në internet të raporteve statistikore apo të deklaratave doganore elektronike.

Administrata qendrore publike në **Hungari** është plotësisht e mbuluar nga sistemi kompjuterik, me një akses në rrjet gati 70% dhe pjesa më e madhe e ministrive kanë faqet e tyre të internetit. Në vitin 1998 u krijuan sistemet e teknologjisë së informacionit të ashtuquajtura “me-një-ndalesë”, për regjistrimin e pronarëve të vetëm dhe shoqatave ekonomike<sup>118</sup>. Modernizimi i portalit të internetit të Ministrisë së Drejtësisë përfshiu krijimin e një forumi për rekomandime dhe mendime në lidhje me problemet e hartimit të ligjeve.

Në **Maltë**, mjetet e teknologjisë së informacionit u krijuan me synimin e rritjes së efikasitetit administrative dhe thjeshtimin e procedurave. Për shembull, u krijuan një bazë të dhënash e përbashkët për të garantuar se kurdoherë që përditësohet informacioni në një bazë publike të të dhënave, ky ndryshim do të kryhet dhe në të gjitha bazat publike të të dhënave.

Në **Republikën Sllovaqe**, qeverisja elektronike po zhvillohet, por është në një fazë fillestare. Janë ndërmarrë kohët e fundit disa nisma, përfshi ato për të thjeshtuar regjistrimin e biznesit. Formularët standardë mund të shkarkohen nga faqja e internetit e Ministrisë së Drejtësisë. Regjistrimi përfundon brenda pesë ditësh, nga momenti që janë dorëzuar nga kompania dokumentet e kërkuara dhe të plotësuara.

Në **Slloveni**, portali, qeveria elektronike<sup>119</sup>, u hap më 22 maj 2006. Ai është një pikë kontakti për informacionet dhe shërbimet e administratës publike, e cila rendit informacionin në grupe fushash të ndryshme të jetës. Portali mundëson marrjen me lehtësi të informacionit si dhe një përdorim miqësor të shërbimeve të ofruara nga shteti në dobi të përdoruesit. Portali i modernizuar përfshin një listë më të gjerë të nëpunësve civilë të cilëve qytetarët mund t’u dërgojnë një aplikim dhe krijon mundësinë që qytetarët të komunikojnë me njësitë e administratës publike, gjë që garanton një përgjigje të shpejtë dhe informacion në dobi të përdoruesit. Për shembull, është e mundur të rinovohet patentat e makinës në internet, falë portalit shtetëror të qeverisjes elektronike.

Ministria e Administratës Publike ka një portal shtetëror për bizneset i quajtur e-VEM<sup>120</sup>, i cili u hap më 1 korrik të vitit 2006. Ai i krijon mundësinë një tregtari të mundshëm të regjistrohet në Regjistrin e Biznesit Slloven dhe e dërgon informacionin tek Administrata e Tatimeve. Është planifikuar të përhapet më shumë sistemi e-VEM për të lehtësuar regjistrimin edhe të tipeve të tjera të kompanive.

---

<sup>117</sup> [www.portal.gov.cz](http://www.portal.gov.cz).

<sup>118</sup> Thjeshtimi Administrativ – Praktikant më të Mira në Hungari, Dorëzimi nga qeveria Hungareze, Komiteti i Menaxhimit Publik, 18-19 tetor 2001, Thjeshtimi Administrativ – praktikant më të mira në vendet e OECD-së, seminari i specialistëve.

<sup>119</sup> <http://uprava.gov.si/e-uprava/>.

<sup>120</sup> <http://evem.gov.si>.

### *Zhvillimi i një administrate më miqësore ndaj qytetarëve*

Në shumë SHRA janë zbatuar nismat për të krijuar një administratë sa më shumë miqësore për qytetarët, përfshirë krijimin e kartës së shërbimeve cilësore apo përqendrimin në disa parime administrative të ligjit.

Në **Maltë**, Zyra e Kryeministrit krijoi një model të Kartës së Shërbimit Cilësor që ministrinë mund të përdorin vullnetarisht dhe të miratojnë fushat e tyre të veçanta të veprimtarisë për të garantuar që qytetarëve t'u shërbehet sa më shpejt të jetë e mundur.

Disa parime të së drejtës administrative mund të ndihmojnë në uljen e barrës administrative. Ligji letonez për Procedurat Administrative kërkon që shërbimi publik estonez të mundësojë procedura administrative që janë efikase dhe që kryhen me koston dhe vonesën më të ulët për përdoruesit<sup>121</sup>.

### *Dialogu me aktorët e angazhuar për uljen e barrës administrative*

Në disa vende, bashkërendimi mes autoriteteve dhe të gjithë të interesuarve të përfshirë në lidhje me uljen e barrës administrative u forcua përmes ngritjes së një grupi pune të veçantë përgjegjës për këto çështje.

Në **Lituani**, u krijua nga Kryeministri një Komitet i Përhershëm për Përmirësimin e Klimës së Biznesit<sup>122</sup>, ku përfshihen përfaqësuesit e institucioneve të biznesit, specialistë të pavarur, specialistë të institucioneve shtetërore, shkencore dhe arsimore. Komiteti synon thjeshtimin e klimës së biznesit dhe metoda e tij e punës është mbështetur në bashkëpunimin e ngushtë mes autoriteteve dhe organizatave të biznesit.

Megjithatë, në vende të tjera, siç është **Republika Sllovaqe**, nuk ka shkëmbim të bashkërenduar të informacionit mes organeve të shërbimit publik. Nuk ka një pikë qendrore, siç mund të jenë “qendrat me një ndalesë” (zyrë ku kryhen të gjitha veprimet), për të ndihmuar bizneset dhe, në veçanti, bizneset e vogla e të mesme dhe qytetarët, që kanë të bëjnë me procedurat administrative dhe proceset e regjistrimit të kërkuara nga organet e shërbimit publik.

### **Mundësia për informacion**

Është themelore për qeverisjen e mirë të një vendi që ligjet e miratuara për të udhëhequr individët dhe personelin e korporatave të jenë të disponueshëm për ata dhe këshilltarët e tyre. Kjo do të thotë se ata jo vetëm duhet të jenë të aftë të gjejnë ligjet por, kur i gjejnë ato, duhet të jenë në gjendje t'i ndjekin ato me lehtësi pa u dashur që të kalojnë nga një tekst tek tjetri, një lumë letrash me ndryshime të ndërthurura dhe kërkesash të mbivendosura. Zhvillimet në teknologjinë e informacionit kanë ndihmuar shumë procesin e hartimit të legjislacionit dhe informacionit tjetër zyrtar në mënyrë elektronike dhe shumë vende tashmë kanë një formë aksesit në legjislacion me ndihmën e internetit.

### *Botimi në Fletoren Zyrtare dhe në internet*

Në të gjitha vendet, legjislacioni parësor dhe dytësor duhet të publikohet në Fletoren Zyrtare në letër dhe në pjesën më të madhe të vendeve mund të gjendet edhe në internet. I njëjti interes të veçantë është fakti se në Estoni dhe Maltë, të dyja variantet (në letër dhe elektronikisht) kanë të njëjtën forcë ligjore. Në **Estoni**, nëse versioni elektronik dhe versioni në letër i të njëjtit legjislacion të botuar bien ndesh me njëri tjetrin, versioni në letër ka fuqi më të madhe dhe Kancelaria e Shtetit duhet të njoftohet për këtë mospërputhje.

Në SHRA-të e tjera, përveç **Qipros**, varianti i legjislacionit në internet është pa pagesë. Në pjesën më të madhe të SHRA-ve, ka një vonesë të vogël mes publikimit të legjislacionit në internet dhe botimit në letër. Gjithsesi, në **Estoni**, legjislacioni dhe dokumentet e tjerë publikohen në Fletoren Zyrtare (Riigi Taetaja-n) elektronike në të njëjtën kohë kur ajo (Riigi Teataja) botohet në letër.

<sup>121</sup> Ligji mbi Procedurat Administrative, Neni 5 II.

<sup>122</sup> Rezoluta Nr. 1265 “Mbi ngritjen e komitetit të përhershëm për Përmirësimin e Klimës së Biznesit”, *Fletorja Zyrtare Nr. 93-3271*, 2001, *Nr 127-4556*, 2005.

Në **Lituani**, i gjithë legjislacioni duhet të publikohet në faqen e internetit të parlamentit ose në faqen e internetit të institucionit që e ka miratuar, brenda tre ditëve nga publikimi i tij zyrtar në Fletoren Zyrtare.

Faqet zyrtare të Fletores Zyrtare mirëmbahen nga Ministri të ndryshme në SHRA. Ministria e Drejtësisë (**Hungaria, Malta dhe Republika Sllovaqe**) ose Kancelaria e Shtetit (**Estonia, Letonia**) është përgjegjëse për botimin e Fletores Zyrtare, përfshirë publikimin e saj në internet.

Në **Republikën Çeke**, ka një bazë të dhënash ku mund të kërkohet legjislacioni që ofrohet falas në Portalin e Administratës Publike<sup>123</sup>. Botimet e skanuara të Fletores Zyrtare gjithashtu mund të shkarkohen falas nga faja e internetit e Ministrisë së Brendshme<sup>124</sup>. E njëjta faqe interneti mundëson kërkim të ngjashëm në bazën e të dhënave për traktatet ndërkombëtare.

Në **Qipro**, hyrja në internet është e mundshme përmes faqeve të tjera të internetit siç është Leginet<sup>125</sup>, që është një bazë e gjerë të dhënash për materiale ligjore, siç janë titujt e ligjeve dhe rregulloreve, si dhe teksti i plotë i ligjeve. Në Qipro, gjithashtu, botohet në Fletoren Zyrtare një indeks i legjislacionit parësor (Titujt e Ligjeve dhe Rregulloreve). Faqja e internetit e Dhomës së Përfaqësuesve përfshin indekset e të gjithë legjislacionit, në formën e vëllimeve vjetore. Përveç kësaj, Zyra e Komisionerit Ligjor hartoi një indeks për traktatet ndërkombëtare, i quajtur “Indeksi i Traktateve Ndërkombëtare 1960-2004”.

Në **Letoni**, të gjitha Direktivat dhe Rregulloret e Komisionit Europian mund të gjenden dhe në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe në Qendrën e Terminologjisë.

Në **Lituani**, kur ndryshohet legjislacioni, botohet një tekst jo zyrtar i legjislacionit, i cili jep tekstin origjinal me ndryshimet.

Në **Maltë**, Departamenti i Informacionit, brenda Zyrës së Kryeministrit, është përgjegjës për botimin e Fletores Zyrtare, përfshirë publikimin e saj në internet. I gjithë legjislacioni dytësor, përfshirë dhe aktet nënligjore, mund të gjendet në faqen e internetit të Departamentit të Informacionit.<sup>126</sup> Në **Qipro** dhe **Lituani** një bazë të dhënash të normimeve është në dispozicion në faqen e internetit të parlamentit.

Në **Poloni**, çdo vit, duke filluar nga 31 marsi, do të publikohet një indeks i të gjitha rregulloreve të botuara në Fletoren Zyrtare për një vit të caktuar.

Në disa vende, përveç teksteve të ligjeve, botohen dhe indekset e titujve të ligjeve dhe rregulloreve. Në **Lituani**, institucionet publike botojnë titujt e rregulloreve në fuqi, brenda sferës së kompetencës së tyre, me referencat respektive të versioneve përkatëse të rregulloreve, që mund të gjenden në bazën e të dhënave të rregulloreve të parlamentit.

### ***Akresi tek versionet e konsoliduara***

Në **Estoni**, që nga viti 2006, versionet e konsoliduara të legjislacionit botohen në të njëjtën kohë me botimin e një ligji të ndryshuar.

Pas ndryshimit apo shfuqizimit të një pjese legjislative përgatitet dhe publikohet elektronikisht në Riigi Teataja (fletore zyrtare) një tekst i konsoliduar i këtij legjislacioni, që vendos të gjitha ndryshimet e bëra ndaj tekstit origjinal. I gjithë legjislacioni konsolidohet në këtë mënyrë<sup>127</sup>.

Në **Letoni**, normimet, pasi ndryshohen, botohen nga Ministria e Drejtësisë në një formë me shpjegime<sup>128</sup>. Të gjitha normimet mblidhen në një bazë të dhënash (NAIS) e financiar pjesërisht nga buxheti i shtetit dhe

<sup>123</sup> [http://portal.gov.cz/wps/portal/\\_s.155/699](http://portal.gov.cz/wps/portal/_s.155/699).

<sup>124</sup> <http://www.mvcr.cz/sbirka/index.html>.

<sup>125</sup> [www.leginetcy.com](http://www.leginetcy.com).

<sup>126</sup> [www.doi.gov.mt](http://www.doi.gov.mt).

<sup>127</sup> 1) Aktet e ligjeve; 2) Dekretet e Presidentit të Republikës; 3) rregulloret dhe urdhërat e qeverisë së Republikës; 4) rregulloret e ministrave; 5) rregulloret e Presidentit të Bankës së Estonisë; 6) rregulloret e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



pjesërisht nga pagesat nga shitja e shërbimit shpjegues. Është planifikuar që kjo bazë të dhënash të vihet në dispozicion të publikut falas dhe të bashkojë rregulloret me shpjegimet dhe materialet e lidhura me to.

Në **Maltë**, kur ndryshohet, legjislacioni ribotohet me ndryshimet e kryera. Faqja e internetit e Ministrisë së Drejtësisë përditësohet rregullisht për të përfshirë çdo ndryshim të fundit.

Ne **Republikën Sllovake** ekziston një faqe interneti për Regjistrin Qendror të Ligjeve<sup>129</sup> ku mund të lexohen ligjet që janë ndryshuar si një tekst i vetëm, në formë të konsoliduar.

Në **Slloveni**, parlamenti boton një tekst të konsoliduar të legjislacionit, kur ndryshohet një Ligj parësor nga një numër ligjesh. Teksti i ndryshuar nuk miratohet përsëri, por pranohet si një version zyrtar i legjislacionit dhe si provë e përmbajtjes së tij.

### ***Botimi i vendimeve gjyqësore***

Në **Qipro** dhe **Estoni**, baza e të dhënave me statistika të gjyqësorit dhe vendime gjyqësore do të jetë shumë shpejt në dispozicion të publikut.

Në **Qipro** është programuar një sistem i mbështetur në internet që do të mirëmbahet nga Ministria e Drejtësisë dhe e Rendit Publik. Pasi të përfundojë, sistemi do të vërë në dispozicion të gjyqtarëve, avokatëve, nëpunësve shtetërorë, organeve të tjera të jashtme si dhe publikut të gjitha vendimet, ligjet, rregulloret dhe materialet e tjera ligjore.

Në **Estoni**, të gjitha vendimet e Gjykatës së Lartë mund të gjenden në Fletoren Zyrtare, të printuara, dhe në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë. Përveç kësaj, një bazë të dhënash “KOLA”, në përdorim që nga viti 2001, është e ndarë në pjesë që vihen në dispozicion të publikut. Statistikat që kanë lidhje me proceset gjyqësore mund të merren dhe nga publiku. Përdoruesit e autorizuar të “KOLA”-s kanë akses tek të gjitha gjykatat e Estonisë. Gjykatat hedhin në “KOLA” njoftimet për të gjitha seancat gjyqësore që kryejnë.

---

<sup>128</sup> Hartimi i materialeve të ndërmarra nga një zyrtar i Ministrisë së Drejtësisë por shpjegimi bëhet nga një kompani e sektorit privat. Tekstet nuk konsolidohen plotësisht në kuptimin formal të fjalës, por shoqërohen me adresa për t'i bërë të mundur lexuesit të ndjekë me lehtësi një tekst që është ndryshuar në një numër rastesh.

<sup>129</sup> [www.zbierka.sk](http://www.zbierka.sk).

## 5. MIRATIMI NGA PARLAMENTI

*Kapaciteti i procesit të miratimit në parlament mund të vlerësohet duke marrë nën shqyrtim:*

- strukturën për miratimin e legjislacionit parësor;
- procedurën për miratimin e legjislacionit parësor;
- çështjen nëse kur parlamenti merr nismën për legjislacionin – a ndjek ai të njëjtin proces të diskutimit të politikave dhe të hartimit të ligjit, siç ndiqet nga strukturat e qeverisë.
- burimet në dispozicion të parlamentit për t'i dhënë anëtarëve të parlamentit mundësinë që të kryejnë kërkime në lidhje me probleme që dalin në legjislacion.
- rezultatet e parlamentit dhe në çfarë mase ligjvënësit tregojnë pavarësi në nisjen e legjislacionit nga ekzekutivi.

### **Strukturat për miratimin e legjislacionit parësor**

Përgjithësisht, parlamentet merren vetëm me legjislacionin parësor; gjithsesi, Dhoma e Përfaqësuesve në **Qipro** diskuton në hollësi dhe legjislacionin dytësor.

Pjesa më e madhe e parlamenteve në SHRA-të janë me një dhomë, siç mund të shihet nga tabela e mëposhtme. Pyetja nëse duhet të jenë një apo dy dhoma legjislative është një nga pyetjet më të shpeshta në lidhje me strukturën e parlamentit<sup>130</sup>. Procedurat për debat ndryshojnë nga SHRA-i në SHRA edhe pse ato të gjitha mbështeten në një format shumë të ngjashëm me tre lexime.

Parlamentet me dy dhoma gjenden në **Poloni** dhe në **Republikën Sllovake**. Një ndryshim i mëtejshëm i kësaj teme është **Sllovenia** dhe në një farë mase edhe **Republika Çeke**, që kanë një strukturë jo të plotë dy dhomëshe. Kjo do të thotë se Dhoma e Lartë nuk ka kompetenca të njëjta me Dhomën e Ulët dhe ka më pak autoritet. Qëllimi i Dhomave të Larta në sistemet jo të plota dy dhomëshe, që në shkallë botërore janë më të zakonshme se sa sistemet e plota me dy dhoma, është që të mbikëqyrin punën e Dhomës së Ulët.

Siç mund të shihet nga tabela e mëposhtme, afatet kohore ndryshojnë. Përfaqësuesit kanë mandate katër-vjeçare (Vendet Baltike, Asambleja Kombëtare e Republikës së Sllovenisë) ose pesë-vjeçare (**Malta**, **Qipro**, **Këshilli Kombëtar i Republikës së Sllovenisë**). Numri i përfaqësuesve ndryshon shumë nga vendi në vend.

---

<sup>130</sup> Gallagher, Laver dhe Mair, McGraw Hill (2006), *Qeveria Përfaqësuese në Europën Moderne*.

**Pamje e përgjithshme e Parlamenteve në SHRA-të**

	<b>Emri i Parlamentit</b>	<b>Numri i deputetëve</b>	<b>Mënyra e zgjedhjes</b>	<b>Mandati</b>
<b>Qipro</b>	Dhoma e Përfaqësuesve	80 (56 Qipriotë Grekë dhe 24 Qipriotë Turq) 1/9804 qytetarë (14 005 sikur të merren parasysh vetëm deputetët grekë)	Zgjedhje e drejtpërdrejtë me përfaqësim proporcional dhe sistem preferencial	5 vite
<b>Republika Çeke</b>	Dhoma e Deputetëve Senati	200 81 1/	Sistemi Proporcional Sistemi Mazhoritar (anëtarët zgjidhen në 81 zona)	4 vite 6 vite
<b>Estonia</b>	Riigikogu	101 1/13112 shtetas	Sistemi Proporcional	4 vite
<b>Hungaria</b>	Országgyűlés	386 1/25858 shtetas	Sistemi proporcional dhe përfaqësimi i drejtpërdrejtë	4 vite
<b>Letonia</b>	Saeima	100 1/22747 shtetas	Zgjedhje të barabarta dhe direkte, dhe me votim të fshehtë mbështetur në përfaqësimin proporcional	4 vite
<b>Litania</b>	Seimas	141 1/25432 shtetas	70 të zgjedhur nga listat partiake dhe 71 nga rajonet me një anëtar.	4 vite
<b>Malta</b>	Dhoma e Përfaqësuesve	65 1/6157 shtetas	Përfaqësim proporcional	5 vite
<b>Polonia</b>	Sejm (dhoma e ulët) Senati	460 100 1/68816 shtetas	Sistemi kompleks i përfaqësimit proporcional I zgjedhur me votë mazhoritare në bazë të provincave.	4 vite 4 vite
<b>Sllovenia</b>	Asambleja Kombëtare  Këshilli Kombëtar	90  40 1/15464 shtetas	88 vende të zgjedhur drejtpërdrejt në bazë të sistemit proporcional, dy vende të rezervuara për minoritetet italiane dhe hungareze (të drejtat për votim të veçantë) Anëtarët zgjidhen në mënyrë të tërthortë nga një kolegji elektoral	4 vite  5 vite
<b>Republika Sllovake</b>	Këshilli Kombëtar	150 1/36263 shtetas	Përfaqësim proporcional	4 vite

## Procedurat e miratimit

Të gjitha parlamentet në SHRA-të kanë zhvilluar procedura të ndryshme për paraqitjen, ndryshimin dhe debatimin e projektligjeve. Do të duhej një analizë shumë e hollësishme e ecurisë së një projektligji të posaçëm, në të gjitha parlamentet, për të krijuar një ide nëse një procedurë është më efikase se sa një tjetër. Një tregues i përbashkët është se projektligjet vlerësohen në tre faza në të gjitha SHRA-të. Procedurat e ndërlikuara japin kohë për të vlerësuar çështjet dhe ka shumë pak mundësi që projektligji të miratohet nga ndonjëri prej parlamenteve pa u shqyrtuar me kujdes. Disa parlamente kanë procedura të përsheptuara<sup>131</sup> dhe i përdorin shumë ato. Ajo që vijon është një pamje e përgjithshme që tregon kompleksitetin e procesit dhe nënvizon nevojën që SHRA-të të mbajnë nën shqyrtim procedurat e tyre. Vjen një kohë kur ato duhet të pyesin veten:

- Pse janë kaq të ndryshëm këto sisteme?
- Çfarë qëllimi i shërbejnë procedurat e ndryshme?
- A ka mundësi që ligjet të diskutohen dhe miratohen në një mënyrë më efikase dhe efektive?

### *Faza (leximi) e parë*

Faza e parë në të gjitha SHRA-të është dërgimi i projektligjit në parlament. Megjithatë, në **Sloveni** seanca e parë mund të shmanget dhe zhvillohet vetëm nëse kërkohet nga të paktën 10 anëtarë të parlamentit (deputetë) (nga 90).

Në **Maltë** paraqitja e projektligjit mbështetet në një mocion që kërkon “që të jepet leja për të sjellë një projektligj të tillë”. Pra faza e parë është një miratim formal i titullit të projektligjit.

Në vende të tjera, faza e parë mund të ketë si qëllim përcaktimin e komisionit që do të jetë përgjegjës për punën për projektligjin (**Republika Çeke, Estonia, Lituania** dhe **Republika Sllovake**).

### *Faza (leximi) e dytë*

Faza e dytë në **Qipro, Estoni, Hungari** dhe **Letoni** fillon me paraqitjen e raportit të përgatitur nga komisioni përgjegjës për studimin e projektligjit. Roli i komisionit në këtë fazë është të përqendrohet mbi parimet e përgjithshme të projektligjit. Në **Republikën Çeke, Lituani** dhe **Republikën Sllovake**, faza e dytë inicion një diskutim më të hollësishëm, pjesë pas pjesë, mbështetur në raportin e komisionit drejtues.

Në **Republikën Sllovake**, Këshilli Kombëtar mund vetëm të debatojë mbi projektligjin në fazën e dytë, pas të paktën 48 orëve nga koha kur është dorëzuar raporti i komisionit të krijuar për të shqyrtuar projektligjin. Në **Maltë**, kur caktohet një datë për fazën e dytë të projektligjit, Drejtuesi i Dhomës i jep çdo Anëtar të Dhomës një kopje të printuar dhe urdhëron botimin e tij në Fletoren Zyrtare të Maltës.

Në **Sloveni**, gjatë fazës së dytë, njësia e punës së Asamblesë Kombëtare përgjegjëse diskuton mbi projektligjin, nen pas neni, përpara se të diskutohet në Asamblenë Kombëtare si i tërë.

Ndryshimet e propozuara mund të shqyrtohen pastaj në fazën e dytë të dëgjimit (**Republika Çeke, Estonia** dhe **Hungaria**). Në **Estoni**, pas mbylljes së fazës së parë, anëtarët e *Riigikogu-t* mund të dërgojnë në komisionin drejtues mocion për ndryshime. Nëse ai komision e pranon ndryshimin e propozuar, ai hidhet për votim. Senca e dytë e projektit mund të pezullohet për të lejuar kohën e duhur për përmirësimin e projektligjit dhe për të dërguar mocionet për ndryshime.

<sup>131</sup> Në disa vende, sikurse janë Republika Çeke, Polonia, and Republika Sllovake, Urdhëri i Përhershëm i Parlamentit krijon të ashtuquajturën procedurë të përsheptuar legjislative, sipas së cilës koha e procedurës së miratimit pakësohet, zakonisht përmes uljes së numrit të dëgjimeve të detyrueshme. Për shembull, në Republikën e Sllovakisë, të tre dëgjimet e nevojshme bëhen gjatë një seance të vetme plenare.

Përdorimi i tepërt i një procedure të tillë, sikurse është thënë nga Këshilli Kombëtar i Republikës Sllovake, mund të jetë rezultat i një mungese të përgatitjes së përshtatshme nga ana e qeverisë ose një punë më pak efikase nga ana e parlamentit.

Mes diskutimit të dytë dhe të tretë, në **Republikën Çeke** dhe **Poloni**, një projektligj apo projekt rezolutë mund të kthehet tek komisionet që e kanë shqyrtuar, nëse ka ndryshime dhe mocione të reja të bëra gjatë fazës së dytë. Në **Republikën Çeke** mbahet një debat i hollësishëm parlamentar mbi dispozita të veçanta të projektit dhe ndryshimeve të propozuara kur Dhoma e Deputetëve ka vendosur që të mos e kthejë draftin tek një komision për diskutim të mëtejshëm. Në **Poloni**, komisionet mund të paraqesin tek *Sejm* një raport shtesë në të cilin ato mund të propozojnë miratimin apo hedhjen poshtë të projektligjit në tërësi.

### ***Faza (leximi)e tretë***

Në **Qipro**, **Letoni**, **Maltë**, **Poloni**, **Republikën Sllovaqe** dhe në **Siloveni**, pas fazës së tretë mund të merret parasysh të bëhen ndryshime. Në **Maltë**, në fazën e tretë mund të bëhen vetëm ndryshime me gojë për ndonjë ligj. Në **Republikën Sllovaqe**, faza e tretë kryhet vetëm për ato dispozita për të cilat janë miratuar në fazën e dytë propozimet për ndryshim. Një deputet në seancën e tretë vetëm mund të propozojë ndryshime të parregullsive tekniko-legjislative dhe të gabimeve gramatikore. Në fazën e tretë të leximit të projektit, në të gjitha SHRA-të, drafti diskutohet për herë të fundit; pasi mbyllen diskutimet, projektligji hidhet në votim përfundimtar.

Në **Siloveni**, ndryshime mund të bëhen tek ato nene në të cilat janë miratuar ndryshime në fazën e dytë. Qeveria mund të propozojë një ndryshim vetëm nëse nuk e ka propozuar ajo projektligjin që diskutohet. Qeveria apo anëtarë që propozon projektligjin mund të propozojë ndryshime për ato ndryshime të bëra, por jo për tekstin origjinal të propozuar.

### ***Vota nga asambleja tjetër në rastin e parlamentit me dy dhoma***

Në rastin e parlamentit me dy dhoma, siç është në **Republikën Çeke** dhe **Poloni**, pasi miratohet projektligji nga një asamble, dërgohet tek asambleja tjetër, që mund ta miratojë, refuzojë apo ndryshojë atë. Në të dy rastet e fundit, projektligji kthehet tek asambleja që e diskutoi për herë të parë dhe ka një procedurë për të garantuar që së fundi të arrihet një konsensus mes të dyja asambleve.

Në **Republikën Çeke**, senatorët mund të ndjekin një seancë të Dhomës së Deputetëve dhe të justifikojnë vendimin e Senatit kur një projektligj është kthyer me ndryshimet e propozuara apo nëse një projektligj është refuzuar.

Në **Poloni**, senati, brenda 30 ditësh nga dorëzimi i projektligjit, mund ta miratojë atë pa ndryshim, të miratojë ndryshimet apo të vendosë ta refuzojë atë plotësisht<sup>132</sup>. Nëse, brenda 30 ditëve pas dorëzimit të projektligjit në Asamble, Senati nuk arrin të japë një zgjidhje, projektligji konsiderohet i miratuar sipas formulimit të dorëzuar nga *Sejm*. Një procedurë e ngjashme ekziston dhe në **Republikën Çeke**.

### ***Nisja e projektligjeve dhe ndryshimeve nga anëtarët e parlamentit***

Kur anëtarët e parlamentit bëhen nismëtarë të një legjislacioni apo propozojnë ndryshime, është shumë e rëndësishme që ata ta bëjnë këtë me të njëjtën vëmendje edhe ndaj hollësive teknike, si në rastin e projektligjit apo ndryshimit të përgatitur nga një anëtar i qeverisë me ndihmën teknike të zyrtarëve të tij/saj. Ndryshe, veprimet mund të çojnë në propozimin e ligjeve të papërshtatshme dhe në cenimin e cilësisë së legjislacionit si pasojë e ndryshimeve të menduara keq.

Për të vlerësuar shkallën në të cilën janë futur parimet e Normimit më të Mirë në një vend, është e rëndësishme që të analizohet nëse propozimet nga anëtarët e parlamentit janë subjekt i të njëjtit proces të analizës së politikave dhe të hartimit të ligjeve, si ato të ndjekura në degën e ekzekutivit.

Në disa SHRA, bëhen përpjekje për të ruajtur integritetin e veprimtarive parlamentare, duke garantuar që propozimet për projektligjet dhe ndryshimet e propozuara nga anëtarët e parlamentit të jenë subjekt i një vlerësimi të hollësishëm analitik, larg diskutimeve të njëanshme në dhomën e parlamentit.

---

<sup>132</sup> Neni 121 i Kushtetutës.

Në disa vende (**Estoni, Hungari, Lituani** dhe **Republika Sllovaqe**), projektligjet e nisura nga anëtarët e parlamentit duhet të dërgohen tek qeveria për shqyrtim. Në disa vende, projektligjet shoqërohen me një dokument shpjegues (**Qipro, Estoni, Letoni, Republika Sllovaqe** dhe **Sloveni**) në të njëjtën mënyrë si edhe projektligjet qeveritare.

Në **Lituani**, një projektligj duhet të dërgohet tek Departamenti i Legjislacionit Europian në Ministrinë e Drejtësisë për vlerësimin e përputhshmërisë së tij me ligjet e Bashkimit Europian. Nëse i kërkohet mendim, qeveria ka vetëm të drejtë të japë një përfundim dhe të propozojë ndryshime. Ndryshimet në një projektligj nuk mund të bëhen pa pëlqimin e grupit të punës së parlamentit.

Në **Republikën e Sllovakisë**, propozimi nga parlamenti dërgohet tek kryetari i Këshillit Kombëtar të Qeverisë për opinion. Ai diskutohet brenda Këshillit Legjislativ dhe paraqitet tek qeveria nga ministri, fusha e përgjegjësisë e të cilit ndikohet nga propozimi. Nëse qeveria nuk jep pozicionin e vet për propozimin brenda një afati kohor 30 ditor, propozimi diskutohet nga Këshilli Kombëtar dhe në çdo rast, qëndrimi i qeverisë ka vetëm karakter rekomandues.

Në **Sloveni**, projektligjet e dërguara në parlament duhet të shoqërohen me dokumentacion që tregon nëse janë bërë apo jo vlerësime të ndikimit, nëse janë kryer konsultime dhe se sekretariati i parlamentit ka mundësi të refuzojë projektligjin që nuk është i shoqëruar me të paktën një vlerësim ndikimi. Cilësia e këtyre vlerësimeve të ndikimeve nuk analizohet nga sekretariati, pra s'ka diskutim, dhe cilësia e vlerësimeve është e ndryshme.

### ***Rregullat e procedurës***

Rregullat koherente dhe efikase në organizimin e debateve plenare janë faktorët kryesorë për garantimin e cilësisë së debateve parlamentare dhe, si rrjedhojë, të cilësisë së veprimtarisë parlamentare dhe ligjeve të miratuara. Në veçanti, po bëhen përpjekje, përmes sistemit të komisioneve, për të vënë më shumë theksin tek puna e komisioneve të përhershme parlamentare për t'i ruajtur seancat parlamentare për diskutimet e çështjeve më madhore.

Urdhrat apo rregullat e procedurës zakonisht përfaqësojnë burimin kryesor të rregullave që normojnë rendin, kohën dhe organizimin e diskutimeve plenare si dhe kuorumin. Gjithsesi, edhe Kushtetuta mund të përmbajë dispozita themelore në këtë aspekt, siç është rasti i **Qipros**.

Në të gjitha SHRA-të, urdhrat e përhershëm krijojnë organet, siç janë kryetari dhe bordi, i cili garanton organizimin logjistik të diskutimeve parlamentare.

Në **Republikën Çeke**, bashkërendimi i punës në Dhomën e Deputetëve është detyrë e kryetarit dhe e nënkryetarit të Dhomës. Kryetari i Dhomës së Deputetëve përfaqësohet nga nënkryetarët me urdhër të tij/saj ose sipas rendit që është caktuar.

### ***Pozicionet relative të legjislativët nga ekzekutivi***

Marrëdhëniet mes anëtarëve të degës ekzekutive të qeverisë dhe parlamentit vendosen ose nga Kushtetuta, nga rregullorja e punimeve të parlamentit, ose nga marrëveshjet ndërinstitucionale.

Tek SHRA-të mund të shihen dy modele të dallueshme. Modeli i parë është kur dega ekzekutive e qeverisë kontrollon parlamentin (**Qipro, Estoni, Letoni, Lituani** dhe **Maltë**). Modeli i dytë është kur parlamenti luan një rol më aktiv. Në **Republikën Çeke, Hungari, Poloni** dhe **Republikën Sllovaqe**, parlamentet kanë një qasje më të pavarur për trajtimin e degës ekzekutive të Qeverisë. Kjo mund të ketë pasoja negative për cilësinë e legjislacionit, pasi qeveria nuk ushtron shumë kontroll mbi ndryshimet e paraqitura në fazën e miratimit. **Slovenia** qëndron diku mes këtyre dy pozicioneve, pasi parlamenti i saj është i pavarur, por respekton nevojat e degës ekzekutive të qeverisë.

### ***Prirja pozitive***

Në disa SHRA janë firmosur marrëveshje ndërinstitucionale mes qeverisë dhe parlamentit për të nxitur efikasitetin në procesin e miratimit. Në **Poloni**, në vitin 2004, Ligji për Bashkëpunimin e Këshillit të

Ministrave me *Sejm-in* dhe Senatin mbi çështjet që kanë lidhje me anëtarësimin në Bashkimin Europian përfshin dispozita mbi miratimin në kohë të projekteve që harmonizojnë legjislacionin e vendit me atë të Bashkimit Europian. Gjithsesi, bashkërendimi mes këtyre dy organeve kushtetuese i referohet vetëm rasteve të lidhura me Bashkimin Europian dhe nuk mbulon fusha të tjera.

Në **Sloveni**, bashkëpunimi i qeverisë dhe asamblesë kombëtare mbi çështjet e Bashkimit Europian normohet nga Ligji mbi Bashkëpunimin mes Asamblesë Kombëtare dhe Qeverisë për Çështjet e Bashkimit Europian<sup>133</sup>, që parashikon se ato duhet të bashkëpunojnë në përgatitjen e qëndrimit dhe komenteve në rastet kur, në situata të ngjashme kombëtare, dokumenti do të përpunohej në Asamblenë Kombëtare. Në raste të tjera, qeveria informon Asamblenë Kombëtare për zhvillimet.

### **Burimet në dispozicion të parlamentit**

Parlamentet janë relativisht të pajisur mirë me mjetet kërkimore dhe studjues. Në pjesën më të madhe të vendeve (**Qipro, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Republika Sllovaqe**), secili anëtar i parlamentit ka një asistent, ndihmës parlamentar që ka një diplomë universitare.

Në **Sloveni**, Asambleja Kombëtare i siguron një grupi deputetësh sekretare/ë, dy anëtare/ë personeli të specializuar dhe një nëpunës/e; një nëpunës/se shtesë jepet për çdo grup prej tetë deputetësh; një grup me më shumë se tetë deputetë ka dhe një ndihmës tjetër të specializuar.

Anëtarët e parlamentit mund të kenë akses tek libraritë dhe tek baza e gjerë e të dhënave, përfshirë aksesin në legjislacionin e plotë dhe të përditësuar, siç është rasti në **Maltë** dhe **Lituani**. Në këtë të fundit, që nga viti 1997, baza e të dhënave është zgjeruar me një nënsistem të ri ku mund të gjenden përkthime në lituanisht të të gjitha normimeve të Bashkimit Europian.

Në **Republikën Sllovaqe**, Biblioteka e Parlamentit i vë në dispozicion anëtarëve të Këshillit Kombëtar libra, periodikë dhe dokumente të tjerë dhe u mundëson shërbime kërkimi dhe referencash, kërkime tematike nga specialistët dhe krijon një bazë të dhënash të automatizuar për librat, periodikët dhe nenet nga periodikët e zgjedhur<sup>134</sup>.

Në **Republikën Çeke, Letoni, Lituani, Maltë, Hungari** dhe Republikën Sllovaqe, anëtarët e parlamentit mund të përfitojnë edhe nga shërbimet e ofruara nga personeli mbështetës i parlamentit, i caktuar për komisionet ose nga njësitë e veçanta të mbështetjes. Përveç informacionit të dhënë nga personeli mbështetës i parlamentit, deputetët e parlamentit, si në rastin e **Qipros**, mund të vizitojnë parlamentet në vendet e tjera për të shkëmbyer përvojat.

Cilado qoftë madhësia e tyre, njësitë mbështetëse duket që janë shumë të rëndësishme, pasi analiza dhe veprimet e tyre ndihmojnë parlamentin për të kontrolluar cilësinë e projektligjeve. Përveç kësaj, në disa SHRA, ato ndihmojnë deputetët e parlamentit për të hartuar propozime apo amendime si dhe për të vlerësuar projektligjet qeveritare.

Në **Estoni**, Parlamenti ka ndjekur të njëjtat rregulla teknike për hartimin e normimeve si edhe qeveria. Këto rregulla përfshijnë domosdoshmërinë për të shqyrtuar listën e ndikimeve që duhet të vlerësohen gjatë hartimit të legjislacionit dhe personeli mbështetës, mund të ndihmojë deputetët e parlamentit për kryerjen e këtyre vlerësimeve.

Në **Lituani**, Departamenti i Analizës së Informacionit në Zyrën e Parlamentit prodhon analiza krahasuese dhe interpretim të rregulloreve të vendeve të huaja, analiza të praktikës rregullatore në fusha të ndryshme dhe jep çdo informacion të kërkuar nga deputetët. Departamenti shpesh kontribuon për arsyetimin e dhënë nga Departamenti Juridik i Parlamentit, kur ky i fundit kryen analizën dhe interpretimin e rregulloreve lituaneze.

<sup>133</sup> Fletorja Zyrtare e RS, Nr. 34/2004.

<sup>134</sup> Për shembull, Biblioteka Parlamentare Dixhitale Sllovaqe, që përmban dokumenta elektronikë të të gjitha parlamenteve që kanë ekzistuar në territorin e Republikës Çeke dhe Sllovaqe që nga viti 1848.

Në **Poloni**, Kancelaria e *Sejm-it* ka, përveç bibliotekës së *Sejm-it*, Zyrën për Studime, që është përgjegjëse për kryerjen e analizave ligjore, sociale dhe ekonomike për procesin e legjislacionit, si dhe Zyrën për Legjislacionin, që merr pjesë në punën e komisioneve dhe ndihmon anëtarët e *Sejm-it* duke hartuar projektligjet dhe amendimet, ndryshimet.

Të gjithë parlamentet në SHRA-të duket se nuk e kanë përvojën dhe njohuritë në dispozicion të qeverive. Në **Hungari**, zyra e parlamentit ka 660 punonjës; numri i personelit mbështetës ndryshon, por zakonisht, është relativisht i kufizuar. Vetëm 15 punonjës janë të përfshirë në administratën e Parlamentit të **Qipros**, nga të cilët vetëm disa kanë aftësi kërkimore. Një numër i njëjtë personeli është i punësuar dhe në Institutin Parlamentar të **Republikës Çeke**.

Në **Republikën Çeke** ka një sërë problemesh me legjislacionin, që kanë lidhje me mungesën e cilësisë së ndryshimeve të propozuara për legjislacionin dhe me mungesën e disiplinës në menaxhimin e legjislacionit. Shumë prej ndryshimeve të propozuara, nuk marrin parasysh plotësisht sferën dhe qëllimin e legjislacionit, ose i referohen një çështjeje që nuk trajtohet fare nga projektligji i diskutuar. Nëse miratohen, këto ndryshime shtrembërojnë keq kuptimin e projektligjit për të cilin janë propozuar ndryshimet dhe vështirësojnë zbatimin e ligjit që del nga kjo procedurë.

Në **Sllloveni**, vlerësimi i ligjeve që kryhet nga legjislativi dhe shërbimi ligjor është thjesht formal dhe nuk merret me thelbin e propozimit. Përveç kësaj duket sikur përsërit vlerësimin që është bërë nga Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë.

## **Rezultatet e arritura**

Në të gjitha SHRA-të, deputetët e parlamentit mund të propozojnë legjislacion. Në **Qipro**, sipas Kushtetutës, një anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve mund të propozojë një ligj, me kusht që të mos rëndojë buxhetin e shtetit.

Në disa SHRA, projektligjet mund të propozohen edhe si rrjedhojë e kërkesës së një numri të caktuar qytetarësh. Në **Lituani**, për shembull, 50 000 qytetarë mund të dërgojnë një projektligj në parlament. Në **Poloni** - 100 000 dhe në **Sllloveni** pesë mijë apo më shumë votues mund të paraqesin një propozim legjislativ.

Në praktikë dhe në përgjithësi, në SHRA-të e studiuara, pjesa më e madhe e ligjeve të diskutuara dhe të miratuara paraqiten nga qeveria dhe kalohen shumë pak projektligje të propozuara nga deputetët e parlamentit apo nga çdo person apo organ tjetër.

Numri i projektligjeve të propozuar nga partitë opozitare përfaqëson një përqindje shumë të vogël të numrit të përgjithshëm të projektligjeve të dërguara në parlament.



Vendi	% e projektligjeve të paraqitura nga parlamenti	Numri i projektligjeve qeveritare të kaluara		Numri i projektligjeve parlamentare		Numri i projektligjeve të diskutuara		Numri i projektligjeve të miratuara		Numri i projektligjeve të paraqitura nga partitë opozitare/deputetet		Numri i përgjithshëm i personelit mbështetës që punon në parlament
		2005	Legjislatura aktuale apo e fundit <sup>135</sup>	2005	Legjislatura aktuale apo e fundit	2005	Legjislatura aktuale apo e fundit	2005	Legjislatura aktuale apo e fundit	2005	Legjislatura aktuale apo e fundit	
<b>Qipro</b>	12%		318 <sup>136</sup>		61		514		455		63	100
<b>Republika Çeke</b> <sup>137</sup>	40%		450		220		740		489		92	570, përfshirë 15 në institutin parlamentar
<b>Riigikogu (Estonia)</b>	20.5% <sup>138</sup>					245 146 në 2006		196 <sup>139</sup> 84 <sup>140</sup> në 2006		9		266
<b>Hungaria</b>	10%		470		17 nga komisionet parlamentare ("PC") 86 nga		968		573		255 <sup>141</sup>	631 + 221 zyrtarë që ndihmojnë pesë grupe parlamentare.

<sup>135</sup> Republika Sllovake: 2004 -2006; Polonia: 2001-2005; Hungaria : 2002 -2006; Republika Çeke: 2000 -2006.

<sup>136</sup> 9/2004 – 7/2006.

<sup>137</sup> Periudha e katërt zgjedhore (2002-2006).

<sup>138</sup> 2000-2004.

<sup>139</sup> 196 akte të miratuara në vitin 2005 përfshirë 161 ligje dhe 35 vendime.

<sup>140</sup> 84 akte të miratuara në vitin 2006 përfshirë 69 ligje dhe 15 vendime.

<sup>141</sup> 170 u dorëzuan nga deputetë të partive pjesëmarrëse në qeveri, 229 nga deputetë nga partitë opozitare, 17 nga deputetët e partive në qeveri dhe opozitare, 2 nga deputetë të pavarur, 5 nga deputetë të pavarur dhe deputetë nga partitë e opozitës dhe 2 nga deputetë të pavarur dhe deputetë nga partitë qeverisëse dhe të opozitës.  
Mes projektligjeve të miratuara: 68 u dërguan nga deputetë nga partitë në qeverisje, 7 nga deputetë nga partitë opozitare, 10 nga deputetë nga partitë qeveritare dhe opozitare, dhe 1 nga deputetë të pavarur dhe deputetë nga partitë opozitare.

					deputetët							
<b>Letonia</b>	1/3		296 <sup>142</sup>		81 nga deputetët 41 nga Komisioni Parlamentar				216			

<sup>142</sup> Raporti vjetor i Saeima 2005 <http://www.saeima.lv/Saeimasgadaparskats2005.pdf>.

Vendi	% e projektligjeve të paraqitura nga parlamenti	Numri i projektligjeve qeveritare të kaluara		Numri i projektligjeve parlamentare		Numri i projektligjeve të diskutuara		Numri i projektligjeve të miratuara		Numri i projektligjeve të paraqitura nga partitë opozitare/deputetët		Numri i përgjithshëm i personelit mbështetës që punon në parlament
		2005	Legjislatura aktuale apo e fundit <sup>143</sup>	2005	Legjislatura aktuale apo e fundit	2005	Legjislatura aktuale apo e fundit	2005	Legjislatura aktuale apo e fundit	2005	Legjislatura aktuale apo e fundit	
Seimas (Lituania)						869, <sup>144</sup> përfshirë 660 ligje 178 rezoluta 31 akte të tjera ligjore		397, <sup>145</sup> përfshirë 245 ligje 137 rezoluta 15 akte të tjera ligjore				504
Malta						17 (në 2006)	76 <sup>146</sup>	15 (në 2006)	69 <sup>147</sup>		3 <sup>148</sup>	
Polonia	31.5%		735		33 nga komisione të <i>Sejm-it</i> 177 nga grupet e deputetëve	92 (në 2006: 206)	1264	178	894		51	1182

<sup>143</sup> Republika Sllovake: 2004 -2006; Polonia: 2001-2005; Hungaria : 2002-2006; Republika Çeke: 2002-2006.

<sup>144</sup> Shifrat për sesionin e dytë të legjislaturës aktuale (2005/03/10 – 2005/07/07) dhe sesionin e tretë (2005/09/10 – 2005/12/23). Datat e sesionit të parë: 2004/11/15 – 2005/01/20).

<sup>145</sup> Shifrat për sesionin e dytë (2005/03/10 – 2005/07/07) dhe sesionin e tretë (2005/09/10 – 2005/12/23). Datat e sesionit të parë: 2004/11/15 – 2005/01/20).

<sup>146</sup> Nga maji 2003 deri tani.

<sup>147</sup> Nga maji 2003 deri tani.

<sup>148</sup> Nga maji 2003 deri tani.

Vendi	% e projektligjeve të paraqitura nga parlamenti	Numri i projektligjeve qeveritare të kaluara /		Numri i projektligjeve parlamentare		Numri i projektligjeve të diskutuara		Numri i projektligjeve të miratuara		Numri i projektligjeve të paraqitura nga partitë opozitare/ deputetët		Numri i përgjithshëm i personelit mbështetës që punon në parlament
		2005	Legjislatura aktuale apo fundit <sup>149</sup>	2005	Legjislatura aktuale apo fundit	2005	Legjislatura aktuale apo fundit	2005	Legjislatura aktuale apo fundit	2005	Legjislatura aktuale apo fundit	
<b>Këshilli Kombëtar i Sllovakisë</b>	14%	116	458 (83 %)	27	92 (17 %)	262		143	550			509 vende pune (kancelaria e Këshillit Kombëtar të Republikës së Sllovakisë), nga të cilat - 170 nëpunës civilë - 339 të tjerë
<b>Slovenia</b>	6%		565 <sup>150</sup>		97		602		679 <sup>151</sup>		26	364

<sup>149</sup> Republika Sllovake: 2000 -2006; Polonia: 2001-2005; Hungaria : 2002-2006; Republika Çeke: 2002-2006.

<sup>150</sup> 200 – 2004.

<sup>151</sup> Numri i ligjeve të miratuara e tejkalon numrin e projektligjeve pasi Asambleja Kombëtare miratoi ligjet që ishin propozuar në mandatin e mëparshëm.

Vitet e fundit, në parlamentet e SHRA-ve një punë e madhe i është kushtuar zbatimit të legjislacionit të Bashkimit Europian dhe si rrjedhojë rezultatet kanë qenë të shumta.

Gjithsesi, cilësia e punës së kryer në një periudhë kaq të shkurtër kohe dhe nën një presion kaq të madh, po vihet në diskutim. Në shumë SHRA, çështjet e brendshme u lanë pothuajse mënjanë dhe ajo çka nevojitet tani është një periudhë reflektimi dhe vlerësimi. Në shumë SHRA, punonjësit dhe përfaqësuesit e bizneseve dhe OJF-ve theksuan nevojën për uljen e ritmit të parlamentit dhe përqendrimin e tij më shumë tek cilësia se sa tek sasia.

## Raportimet dhe vlerësimet publike

Komisionet parlamentare kanë të drejtën të ftojnë anëtarët e kabinetit tek takimet e tyre dhe t'u kërkojnë atyre shpjegimet, raportet dhe dokumentet e nevojshëm; ata janë të detyruar që të marrin pjesë në një takim komisioni, të japin shpjegimet dhe raportet e duhura dhe të paraqesin dokumentet.

Zakonisht, projektligjet diskutohen në komisione në fazën e parë të procesit të miratimit. Kështu ndodh në pjesën më të madhe të vendeve, përveç **Maltës**, ku diskutimi mbi pjesët e projektligjit në seancat plenare zhvillohet mbështetur në komentet e dhëna nga komisioni përkatës. Edhe pse kompetencat e komisioneve parlamentare mund të ndryshojnë nga një SHRA tek tjetri, komisionet zakonisht kanë të drejtë të shqyrtojnë plotësisht projektligjin e dorëzuar.

Në **Lituani**, fusha e veprimit dhe rëndësia e komisioneve parlamentare është rritur dukshëm pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Parlamentit në vitin 1999<sup>152</sup>.

Në të gjitha SHRA-të, komisionet mund të kërkojnë që anëtarët e qeverisë apo të administratës të japin më shumë informacion. Përveç kësaj, diskutimet në fazën e komisionit zakonisht përfshijnë konsultime me një gamë të gjerë të të interesuarve, ku përfshihen edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe ekspertët.

Në pjesën më të madhe të SHRA-ve, parlamenti dhe komisionet parlamentare kanë të drejtë të dërgojnë tek Kryeministri apo tek një ministër pyetje dhe kërkesa për dokumente të mëtejshëm, për të cilat ky i fundit është përgjegjës (**Qipro, Republika Çeke, Letonia, Malta, Polonia, Republika Slloake dhe Sllovenia**).

Një tipar i veçantë i procesit të miratimit në **Qipro** dhe **Letoni** është fakti se jo vetëm ministrat, por edhe nëpunësit mund të thirren përpara komisioneve të parlamentit dhe t'u kërkohet të japin shpjegime mbi vendimet e politikave.

Në **Qipro, Republikën Çeke** (senati), **Letoni**, **Lituani** dhe **Poloni**, komisionet ose vetë parlamenti mund të ftojnë jo vetëm përfaqësuesit e qeverisë, por edhe të gjitha palët e interesuara për të dhënë mendimin e tyre. Gjithsesi, procedurat që organizojnë seancat publike shpesh as nuk janë të fiksuara dhe as nuk përdoren rregullisht.

Në **Lituani**, në përputhje me Statutin e Parlamentit të vitit 1999<sup>153</sup>, komisioni i interesuar dërgon projektligjin tek të gjitha institucionet e interesuara shtetërore dhe, nëse është e nevojshme, tek organizatat publike, tek pushteti vendor, partitë dhe organizatat politike. Periudha kohore në dispozicion për këshillim është më e gjatë se sa ajo e lejuar për këshillimet qeveritare. Gjithsesi, duket se nuk ekziston ndonjë rregull i përcaktuar qartë për këtë rast.

Në **Letoni**, OJQ-të mund të marrin pjesë në seancat plenare dhe në takimet e komisioneve parlamentare. Megjithatë, OJQ-të që kanë interes vetëm për pjesë të caktuara të legjislacionit përballen me disa vështirësi, siç janë pamundësia për të siguruar leje për të hyrë në ndërtesën e parlamentit. Përveç kësaj, parlamenti, vetëm në raste të rralla, ka mbajtur seanca dëgjimore për të dëgjuar pikëpamjet e komunitetit të OJQ-ve.

---

<sup>152</sup> Hyri në fuqi në 1 shkurt 1999.

<sup>153</sup> 1 shkurt 1999.

Në **Poloni** mund të mbahet një seancë publike për një projektligj, nëse komisioni që e shqyrton miraton një rezolutë në lidhje me projektligjin.

#### ***Mundësi të kufizuara për vlerësim të pavarur***

Në pjesën më të madhe të SHRA-ve, kapaciteti i parlamenteve për të kryer hetime të pavarura mbetet i kufizuar. Në **Hungari** nuk kryhen hetime publike nga parlamenti. Në disa SHRA, p.sh. **Republikën Çeke** (Dhoma e Deputetëve) **Estoni, Letoni, Lituani** dhe **Sllloveni**, parlamenti mund të zgjedhë ose të caktojë komisione hetimore.

Në **Lituani**, për zgjidhjen e detyrave afatshkurtra apo të kufizuara, *Seimas* mund të krijojë komisione të përhershme për të shqyrtuar probleme të veçanta, apo të krijojë komisione hetimore *ad hoc*, apo komisione kontrolli, vlerësimi, apo komisione të tjera për të shqyrtuar, përgatitur ose përmbushur një mision tjetër të *Seimas*. Në praktikë janë gjetur disa raste dublikimi të punës së komisioneve parlamentare dhe komiteteve.

Në **Sllloveni**, Asambleja Kombëtare mund të urdhërojë hetime në lidhje me çështje të rëndësishme publike, kur kjo kërkohet nga një e treta e deputetëve të Asamblesë Kombëtare ose kur kërkohet nga Këshilli Kombëtar. Për këtë qëllim, ajo cakton një komision i cili, për qëllimin e hetimit dhe të vlerësimit, ka kompetenca të ngjashme me ato të një gjykatësi. Asambleja Kombëtare ka ndërmarrë një sërë hetimesh parlamentare *ad hoc*, përfshirë një hetim të kohëve të fundit mbi shkrirjen, bashkimin e kompanive.

Në përgjithësi, parlamenteve u drejtohen dhe u raportojnë organe të ndryshme që kryejnë hetime në fushën e tyre të kompetencave. Për shembull, në **Hungari**, Zyra e Auditimit të Shtetit<sup>154</sup> dhe Komiteti Hungarez i Energjisë Atomike raportojnë çdo vit në parlament.

---

154

<http://www.asz.hu/ASZ/www.nsf/AMain?Openframeset>.

## 6. ZBATIMI DHE RESPEKTIMI

*Kjo pjesë flet për zbatimin dhe respektimin e Ligjit të Pronësisë Intelektuale dhe Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit.*

Zbatimi dhe respektimi janë elementë shumë thelbësorë për të pasur një menaxhim rregullator efektiv. Do të duhej një studim i gjerë për të vlerësuar se deri në çfarë mase është respektuar dhe përputhur i gjithë legjislacioni në SHRA. Për këtë arsye u përzgjedhën vetëm dy fusha të ligjit (ligji për mjedisin dhe ligji për pronësinë intelektuale), si tregues të disa prirjeve të përgjithshme. Këto fusha u zgjedhën për shkak të rëndësisë së tyre në SHRA-të dhe në ekonomitë e tyre dhe për shkak se veprimi i tyre shtrihej mbi një gamë të gjerë instrumentesh administrativë, civilë e penalë të zbatimit dhe respektimit.

Në të gjitha SHRA-të kuptohej mirë se zbatimi efektiv varet nga strukturat e përshtatshme që krijohen për ta arritur një gjë të tillë dhe nga stimujt në fuqi për të siguruar respektimin.

Vlerësimet e kryera kishin për qëllim t'u jepnin përgjigje pyetjeve të mëposhtme në lidhje me ligjin për mjedisin dhe ligjin për pronësinë intelektuale:

- Cilat janë qasjet e përgjithshme ose filozofitë e ndjekura për respektim dhe zbatim?
- A ishin financuar si duhet politikat për zbatimin dhe respektimin e legjislacionit në këto fusha?
- A kishte prirje drejt niveleve më të larta të respektimit apo zbatimit?
- Cilat ishin procedurat në fuqi që u mundësonin shtetasve të kundërshtonin vendimet administrative apo gjyqësore?

### **Qasja apo filozofia e përgjithshme e zbatimit dhe respektimit**

Në të gjitha SHRA-të, filozofia e përdorur ishte “toleranca zero”. Në asnjë vend nuk përmendej filozofia e një modeli normimi proporcional, mbështetur në vlerësimin e rrezikut. Për shkak të burimeve të kufizuara në të gjitha SHRA-të, cilësia e zbatimit dhe vëmendja ndaj teknikave për respektimin e normave ndryshon shumë, pa ndonjë model të dallueshëm, në të dhjetë SHRA-të.

Disa vende kishin përdorur ndëshkime administrative.

#### **Ndëshkimet administrative**

Një ndëshkim administrativ kryhet kur punonjësi i zbatimit të ligjit, gjatë një inspektimi, identifikon një shkelje të ligjit. Ai ose ajo mund të kërkojë që shkelja të korrigjohet brenda një kohe të caktuar apo që të paguhet një gjobë në çast. Në disa raste, shkelja mund të shlyhet nëpërmjet kryerjes së një pune nga një palë të tretë, dhe kostoja e kësaj pune do të paguhet nga personi që kryen shkeljen.

Në **Estoni**, për shembull, ka një prirje që parapëlqehet të përdoren korigjimet administrative më shumë sesa ndëshkimet penale, veçanërisht pas procedurave të përmirësuara që parashikoi Ligji për Zbatimin Alternativ dhe Pagesën e Gjobave.

Sipas këtij ligji mund të zbatohet një dënim administrativ nëse nuk janë plotësuar kërkesat e një autoriteti administrativ brenda periudhës kohore të shënuar në njoftimin paralajmërues. Dënimi administrativ shihet nga zyrtarët e **Estonisë** si më efikas se sa një dënim penal për të arritur respektimin e ligjeve mbi mjedisin.

Një qasje e ngjashme është ndjekur dhe nga **Republika Çeke** dhe **Slovenia**, sipas zyrtarëve të këtyre SHRA-ve. Dënimet administrative përdoren dhe në **Qipro**.

Zyrtarët në këto SHRA e pranojnë se kjo qasje është më e vështirë, për sa i përket kohës dhe energjisë, dhe ka një rrezik më të madh të preket nga korrupsioni. Gjithsesi, zyrtarët e intervistuar ishin të bindur se detyrimi i shkelësve të ligjit që të ndreqin problemet që kanë shkaktuar vetë është më efektiv se sa ndjekja penale, rezultati i së cilës nuk është i sigurt.

Dokumentimi i suksesit të zbatimit dhe respektimit ndryshon nga një SHRA në tjetrën. Në disa prej tyre, informacioni në këtë fushë është më transparent se sa në të tjerat.

Në **Maltë**, raportet e botuara nga Autoriteti i Mjedisit dhe Planifikimit (MEPA) kanë përcaktuar përparësitë për vitet në vijim. Për shembull, Seksioni i Ankesave për Zbatimin dhe i Respektimit (ECCS)<sup>155</sup> ka përparësi heqjen e numrit të madh të reklamave dhe tabelave që ishin vënë pa leje dhe shëmtonin pamjet e qyteteve. Po ashtu, iu dha përparësi pastrimit apo heqjes së pikave të grumbullimit të skrapit dhe qindra ton mbeturinash dhe materiali skrap u depozituan në ambientet e riciklimit.

Në **Poloni**, për shembull, Kryeinspektori i për Mbrojtjen e Mjedisit publikon një raport vjetor të quajtur “Udhëzimet e Përgjithshme në Veprimtaritë e Inspektimit për Mbrojtjen e Mjedisit”. Raporti përcakton përparësi për veprimtaritë e zbatimit, p.sh. inspektime mbi format e veprimtarive të biznesit apo format e ndryshme të legjislacionit, që do të kenë përparësi për inspektim. Në bazë të këtij raporti, secili Inspektorat *Voivodship* i Mbrojtjes së Mjedisit përgatit një plan vjetor të hollësishëm për zbatimin. Një informacion i ngjashëm (por i pabotuar) është në dispozicion edhe në Slloveni dhe Inspektorati për Mjedisin dhe Planifikimin e Territorit ka një plan vjetor, i cili u jep përparësi fushave për mbikëqyrje të veçantë dhe zbatimit të legjislacionit të caktuar.

### **A ka politika në fuqi për zbatimin dhe respektimin e legjislacionit mjedisor dhe a kanë fondet dhe burimet e duhura të drejtat e pronësisë intelektuale?**

Të gjitha SHRA-të patën vështirësi për garantimin e burimeve të mjaftueshme për t’u marrë me të gjitha shkeljet. Vështirësi të veçanta u raportuan në **Qipro** dhe **Slloveni**. Në të parën, zyrtarët e Ministrisë së Mjedisit treguan se ishin harxhuar energji dhe burime të mëdha për të futur *acquis communautaire* në ligjet qipriote, duke lënë pak burime njerëzore apo financiare për inspektimet dhe zbatimin<sup>156</sup>.

Në **Lituani**, të dhënat statistikore mbi numrin e inspektorëve nuk japin një panoramë të plotë të aftësive të administratës për të zbatuar të gjithë legjislacionin. Gjithsesi, komentet nga zyrtarët në fushën e të drejtës mjedisore treguan se do të ishte e nevojshme një farë rritje e kapacitetit për të siguruar numrin e duhur të inspektorëve.

Megjithatë, shumë nga pasojat e dëmshme të shkeljeve të ligjit të pronësisë intelektuale janë identifikuar nga njësitë tregtare, interesat e të cilave preken drejtpërsëdrejti nga këto shkelje. Këto njësi shpesh kanë burimet për të ndërmarrë veprime civile. Në disa forma veprimesh, siç janë veprimet kundër shkeljeve të së drejtës së autorit, personat që nuk kanë mundësi të ndërmarrin veprime ligjore mund të përfitojnë nga përfshirja në shoqëritë e përbashkëta, që janë më të afta për të ndërmarrë veprime kolektive në emër të anëtarëve të tyre.

### **A ka ndonjë prirje drejt niveleve më të larta të zbatimit ose respektimit?**

Të gjitha SHRA-të raportuan përmirësime për sa i përket zbatimit. Raportet nga njësitë e mbrojtjes së mjedisit japin disa të dhëna, por krahasimet janë të vështira, pasi të dhënat mblidhen për arsye të ndryshme në SHRA të ndryshme.

<sup>155</sup> Shih Autoriteti për Mjedisin dhe Planifikimin në Maltë (2005), Raporti vjetor, f. 36 [www.mepa.org.mt](http://www.mepa.org.mt).

<sup>156</sup> Në Qipro, Regjistri i Kompanieve ka dhe përgjegjësi për zbatimin e pronësisë intelektuale, por zyra nuk ka kapacitet të zhvillojë bazën e saj të të dhënave për të qenë e aftë të vlerësojë nivelet e zbatimit, nga viti në vit.



Performanca e zbatimit mund të ndryshojë brenda një SHRA-i, në varësi të sektorit të marrë në shqyrtim. Kjo mund të vijë nga fakti se mekanizmat e zbatimit brenda SHRA-ve zakonisht nuk janë të standardizuar.

Në **Republikën Çeke**, një raport i përgatitur nga Ministria e Brendshme që shqyrton të gjitha masat e inspektimit për një gamë të gjerë ligjesh, zbuloi disa të meta të legjislacionit mbi inspektimin, kontrollin ku përfshiheshin mbivendosje e mekanizmave dhe mospërputhje e terminologjisë së përdorur. Aktualisht, procedurat e inspektimit që kryhen nga autoritetet e administratës publike normohen nga disa qindra akte. Ministria e Brendshme nisi një projekt për të thjeshtuar dhe bashkuar sistemin e kontrollit në Republikën Çeke dhe për të rritur transparencën e tij për publikun e gjerë. Kjo duhet të arrihet përmes miratimit të një rregulloreje të vetme, e cila do të zëvendësonte të gjitha rregulloret ekzistuese. Ministria e Brendshme është duke përgatitur një propozim themelor për aktin e lartpërmendur dhe planifikon ta dorëzojë atë në qeveri në prill të vitit 2007.

Në **Lituani**, komentet nga burimet brenda industrisë tregojnë vështirësi në interpretimin e disa rregulloreve mjedisore.

Në **Maltë**, secila ministri apo njësi zbatuese mund të ketë mekanizmat e saj për të garantuar respektimin e ligjeve. Kjo mund të mos jetë automatikisht negative për nivelin e zbatimit; gjithësesi, mund të kontribuojë në uljen e tij.

Zbatimi i dobët mund të lidhet dhe me faktin se autoritetet e zbatimit të ligjit nuk kanë kompetencat e mjaftueshme apo të duhura. Lidhur me këtë, situata ndryshon nga një SHRA tek tjetri.

Pengesat për zbatimin mund të dalin nga vetë ligji apo nga mënyra se si përdoret dhe interpretohet ai. Në **Qipro**, interpretimi që i bën gjyqësori rregullave të barrës së provës në lidhje me të drejtën e autorit, e bën shumë të vështirë fillimin e procedimeve ligjore kundër shkelësve.

### ***Raportet vjetore***

Dokumentimi i suksesit të zbatimit dhe respektimit ndryshon nga një SHRA tek tjetri.

Në **Maltë**, Autoriteti për Mjedisin dhe Planifikimin raporton se Seksioni i Ankesave për Zbatimin dhe i Respektimit (ECCS)<sup>157</sup> u mor me 3705 ankesa, në periudhën e mbuluar nga raporti i vitit 2005. Nga këto ankesa, 3524 morën përgjigje dhe nga këto 391 raste u zgjidhën pa nevojën për veprim ligjzbatues. ECCS-ja vëzhgoi zhvillimet në ndërtim në mënyrë që shkeljet të shlyheshin në fazën e ndërtimit të projekteve të ndërtimit. Në një numër të vogël rastesh lindi nevoja për ndjekje penale, por, në pjesën më të madhe të rasteve, mjaftoi një vizitë nga ECCS-ja për të zgjidhur problemin.

Në **Poloni**, raporti vjetor i Kryeinspektorit për Mjedisin jep disa informacione lidhur me zbatimin, ku përfshihet numri i kompanive të inspektuara në një vit të caktuar, numri i inspektimeve dhe numri i vendimeve të marra për ndërprerjen e veprimtarisë së një kompanie, për shkak të shkeljeve të ligjit për mjedisin.

### ***Listat e vëzhgimeve***

Një shembull i një mase objektive të qartë për përmirësim është ai i Zyrës së Përfaqësuesit Tregtar të SHBA-ve. Ajo publikon një raport vjetor mbi respektimin e pronësisë intelektuale që përfshin një listë vëzhgimesh prioritare. Ka dhe një listë të dytë të vendeve nën vëzhgim, për arsye se nuk ofrojnë nivelin e duhur të mbrojtjes apo respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale, apo aksesin në treg për persona që mbështeten tek mbrojtja e pronësisë intelektuale<sup>158</sup>. **Republika Sllovaqe** u hoq nga kjo listë në vitin 2005.

<sup>157</sup> Shikoni raportin vjetor për mbi Mjedisin dhe Planifikimin dhe Llogaritw 2005 f. 36 [[www.mepa.org.mt](http://www.mepa.org.mt)].

<sup>158</sup> Këto raporte janë përgatitur sipas seksionit 182 të Ligjit Tregtar 1974 (USA), i ndryshuar, përfshirë Aktin për raundin e Marrëveshjeve të Uruguait (1994), (speciali 301). Sipas dispozitës 301, USTR duhet të identifikojë ato vende, që nuk pranojnë mbrojtjen e duhur dhe efektive të IPR ose që mohojnë akses të barabartë dhe të drejtë të personave që varen nga mbrotja e pronësisë intelektuale.

Megjithatë, disa SHRA mbeten në këtë listë. **Hungaria** mbeti në Listën e Vëzhgimit për vitin 2006 edhe pse autoritetet amerikane e vlerësuan miratimin kohët e fundit të legjislacionit për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Pa diskutim që në **Hungari**, në vitet e fundit, ka pasur përparim në këtë fushë. Hungaria u hoq nga Lista Prioritare e Vëzhgimit dhe u çua në Listën e Vëzhgimit në vitin 2003. Hungaria ka ndërmarrë hapa pozitive për të modernizuar kodin e saj të së drejtës të autorit, por zbatimi i dobët i këtyre ligjeve, vonesat në ndjekje penale, gjobat e ulëta, dënimet e buta dhe kontrolli i dobët i kufirit mbeten një burim shqetësimi i pranuar edhe nga autoritetet hungareze.

Edhe **Letonia** mbeti në Listën e Vëzhgimit për vitin 2006, pavarësisht faktit se ajo ka përmirësuar zbatimin, mes të tjerave, duke përmirësuar bashkërendimin mes ministrive dhe autoriteteve të zbatimit të ligjit. Ka pasur një rritje në numrin e ndjekjeve penale, por gjobat e ulëta dhe dënimet me burgim nuk po funksionojnë si një mjet i mjaftueshëm për të parandaluar kundërvajtjet. Kontrolli i kufirit mbetet i dobët dhe pirateria në internet mbetet ende problem.

Edhe **Lituania** mbetet në listë për vitin 2006. Ajo ka përmirësuar kuadrin e saj ligjor për mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe luftën kundër piraterisë së programeve. Gjithsesi, nivelet e piraterisë në media optike mbeten të larta.

**Polonia** gjithashtu ballafaqohet me sfida nga rritja e piraterisë së programeve. Ajo mbetet në Listën e Vëzhgimeve për vitin 2006. Ka pasur një numër në rritje të kontrolleve në vitin 2005, për të ndaluar programet e piratuara, por vendimet e gjykatave për gjoba të ulëta dhe dënime të lehta me burgim duket sikur nuk kanë krijuar një ambient parandalues për shkeljet e vazhdueshme.

### **Proceset e apelimit**

Zbatimi mund të vonohet nga proceset e gjata të apelimit. Të gjitha SHRA-të kanë procese apelimi në fuqi, por në asnjë prej tyre nuk janë bërë përpjekje për të parashikuar përsheptimin e proceseve të apelimit në rastet me interes shumë të madh për publikun. Vonesat në seancat gjyqësore në disa vende, më dukshëm në **Maltë, në Republikën Sllovaqe** dhe në **Sloveni**, duhet të korrigjohen duke rritur kapacitetin dhe rishikuar procedurat për të përcaktuar nëse përmirësimet mund të vinë përmes proceseve më efektive.

Në të gjitha SHRA-të mund të kundërshtohen vendimet e marra nga autoritetet publike në fushën e të drejtës mjedisore. Në shumë SHRA, përfshirë këtu **Republikën Çeke, Maltën, Poloninë** dhe **Sloveninë**, individët fillimisht mund të kërkojnë nga autoriteti përkatës që të rishikojë vendimin e kundërshtuar përpara se të fillojnë procedurat e apelimit në gjykatë.

Në **Poloni**, vendimet mbi të drejtat e pronësisë intelektuale mund të ankimohen para një gjykate administrative apo gjykate civile. Ligji i viti 2000 për Pronësinë Industriale parashikon të drejtën e veprimit në një gjykatë administrative, ku mund të kryhet apelimi kundër vendimit të Zyrës së Patentave tek Gjykata Rajonale Administrative. Për më tepër, përveç këtyre të drejtave të parashikuara në ligjin e të drejtës së autorit dhe në ligjin për pronësinë industriale, një person i dëmtuar ka të drejtën të bëjë një padi për mbrojtjen e të drejtave civile, siç parashikohet në Kodin Civil.

Disa SHRA kanë ngritur njësi apo procedura të veçanta për apelimin e një vendimi që ka lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale. Në **Republikën e Sllovakisë**, vendimi i Zyrës së Pronësisë Industriale mund të kundërshtohet nëpërmjet një procesi me dy faza. Në fazën e parë, kundërshtimet e ngritura nga palët e treta kundër njohjes së një marke, shqyrtohen dhe zgjidhen nga Zyra. Në fazën e dytë, palët e treta që kundërshtojnë atë vendim mund të regjistrojnë një apelim tek Departamenti i Apelit të Zyrës së Pronësisë Intelektuale. Vendimi përfundimtar firmoset nga kreu i Zyrës, pas vendimit të marrë nga një Komision i pavarur, i përbërë nga pesë anëtarë (tre nga bota akademike dhe dy nga departamenti i apelimit i Zyrës).

### **Mekanizmat e zgjidhjes jashtëgjyqësore**

Të gjitha SHRA-të kanë krijuar mekanizma jashtëgjyqësorë për zgjidhje, përfshirë ngritjen e institucionit të Avokatit të Popullit dhe enteve që merren me ankesat e konsumatorit.

Avokati i Popullit është krijuar në të gjitha SHRA-të dhe zakonisht ka përgjegjësi të ngjashme. Në **Qipro**, për shembull, qytetarët mund të kundërshtojnë vendimet administrative përmes një apeli tek Zyra e Avokatit të Popullit. Përveç kësaj, në disa SHRA janë krijuar mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ku përfshihen qëndrat SOLVIT dhe mekanizmat e arbitrazhit.

Në **Maltë**, konsumatorët ka mundësi të shkojnë tek Forumi i Konsumatorit ose Gjykata e Ankesave të Konsumatorit për blerjet e bëra nga konsumatorët me vlerë deri në 1500 Lira. Ka të dhëna shumë të pakta përse i përket zbatimit. Gjithësesi, është bërë një kërkim nga Këshilli i Konsumatorëve, që doli në përfundimin se shumë vendime të marra nga Gjykata e Ankesave të Konsumatorit nuk janë zbatuar. Gjithashtu në **Maltë** kohët e fundit arbitrazhi u bë i detyrueshëm për ankesat e kreditorëve për blerje nën 5000 Lira, gjë që solli një ulje të dukshme të numrit të rasteve të regjistruara në gjykata. Që nga gushti i vitit 2005 janë bërë 500 ankesa sipas kësaj procedure.

Në **Republikën Sllovaqe**, në shtator të vitit 2004 u miratua Ligji mbi Ndërmjetësimin. Pas ndryshimit në vitin 2004 të Ligjit mbi Falimentimin u arrit një fleksibilitet i rëndësishëm në procedurat e falimentimit.

Në **Slloveni**, Programi i Reformës Kombëtare i miratuar në vitin 2005 nxjerr në pah nevojën për të përmirësuar funksionimin e sistemit gjyqësor. Masat e propozuara përfshijnë: thjeshtimin e procedurave, kompjuterizimin e gjykatave dhe riorganizimin e menaxhimit të gjykatave.

## 7. PËRFUNDIME

### *Të përgjithshme*

SHRA-të e vlerësuara në këtë studim janë, nga këndvështrimi gjeografik, një grup i larmishëm vendesh. Ato janë që nga ishuj të vegjël në Mesdhe deri në shtete që kanë kaluar së fundmi nga struktura të planifikimit qendror në ekonomi të tregut të lirë. Të gjitha kanë miratuar *acquis communautaire* në një periudhë shumë të shkurtër kohore dhe, shumë prej tyre, kanë pasur ndryshime të shpejta dhe shumë të mëdha në sistemet e tyre të qeverisjes. Tani që janë anëtare të BE-së, ato të gjitha përballen, në shkallë të ndryshme, me sfidën e garantimit që ligjet, të cilat janë miratuar si pjesë e procesit të anëtarësimit, të respektohen apo zbatohen dhe që ndryshimet e ardhshme të *acquis communautaire* të miratohen dhe zbatohen në një kohë të shkurtër.

Shumë SHRA përballen me çështje të brendshme të vështira, disa prej të cilave janë jashtë juridiksionit të Bashkimit Europian. Këto çështje përfshijnë: gjetjen e baraspeshës mes pritshmërisë së mbështetjes shtetërore për politikën e mirëqenies dhe pensione, përkundrejt realitetit të hidhur, ku ato duhet të financohen nga taksat; ruajtjen e konkurrueshmërisë, zgjidhjen e sfidave të papunësisë dhe emigrimit të talentit, si dhe trajtimin e të drejtave të pakicave.

Lidhur me menaxhimin rregullator, të gjitha SHRA-të kanë sisteme transparente dhe efikase për planifikimin e zbatimit të politikave të zgjedhura, për hartimin e politikave dhe zbatimin e tyre në legjislacion. Të gjitha vendet kanë politika të llojit të Normimit më të Mirë, ku disa kanë politika të qarta të Normimit më të Mirë (**Republika Çeke, Malta dhe Polonia**), ndërsa të tjerat kanë një politikë të nënkuptuar të Normimit më të Mirë.

Mbështetja politike është një faktor i rëndësishëm i suksesit për hartimin dhe zbatimin e praktikave të përmirësuara të qeverisjes, siç janë miratimi i një politike të Normimit më të Mirë. Në disa SHRA (**Qipro, Maltë, Poloni, Slloveni**), mbështetja politike ishte shumë e dukshme, në formën e pjesëmarrjes së ministrave në konferencat mbi Normimin më të Mirë, duke folur me kompetenca mbi temën. Megjithatë, në SHRA-të e tjera, mbështetja politike ishte më pak e dukshme edhe pse referenca të çështjeve të Normimit më të Mirë mund të gjenden në të gjitha planet strategjike dhe dokumentet politikë në një formë apo në një tjetër në të gjitha SHRA-të. Këto referenca duhet të trajtohen me kujdes, pasi shumë nga këto dokumente parashtrajnë jo vetëm synime realiste dhe të arritshme, por edhe ideale dhe ambicie.

Çdo politikë e hartuar në shtetet ishkomuniste duhet të mbijetojë përkrah një numri të madh çështjesh të tjera urgjente të karakterit politik. Në periudhën deri në integrimin europian dhe menjëherë pas tij, iu dha përparësi dhe përshpejtim gjithçkaje që kishte lidhje me anëtarësimin në BE. Është e sigurt që kjo do të vazhdojë edhe në periudhën pas anëtarësimit.

### *Kapaciteti për menaxhim normues*

Në pjesën më të madhe të SHRA-ve duket se menaxhimi normues funksionon shumë mirë dhe përmirësimi i sofistikuar dhe abstrakt përmes zhvillimit të Normimit më të Mirë nuk është një çështje që ka të ngjarë të tërheqë vëmendjen e votuesve apo interes politik të vazhdueshëm. Prandaj do të jetë e vështirë puna për ta mbajtur të lartë interesin për të. Zvogëlimi i burokracisë dhe ulja e detyrimeve administrative janë çështje që mund të tërheqin pak interes, për shkak të vlerës së tyre të dukshme e të veçantë. Megjithatë, këto çështje po konkurrojnë me një gamë të gjerë sfidash të tjera dhe sigurisht që kërkojnë investime në kohë dhe para. Argumenti që politika e Normimit më të Mirë është një investim në infrastrukturën e qeverisjes, kërkon mbrojtje të aftë dhe një shkallë vizioni politik që nuk shihet qartë në pjesën më të madhe të SHRA-ve.

Sfida më e madhe e kapacitetit, me të cilën përballen SHRA-të gjatë zhvillimit dhe mirëmbajtjes së politikave për të përmirësuar qeverisjen do të jetë ose të mbajnë zyrtarët aktualë ose të krijojnë struktura që mundësojnë vazhdimësinë. Në të gjitha SHRA-të, zjarri për përmirësimin e menaxhimit rregullator mbahet gjallë nga një numër i vogël zyrtarësh të lartë. Nëse ata ngrihen në detyrë, sfida e radhës do të jetë caktimi i zyrtarëve të tjerë për të vazhduar reformat të cilat u vlerësuan të zhvilluara gjatë vlerësimeve.

### ***Kontrolli i cilësisë***

Të gjitha SHRA-të kanë krijuar praktika menaxhuese normimi për të garantuar cilësinë e legjislacionit të tyre përpara se të dërgohet në qeveri dhe në parlament për miratim. Megjithatë, praktikat kanë prirje të përqendrohen vetëm tek fakti nëse ligji ka arritur objektivat përkatëse politike dhe tek çështjet teknike, juridike, siç janë përputhshmëria me Kushtetutën, përputhja me parimet e përgjithshme të së drejtës dhe me detyrimet ndërkombëtare. Këto janë synime të rëndësishme; gjithsesi, pjesa më e madhe e SHRA-ve neglizhojnë për të kryer vlerësime të faktit nëse legjislacioni i propozuar përputhet me parimet e Normimit më të Mirë, ose nëse janë përdorur siç duhet mjetet për përgatitjen e tij (vlerësimi i ndikimit apo këshillimi). Disa SHRA po fillojnë të trajtojnë çështjet që shoqërojnë garantimin e mbajtjes në minimum të kostove administrative.

### ***Përdorimi i Mjeteve të Normimit më të Mirë***

Në pjesën më të madhe të SHRA-ve ka ligje që kërkojnë kryerjen e vlerësimit të ndikimit. Gjithsesi, pjesa më e madhe e këtyre ligjeve kanë hyrë në fuqi pa krijuar aftësitë e nevojshme apo strukturat mbështetëse dhe deri kohët e fundit nuk ka pasur përkushtim real për zbatimin e tyre. Sigurisht ka edhe mekanizma formalë në veprim, po që shpesh nuk merren parasysh. Një numër SHRA-sh (**Republika Çeke, Lituania, Polonia, Republika Slloake dhe Sllovenia**) janë në dijeni të këtij problemi dhe po e trajtojnë atë.

### ***Miratimi***

Të gjitha SHRA-të kanë institucione demokratike efektive dhe plotësisht funksionale, dhe shumë prej tyre kanë burime relativisht të mira. Gjithsesi, në pjesën më të madhe të SHRA-ve, dega legjislative e qeverisjes dominohet nga ekzekutivi. Megjithatë, në disa prej tyre (**Çeki, Hungari, Poloni dhe Republika Slloake**) parlamenti luan një rol dinamik, megjithëse jo gjithmonë efektiv, duke propozuar e miratuar ndryshime në legjislacion.

### ***Zbatimi dhe respektimi***

Zbatimi dhe respektimi nuk është një fushë që ka pasur shumë vëmendje në kuadër të studimeve mbi reformat normuese, rregullatore apo si pjesë e nismave për Normim më të Mirë. Përveç sigurimit të një pamjeje të përgjithshme të zbatimit dhe respektimit në këto fusha në SHRA-të, vlerësimet ngritën disa pyetje të themelore, studimi i të cilave në BE, si një e tërë, mund të jetë i dobishëm:

- A duhet të ketë “tolerancë zero” filozofia e zbatimit dhe respektimit, d.m.th. që çdo shkelje, pavarësisht sa e vogël, të ndiqet penalisht, apo duhet që sistemet e ndëshkimit të jenë të modelit proporcional të mbështetur tek rreziku?
- A janë më efektive ndëshkimet administrative nga ato penale, dhe në çfarë rrethanash janë ato më efektive?
- Cilat janë ndëshkimet më efektive për forma të veçanta shkeljesh?
- Cilët janë stimujt më të mirë për të garantuar nivele më të larta të respektimit?
- A duhet të hartohen të dhënat statistikore mbi respektimin dhe zbatimin nga qeveritë e vendeve të Bashkimit European në një mënyrë që do të lehtësonte krahasimet mes vendeve anëtare të Bashkimit European?

## **Rekomandime të përbashkëta për të gjitha Shtetet e Reja Anëtare**

### **1. *Për të pasur një politikë për Normim më të Mirë duhet të ketë mbështetje politike***

Mbështetja politike është thelbësore për zhvillimin e kapaciteteve të menaxhimit rregullator, në mënyrë që të mund të vendosen synime strategjike për të arritur qeverisjen e mirë përmes Normimit më të Mirë. Mbështetja politike duhet të jetë më themelore sesa disa fraza të hartuara me kujdes në deklaratat politike apo planet kombëtare. Ajo duhet të jetë e pastër dhe e mbështetur në angazhimin personal të figurave të larta politike për të arritur përmirësime në qeverisje, çka do të garantojë që normimi i shoqërive dhe ekonomive të tyre, dhe mbrojtja e mjedisit kryhet në një mënyrë të tillë që është proporcional me problemet e përjetuara, është transparent dhe trajton çështje pa pasur pasoja të papritura. Njësitë e Normimit më të Mirë mund ta lehtësojnë këtë proces duke organizuar seminare dhe duke nxitur diskutimin mbi çështjet e Normimit më të Mirë.

### **2. *Një politikë për të arritur Normim më të Mirë funksionon më mirë kur ka masa të përshtatshme dhe të financuara siç duhet në fuqi për ta mbështetur dhe ruajtur atë.***

Duhet të vihen në funksionim masat e duhura administrative për të garantuar që cilësia e hartimit të politikave dhe të legjislacionit është testuar ndaj një grupi të caktuar parimesh objektive, të hartuara dhe të miratuara për të përmirësuar menaxhimin rregullator. Në të gjitha SHRA-të, legjislacioni vlerësohet me rigorozitet për sa i përket ligjshmërisë, kushtetutshmërisë dhe përputhshmërisë me parimet e përgjithshme të së drejtës dhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare. Këto janë kërkesa të rëndësishme, por nuk mjaftojnë për të trajtuar kompleksitetin e problemeve të botës moderne. Duhet një qasje shumëdisiplinare për të garantuar që zgjidhjet e politikave të bëhen mirë dhe, kur është e përshtatshme, të shprehen në instrumentet legjislativë që plotësojnë një test të efikasitetit si dhe një test tradicional të efektivitetit ligjor.

### **3. *Kapacitetet e menaxhimit rregullator mund të zhvillohen nëpërmjet përdorimit efektiv të mjeteve të Normimit më të Mirë***

Të gjitha institucionet e interesuara (degët legjislativë dhe ekzekutive të qeverisjes dhe normuesit e pavarur) duhet të përdorin gjerësisht mjetet e normimit më të mirë në një mënyrë proporcionale. Çështja e proporcionalitetit ka një rëndësi të veçantë në lidhje me vlerësimin e ndikimit. Të gjitha SHRA-të kanë nxjerrë ligje që kërkojnë përdorimin e vlerësimit të ndikimit për të gjitha propozimet mbi politikat.

Këto kanë mundësi të jenë të suksesshme kur vlerësimet e plota të ndikimit, duke përdorur teknika të shumëllojshme dhe ekonomistë të trajnuar, përdoren për propozime për politika të rëndësishme që përfshijnë ndikime themelore. Për ndikime më të vogla, ajo që kërkohet është një ndërgjegjësim i zyrtarëve mbi ato që nevojiten, si dhe mbi kostot e mundshme që ka një propozim i caktuar.

Duhet të zhvillohen praktikatat e konsultimeve për të garantuar se njohuritë kolektive të shoqërisë përdoren gjatë hartimit të ligjeve të reja.

Mund të kryhet matja e kostove administrative, por kjo nuk duhet të heqë vëmendjen nga qëllimet më të gjera të hartimit të legjislacionit në atë mënyrë që të jetë sa më i thjeshtë dhe i lehtë për t'u respektuar, me sa më pak detyrime dhe përpjekje të dubluara.

Përdorimi i këtyre instrumenteve duhet të lehtësojë krijimin e një qasje shumëdisiplinare për hartimin e politikave dhe distancimin gradual nga kontrolli monopolist i juristëve që vlerësojnë cilësinë e legjislacionit drejt hartimit të legjislacionit që nuk është vetëm efektiv ligjërish, por dhe efikas.

### **4. *Degët ekzekutive dhe legjislativë të qeverisë duhet të bashkëpunojnë në mënyrë konstruktive për të garantuar qeverisjen e mençur***

Degët ekzekutive dhe legjislativë të qeverisë duhet të bashkëpunojnë në mënyrë konstruktive për të garantuar qeverisjen e mençur. Parlamentet në **Hungari, Poloni, Republikën Çeke dhe Republikën**

**Slovake** kanë prirje të bëjnë propozime legislative dhe të parashtrojnë ndryshime për legjislacionin duke mos marrë parasysh çështjet më afatgjata. Edhe pse këto janë çështje që u përkasin vetëm SHRA-ve të analizuara, gjithsesi është e rëndësishme që të tërhiqet vëmendja drejt nevojës për këtë bashkëpunim.

#### **5. *Vëmendje më e madhe i duhet kushtuar respektimit dhe zbatimit***

Në Bashkimin European po ndodhin ndryshime themelore në lidhje me matjen e kostove administrative, thjeshtimin dhe vlerësimin e ndikimit. Gjithsesi, sfida e ardhshme me të cilën do të përballlet Bashkimi European do të jetë garantimi i zbatimit të vazhdueshëm të legjislacionit european në të gjithë Bashkimin European. SHRA-të që kanë pranuar së fundmi *acquis communautaire*, tani përballen me sfidën e zbatimit efektiv të tij. Mënyra se si këto SHRA do të përballojnë këtë sfidë mundet të nxisë frymëzim dhe drejtim për vendet që kanë hyrë në Bashkimin European para 1 majit 2004, si dhe për ato që do të anëtarësohen në vazhdim.

## SHTOJCA 1: FJALORTH TERMASH PËR PROJEKTIN E VLERËSIMIT TË KAPACITETEVE NORMUESE

“*acquis*” (ose *acquis communautaire*) në Bashkimin Europian do të thotë i gjithë legjislacioni i Bashkimit Europian i mbledhur deri tani. Kur përdoret në kuadrin e zgjerimit dhe të anëtarësimit të SHRA-ve në Bashkimin Europian, termi i referohet të tërë grupit të legjislacionit të të drejtës komunitare që duhet të pranojnë SHRA-të, ku përfshihen:

- traktatet;
- vendimet e marra nga Institucionet e Bashkimit Europian sipas Traktateve;
- jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë.

“**Barrat administrative të normimit**” nënkupton kostot për marrjen, leximin dhe kuptimin e normave, hartimin e strategjive për respektimin dhe arritjen e kushteve të detyrueshme të raportimit, përfshirë mbledhjen e të dhënave, përpunimin, raportimin dhe ruajtjen, por **nuk** përfshihen kostot kapitale të masave të marra për të respektuar normimet, dhe as kostot që ka sektori publik për të administruar normimet.

“**Kostot administrative**” brenda institucioneve të Bashkimit Europian nënkuptojnë kostot e ndeshura nga ndërmarrjet, sektori vullnetar, autoritetet publike dhe qytetarët në plotësimin e detyrimeve ligjore për të dhënë informacion mbi veprimet apo prodhimet e tyre, ose tek autoritetet publike, ose tek palët private. Informacioni duhet të shihet në një kuptim të gjerë, d.m.th. duke përfshirë kostot e identifikimit, raportimit, monitorimit dhe vlerësimit të nevojitur për të dhënë informacion dhe për tu regjistruar. Ato janë rrjedhojë e kostove të zbatimit, që dalin nga kërkesat e përgjithshme të legjislacionit, ku përfshihen edhe kostot themelore të investimeve në proceset e reja të prodhimit, trajnimit apo kostot e përsëritura, të shtuara, të materialeve të para dhe krahut të punës (përfshijë ato administrative).

“**Kostot administrative të respektimit**” kanë të njëjtin kuptim si barrat administrative të normimit.

“**Grupet këshillimore**” nënkuptojnë ekspertët e zgjedhur apo palët e interesuara, (p.sh. partnerët socialë, grupet mjedisore) që mbledhen së bashku për të formuar një organ konsultativ, qoftë në mënyrë *ad hoc*, qoftë në mënyrë të përhershme.

“**Instrumentet e politikave alternative**” kanë të njëjtin kuptim si alternativat normuese.

“**Alternativat ndaj rregulloreve**” nënkuptojnë çdo instrument tjetër përveç normimit komando dhe kontrollo, të përdorur për qëllimin e arritjes së synimeve të politikave dhe që përfshijnë instrumente të tilla të politikave, siç janë:

- normimi i mbështetur në performancë;
- normimi i procesit;
- dispozitat e heqjes dorë apo të mosmarrëveshjes;
- bashkë-normimi;
- vetë-normimi;
- marrëveshjet kontraktuale;
- marrëveshjet vullnetare;



- lejet e shkëmbyeshme;
- taksat dhe subvencionet;
- skemat e sigurimeve ose fushatat e informimit.

“**Standardi**” është pika minimale ose pika e fillimit për krahasimet; në këtë rast, është një numër minimal i kriterëve të hartuara nga SIGMA, në konsultim me Komisionin Europian, për këtë projekt.

“**Normim më i Mirë, Menaxhimi Rregullator, Normimi më i Mirë dhe Normimi më i Zgjuar**” janë termat që po përdoren sa vjen e më shumë për të treguar konceptin e një angazhimi të vazhdueshëm për të përmirësuar proceset e formulimit të politikave, të hartimit të legjislacionit dhe përmirësimit të efektivitetit të përgjithshëm dhe të koherencës së normimit.

“**Normimi më i Mirë**” nënkupton një politikë për të përmirësuar kapacitetet e menaxhimit rregullator, duke përdorur një qasje shumë disiplinëshe për të formuluar politikat dhe hartuar rregulloret, si dhe për të përdorur mjete si vlerësimi i ndikimit, konsultimi dhe thjeshtimi. Ai përdoret për fluksin e rregulloreve të reja dhe grupin e rregulloreve ekzistuese. Ai është e lidhur ngushtë, por shkon edhe më tej se sa reforma rregullatore që merret me reformimin e normimeve për t’i bërë ato sa më efikase. Politika e Normimit më të Mirë është hartuar për të garantuar që legjislacioni ekzistues dhe legjislacioni në të ardhmen të jenë me një cilësi të lartë, d.m.th. të jetë i qartë, konciz dhe të përdoret vetëm kur detyrimet e tij janë në përpjesëtim të drejtë me qëllimet e tij.

“**Konsumator**” dhe “**qytetar**” janë përdorur shpesh dhe është e rëndësishme të theksohet që këto nuk janë terma të njëjtë. Termi **konsumator** nënkupton individët që marrin pjesë në treg dhe konsumojnë mallra dhe shërbime të veçanta. Ai mund t’i referohet dhe bizneseve, të cilët shpesh janë konsumatorët e parë në sektorë të veçantë. Koncepti i **qytetarit** është më i gjerë dhe nënkupton marrëdhënien mes individëve dhe shtetit (pa u përdorur në kuptim strikt ligjor për të treguar kombësinë). Ka rrethana ku shteti është prodhuesi apo furnizuesi i një malli apo shërbimi tek qytetarët. Në këtë kuadër, qytetarët mund të shikohen si konsumatorë të shtetit<sup>159</sup>.

Ideja e “Normimit më të Mirë” ndihmon dhe në heqjen e një dallimi të rëndësishëm mes programit të reformimit të gjerë dhe heqjes së normimit. Është pranuar që, në disa raste, interesit të konsumatorit, investitorit dhe publikut të gjerë mund t’i shërbehet më mirë duke futur një normim të ri dhe që në raste të tjera mund t’i shërbehet më mirë përmes heqjes së normimit.

Nuk është bërë asnjë hamendësim fillestar, as mbi cilësinë apo sasinë ekzistuese të normimit, as për nevojën për heqjen e normimit. Por, sugjerohet se qëllimi i Normimit më të Mirë nuk do të arrihet thjesht duke kërkuar të zvogëlohet vëllimi i normimeve, por më shumë duke përdorur masa që janë sa më të thjeshta dhe të drejtpërdrejta, por që arrijnë të njëjtat objektiva të politikave.

“**Kapaciteti**” nënkupton aftësinë për të kryer detyrat e duhura me efektivitet, me efikasitet dhe sistematikisht.

“**Qarkullimi i propozimeve për koment**” nënkupton procesin përmes së cilit qarkullohet informacioni mbi propozimet rregullatore për koment tek një grup i caktuar specialistësh apo palësh të interesuara.

“**Kodifikimi**” nënkupton rregullimin sistematik të ligjeve në fuqi.

“**Normimet komando dhe kontrollo**” nënkupton normimet që përdorin qasjen tradicionale të vendosjes së një ndëshkimi, zakonisht një gjobë apo burgim ose të dyja bashkë, për mungesën e respektimit të një detyrimi.

“**Bashkë-normimi**” nënkupton një sistem të përgjegjësive të përbashkëta rregullatore, në të cilën një shoqatë industriale apo një grup profesional mund të marrë disa funksione normuese, siç janë ruajtja dhe respektimi apo krijimi i standardeve rregullatore.

<sup>159</sup> Shikoni Studimin mbi Normimin më të Mirë (Dublin, 2004) [www.betterregulation.irlgov.ie](http://www.betterregulation.irlgov.ie).

“**Politika e Bashkimit Europian për Normimin më të Mirë**” përfshin “Planin e Veprimit mbi thjeshtimin dhe përmirësimin e mjedisit rregullator”<sup>160</sup> si pjesë e Dokumentit të Bardhë të Komisionit Europian mbi Qeverisjen Europiane<sup>161</sup> dhe Komunikatën e marsit të vitit 2005 për “*Normimin më të Mirë për Zhvillim dhe Vende Pune në Bashkimin Europian*”<sup>162</sup> dhe Komunikatën e nëntorit të vitit 2006 “*Një vlerësim strategjik i Normimit më të Mirë në Bashkimin Europian*”<sup>163</sup>.

“**Qeverisja**” përfshin “rregullat, proceset dhe sjelljen që ndikojnë në mënyrën se si ushtrohen kompetencat, veçanërisht lidhur me hapjen, pjesëmarrjen, përgjegjshmërinë, efektivitetin dhe koherencën”. Termi në këtë dokument përdoret për t’iu referuar qeverisjes në të gjitha nivelet e qeverisjes: kombëtare, lokale dhe, herë pas here, në nivelin e sektorëve të veçantë ekonomikë.

“**Legjislacion**” nënkupton aktet e miratuara nga parlamenti.

“**Parimet e Normimit më të Mirë**” janë parimet që përdoren për hartimin e normimeve, siç janë domosdoshmëria, transparenca, proporcionaliteti dhe mundësia për t’i pasur.

“**Kapaciteti i menaxhimit normues/rregullator**” nënkupton aftësinë për të normuar me anë të formulimit të politikave dhe të zbatimit të tyre përmes normimit.

“**Politika e menaxhimit normues/rregullator**” nënkupton një politikë të veçantë mbi Menaxhimin Normues, që do të thotë: një politikë që ka për objekt përmirësimin e cilësisë normuese dhe që nxitet politikisht dhe nga një strukturë që ka personelin e duhur.

“**Normimi/rregullore**” nënkupton çdo normë ligjore dhe përfshin një instrument me anë të të cilit qeveritë vendosin kushte mbi ndërmarrjet dhe qytetarët dhe përfshin të gjitha ligjet (parësore dhe dytësore), urdhrat formalë dhe joformalë, nënregullat, formalitetet dhe rregullat administrative të nxjerra nga organet joqeveritare apo vetë-normuese, të cilave qeveritë u kanë deleguar kompetenca normuese.

“**Rregullatorët**” nënkupton të gjithë personelin e departamenteve qeveritare dhe agjencive të tjera përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e normimeve.

“**Analizimi/Vlerësimi i Ndikimit Rregullator (VNR)**” nënkupton procesin e rregullt të identifikimit dhe matjes së ndikimeve ekonomike, shoqërore dhe mjedisore që mund të rrjedhin nga miratimi i **një normimi** të propozuar ose i një alternative të politikës jonormuese nën shqyrtim. Ai mund të mbështetet tek një analizë përfitim/kosto, analizë të efektivitetit të koston, etj.

Një përkufizim më i gjerë i VNR-së do të tregonte ndryshimin mes VNR-së *ex ante* (përpara faktit) që ka lidhje me ndikimet e mundshme të një propozimi rregullator dhe VNR-së *ex post* (pas faktit) që ka lidhje me ndikimet faktike të një mase normuese ekzistuese.

“**Menaxhimi normues/rregullator**” nënkupton menaxhimin e hartimit të politikave nga një vend për të arritur një shoqëri të barabartë, zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë së tij dhe të mbrojtë mjedisin e tij.

“**Reforma normuese/rregullore**” nënkupton ndryshimet që përmirësojnë cilësinë normuese, pra, që nxisin performancën, efektivitetin e koston apo cilësinë ligjore të **normimit** dhe formaliteteve.

“**Legjislacioni dytësor**” nënkupton rregulloret që mund të përgatiten nga një person (ministër) apo një organ (një autoritet vendor i pavarur).

<sup>160</sup> COM (2002)278 finale, po aty. – Shikoni dhe Komunikatën nga Komisioni “Qeverisja europiane: hartimi më i mirë i ligjeve, COM (2002)275 finale, [http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/com/2002/com2002\\_0275en01.pdf](http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/com/2002/com2002_0275en01.pdf)

<sup>161</sup> COM(2001)428 finale, po aty: Qëllimi i nismës së Komisionit Europian mbi qeverisjen europiane është zhvillimi i kulturës së re të përbashkët legjislativë në Europë, përmes përmirësimit të procedurave aktuale, zgjerimit të hapësirës së mjeteve të politikave të përdorura dhe thjeshtimit të legjislacionit ekzistues.

<sup>162</sup> COM (2005) 97 finale, [http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/com/2005/com2005\\_0097en01.pdf](http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/com/2005/com2005_0097en01.pdf).

<sup>163</sup> COM (2006) 689 finale, [http://ec.europa.eu/enterprise/regulation/better\\_regulation/docs/docs\\_admin\\_b/en\\_689.pdf](http://ec.europa.eu/enterprise/regulation/better_regulation/docs/docs_admin_b/en_689.pdf).

**“SIGMA”** (Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit në Vendet e Europës Qendrore dhe Lindore) nënkupton nismën e përbashkët OECD-BE të nisur në vitin 1992, bashkërenduar dhe financuar kryesisht nga Komisioni Europian e cila synon, mes objektivave të tjera, të ndihmojë Shtetet e reja Anëtare të Bashkimit Europian dhe Vendet Kandidate për modernizimin dhe forcimin e kapaciteteve të tyre politike-bërëse.

**“Ligji i butë”** nënkupton qarkoret administrative dhe vendimin administrativ.

**“Perëndimi”** nënkupton një shfuqizim automatik të normimeve, pas një numri të caktuar vitesh nga data e hyrjes në fuqi. Kjo zakonisht nxit një vlerësim të normimit pak përpara se të ndodhë shfuqizimi.

## SHTOJCA 2: STANDARDI

### **Standardi**

Standardi krijon një grup normash në lidhje me shtatë fushat kryesore (A-G) dhe do të përdoret për të vlerësuar:

- horizontalisht (d.m.th. të gjithë qeverinë) një politikë gjithëpërfshirëse dhe kapacitetin e një vendi për të krijuar dhe zbatuar një politikë të qartë normuese, dhe
  - vertikalisht (d.m.th. në një fushë të caktuar normimi) zbatimin e një politike të normimit më të mirë në veprimtari të veçanta të politikës.
- A.** një politikë në lidhje me menaxhimin normues.
- B.** një proces të përcaktimit të programit të normimit.
- C.** një proces për formulimin e politikës dhe kthimin e saj në normime (qofshin instrumente ligjorë apo administrativë).
- D.** një proces normues i garantimit të cilësisë.
- E.** një proces të hyrjes në fuqi.
- F.** një mekanizëm të zbatimit/respektimit.
- G.** një proces vlerësimi, në lidhje me rregullore të caktuara ose në përgjithësi pas një periudhe të miratuar të veprimtarisë.

**A. Një politikë e veçantë e menaxhimit normuese**

1. Normimi i një vendi duhet të menaxhohet duke iu referuar një politike të veçantë mbi menaxhimin normues/rregullator: pra, një politike që ka si objektiv të saj in përmirësimin e cilësisë së normimit dhe që përcaktohet politikisht dhe nga strukturat e pajisura me personelin e duhur. Politika duhet të përqendrohet në legjislacionin e ri si dhe në grupin e rregulloreve ekzistuese për të sjellë përmirësim të vazhdueshëm në hartimin e normimeve dhe në mjedisin e përgjithshëm rregullator. Politika duhet të qëndrojë si një politikë e identifikueshme qartë në mënyrë që politikat fiskale apo mjedisore të mund të shihen dhe kuptohen si politika të qarta.

2. Aftësia, kapaciteti për të ndërmarrë politika të tilla duhet të tregohet nëpërmjet:

- një politike të shkruar mbi menaxhimin normues, që vepron në të gjithë qeverinë dhe garanton një qasje të plotë të qeverisë në fusha të politikave që mbivendosen.
- ekzistencës së një organi apo strukture për të zbatuar politikën.
- një numri të përshtatshëm të personelit të kualifikuar siç duhet.
- raporteve ose treguesve të tjerë të pikave të forta dhe të dobëta të politikës.
- mjeteve dhe mekanizmave të përshtatshëm për të garantuar respektimin e politikës.

**B. Një proces i përcaktimit të programit**

1. Menaxhimi normues efektiv kërkon planifikim në formën e një strategjie të përgjithshme për të arritur qëllimet politike, ekonomike, mjedisore dhe sociale të qeverisë, si dhe një planifikim taktik për t'u marrë me zbatimin e përditshëm të programeve qeveritare dhe negocimin, respektimin dhe zbatimin efektiv të politikave të Bashkimit Europian. Procesi i planifikimit duhet të shfaqë prova të aftësive për të përcaktuar synime dhe një aftësi për të garantuar që synimet e përcaktuara të jenë të arritshme dhe arrihen.

2. Aftësia, kapaciteti i procesit të përcaktimit të programit duhet të tregohet nëpërmjet:

- përshkrimeve të procesit.
- planeve të publikuara, siç janë programet qeveritare ose të koalicionit.
- strukturave administrative.
- një numri të përshtatshëm personeli të kualifikuar siç duhet.
- raporteve apo treguesve të tjerë, që tregojnë se janë arritur rezultate të miratuara më parë në periudha të caktuara.
- një kapaciteti për të garantuar përputhshmërinë me programet, pasi të jenë vendosur.

#### **C. Procesi i formulimit të një politike dhe i hartimit të normimeve**

1. Një pjesë përbërëse e menaxhimit rregullator është procesi i formulimit të politikave dhe artikulimi i tyre në formën e rregulloreve. Cilësia normuese është një funksion i personave dhe proceseve të përfshirë në analizimin e problemeve, gjetjen e zgjidhjeve normuese, hartimin e rregulloreve, garantimin e cilësisë së rregulloreve, zbatimin dhe/ose respektimin e rregulloreve dhe vlerësimin e rregulloreve, pasi të kenë hyrë në fuqi. Menaxhimi i mirë rregullator është një funksion i politikave (politika të qarta mbi menaxhimin normues dhe politika për çdo sektor), instrumenteve (këshillimi, vlerësimi i ndikimit rregullator, përdorimi i alternativave ndaj normimit tradicional komandë e kontroll) dhe institucioneve të përfshira në këtë proces.

2. Kapaciteti i procesit të formulimit të politikave dhe i hartimit të rregulloreve duhet të tregohet nëpërmjet:

- një procesi transparent, të parashikuar me ligj ose të vendosur në listën e kontrollit për analizimin e problemeve dhe vendimmarrjen apo udhëzime të ngjashme.
- strukturave të përshtatshme për analizimin e çështjeve të politikave dhe zgjidhjen e tyre përmes mjeteve normuese apo mjeteve të tjera.
- instrumenteve të përshtatshme siç janë mjetet e analizimit të ndikimit rregullator.
- një numri të përshtatshëm personeli, të trajnuar siç duhet në lidhje me fusha të caktuara të formulimit të politikave dhe hartimit të rregulloreve.
- në lidhje me masat e BE-së, nëpërmjet proceseve dhe personelit për analizimin e propozimeve dhe respektimin dhe zbatimin e politikave të Bashkimit Europian.
- proceseve të konsultimit të hartuara dhe të menaxhuara siç duhet, mjeteve të vlerësimit të ndikimit rregullator dhe larmisë së mjeteve të zbatimit të normimeve përfshirë alternativat ndaj mjeteve normuese tradicionale komandë e kontroll.

#### **D. Procesi i sigurimit të cilësisë**

1. Menaxhimi i mirë normues kërkon një proces të brendshëm të sigurimit të cilësisë që verifikon rregulloret përkundrejt parimeve të normimit të mirë, të tilla si:

- kushtetutshmëria dhe përputhshmëria me parimet e përgjithshme të së drejtës, përfshirë legjislacioni dhe politikat e Bashkimit Europian.
- qëndrueshmëria brenda rregullores.
- përputhja me rregulloret e tjera, politikat e BE-së dhe ato qeveritare në përgjithësi.

- proporcionaliteti.
- qartësia.
- mundësia për t'u përdorur.
- efektiviteti, jo vetëm në lidhje me arritjen e objektivave të politikave të deklaruara, por edhe nga këndvështrimi i minimizimit të burokracisë dhe barrave, veçanërisht detyrimeve mbi Ndërmarrjet e Mesme dhe të Vogla. (SME-të)
- përputhshmëria me politikën buxhetore.
- ndikimi ekonomik, mjedisor dhe social (përfshirë ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme).
- efikasiteti dhe efektiviteti (lidhur me praktikitetin dhe zbatimin).
- transparenca dhe mosdiskriminimi.
- mjaftueshmëria e burimeve për të arritur objektiva të caktuara.
- kompetenca për të zbatuar standardet e cilësisë.
- barrat administrative dhe ulja e burokracisë.

2. Procesit i sigurimit të cilësisë duhet të funksionojë horizontalisht për sa i përket zbatimit të një politike gjithëpërfshirëse mbi menaxhimin rregullator dhe vertikalisht brenda secilit organ përgjegjës për hartimin e rregulloreve.

3. Kapaciteti i procesit të formulimit të politikave dhe hartimit të rregulloreve duhet të tregohet nëpërmjet:

- një institucioni apo grupi masash të ngjashme për garantimin e cilësisë, horizontalisht - në të gjithë qeverinë dhe vertikalisht - në lidhje me secilin organ që harton rregulloren.
- normave të publikuara apo të verifikueshme të cilësisë normuese.
- procedurave për vlerësimin e cilësisë.
- një numri të mjaftueshëm personeli të kualifikuar siç duhet.
- raporteve (të brendshëm) mbi procesin e garantimit të cilësisë, të përgatitura nga vetë organet ose nga komisionet parlamentare apo komentuesit akademikë.
- praktikave dhe procedurave për t'u marrë me rastet kur nuk është arritur normim me cilësi të lartë, në përputhje me normat e miratuara.

#### **E. Miratimi**

1. Për të arritur menaxhim normues efektiv duhet të miratohet një ligj i veçantë mbi menaxhimin normues cilësor, i cili të parashikojë norma rregullatore.

2. Miratimi është thelbësor për procesin e menaxhimit normues, qoftë nga parlamenti (legjislacioni parësor), qoftë nga një organ i deleguar (legjislacioni i deleguar). Procesi i miratimit zakonisht përfshin një formë vlerësimi të çështjeve të politikave dhe vlerësimi të cilësisë së rregulloreve. Nuk është e nevojshme të vlerësohet ekzistenca e institucioneve të tilla dhe do të ishte e papërshtatshme që të kryhej analizë e cilësisë së tyre. Gjithsesi, një tregues i dobishëm i kapacitetit të mundshëm të institucioneve miratuese mund të përcaktohet nga një vlerësim i ekzistencës dhe shkallës së kërkimit, mjediseve të sekretariatit si dhe bibliotekave në dispozicion të ligjvënësve.

3. Kapaciteti i procesit të miratimit duhet të tregohet nëpërmjet:

- një institucioni apo grupi masash të barazvlefshme për sigurimin e cilësisë.
- normave të publikuara apo të verifikueshme të cilësisë normuese.
- procedurave për analizën e cilësisë.
- një numri të mjaftueshëm të personelit të kualifikuar siç duhet.

- raporteve (të brendshëm) mbi procesin e garantimit të cilësisë, të përgatitura nga vetë organet ose nga komisionet parlamentare apo komentuesit akademikë.

#### **F. Respektimi dhe zbatimi i rregulloreve**

1. Formulimi dhe hartimi i rregulloreve është pjesa fillestare e procesit rregullator. Për të qenë efektive, rregulloret duhet të respektohen ose të detyrohet respektimi i tyre përmes zbatimit të ligjit. Vlerësimi i kapacitetit të plotë për të garantuar zbatimin apo respektimin e rregulloreve do të kërkonte një studim të gjerë. Si rrjedhojë janë zgjedhur dy fusha si tregues: rregulloret e pronësisë intelektuale dhe rregulloret e mbrojtjes së mjedisit.

2. Kapaciteti i procesit të miratimit duhet të tregohet nëpërmjet:

- mundësisë për të pasur akses tek regjimet rregullatore përkatëse dhe shkallën në të cilën janë në dispozicion materialet shpjeguese për të bërë të njohura kërkesat rregullatore.
- raporteve (të brendshëm apo të jashtëm) që tregojnë se deri në çfarë mase janë efektive regjimet rregullatore të matura përkundrejt vetëvlerësimeve subjektive të qeverisë për efektivitetin apo vlerësimeve objektive të ndërmarra nga komentuesit akademikë, konsumatorët, grupet e interesit në fushën e tregtisë dhe mjedisit.
- Pranisë së një numri të mjaftueshëm të personelit të kualifikuar siç duhet për të kryer inspektime, për të verifikuar nivelet e përputhshmërisë dhe për të garantuar zbatimin.

#### **G. Vlerësimi**

1. Një karakteristikë themelore e menaxhimit rregullator është deri në çfarë mase vlerësohen rregulloret, pasi hyjnë në fuqi, nga këndvështrimi i efektivitetit dhe rëndësisë.

2. Kapaciteti i procesit të vlerësimit rregullator duhet të tregohet nëpërmjet:

- pranisë së proceseve të vlerësimit (të përgjithshëm dhe të veçantë) për vlerësimet e vërtetuara nga masat institucionale dhe raportet apo procedurat e atyre institucioneve.
- pranisë së një numri të mjaftueshëm të personelit të kualifikuar siç duhet për të kryer inspektime, për të verifikuar nivelet e përputhshmërisë dhe për të garantuar zbatimin.
- provave të bashkëpunimit me organet ndërkombëtare ose përmes pjesëmarrjes në vlerësime nga homologët, ose përmes mënyrave të tjera.

### **SHTOJCA 3: PYETËSOR MBI PROJEKTIN E VLERËSIMIT TË KAPACITETEVE TË MENAXHIMIT RREGULLATOR TË SHTETEVE TË REJA ANËTARE TË BE-së**

#### **A. Një politikë në lidhje me menaxhimin rregullator**

##### **Të përgjithshme**

#### **1. A keni politikë të qartë për menaxhimin rregullator?**

Qëllimi i kësaj pyetje është që t'ju kërkojë juve të përshkruani:

- Nëse është miratuar një politikë e qartë reforme, atëherë duhet të tregoni: kur dhe si?
- A mbështetet dhe drejtohet politikisht ajo politikë?
- Nëse nuk ka një politikë të qartë mbi Normimin më të Mirë, duhet të tregoni: si e ka treguar qeveria mbështetjen e saj për reformën rregullatore?
- A ka pasur zhvillime në: këshillimin mbi rregulloret e propozuara, përdorimin e alternativave përkundrejt normimit tradicional, përdorimin e instrumenteve për vlerësimin e ndikimit, vlerësimet e rregulloreve nga këndvështrimi i pakësimit të burokracisë, kodifikimin e ligjeve dhe përmirësimin e aksesit tek ligjet, përmes mundësisë për t'i marrë rregulloret nga interneti?

##### **Hapja e vendimmarrjes rregullatore**

#### **2. A ka ndonjë sistem për planifikimin paraprak të veprimtarive normuese?**

Qëllimi i kësaj pyetje është t'ju kërkojë juve të:

- përshkruani procesin e planifikimit për hartimin e rregulloreve të reja.
- tregoni nëse janë përdorur teknologjitë e informacionit gjatë hartimit apo përdorimit të këtyre planeve.
- shpjegoni se si përcaktohen përparësitë.
- shpjegoni se si zgjidhen përplasjet mes përparësive.

#### **B. Një proces për formulimin e politikave dhe shndërrimin e tyre në normime (qofshin instrumente ligjorë apo administrativë).**

##### **Procedurat administrative për hartimin e politikave.**

#### **3. A ka procedura administrative për të hartuar rregullore të reja?**

Qëllimi i kësaj pyetje është që t'ju kërkojë juve të:

